



رئاسة الشؤون الدينية
بالمسجد الحرام والمسجد النبوي

shqip

ألّباني

حِصْنُ الْمُسْلِمِ مِنْ أَذْكَارِ الْكِتَابِ وَالسُّنَّةِ

Fortesa e Muslimanit Lutje nga Kurani dhe Suneti



Robi nevojtar për Allahun e Lartësuar
Dr. Seid Ibn Ali Ibn Uehf el-Kahtani

حِصْنُ الْمُسْلِمِ
مِنْ أَذْكَارِ الْكِتَابِ وَالسُّنَّةِ

"Fortesa e Muslimanit – Lutje nga Kurani dhe Suneti"

د. سَعِيدُ بْنُ عَلِيٍّ بْنِ وَهْفٍ الْقَحْطَانِيُّ

Robi nevojtar për Allahun e Lartësuar
Dr. Seid Ibn Ali Ibn Uehf el-Kahtani

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Fortesa e Muslimanit – Lutje nga Kurani dhe Suneti

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

Parathënie

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë, Atij ndihmë e falje i kërkojmë dhe tek Ai mbështetemi të na mbrojë nga ligësitë e veteve tona dhe nga veprat tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon, askush nuk e devijon, e atë që Ai e lë në humbje, askush nuk e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka zot që meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit, pa shok. Gjithashtu dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Paqja dhe bekimet e shumta të Allahut qofshin mbi të, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që i pasojnë ata me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Kjo është një përmbledhje të cilën e kam marrë nga libri im: "Dhikri, lutja dhe mjekimi me rukje nga Kurani dhe Suneti"¹, ku kam përmbledhur pjesën e dhikreve dhe të lutjeve, në mënyrë që të jetë e lehtë

¹ Originali i lartpërmendur tashmë është botuar, falë Allahut, së bashku me referencat e hollësishme të haditheve të tij, në katër vëllime. "Fortesa e Muslimanit" gjendet në vëllimin e parë dhe të dytë të këtyre katër vëllimeve.

për t'u bartur gjatë udhëtimeve.

Unë jam mjaftuar vetëm me citimin e tekstit të dhikrit dhe, sa i përket referencave të tij, jam mjaftuar me përmendjen e një ose dy prej tyre nga ato që gjenden në variantin origjinal të librit. Kush dëshiron të dijë emrin e sahabiut ose detaje shtesë rreth referencave të hadithit, le t'i referohet origjinalit. E lus Allahun e Plotfuqishëm e të Madhërishëm, me Emrat e Tij të Bukur dhe me Cilësitë e Tij të Larta, që ta bëjë atë të singertë për Fytyrën e Tij Fisnike, ta bëjë të dobishëm për mua në jetën time dhe pas vdekjes sime, si dhe ta bëjë të dobishëm për gjithsecilin që e lexon, e boton a bëhet shkak për përhapjen e tij. Pa dyshim Ai është i Denjë dhe i Plotfuqishëm për ta realizuar këtë. Salavatet dhe selamet qofshin për profetin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij, dhe për të gjithë ata që i ndjekin ata me vepra të mira deri në Ditën e Gjykimit!

Autori

Ky libër u shkrua në muajin Sefer të vitit 1409 hixhri.

Vlera e dhikrit (përmendjes së Allahut)

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ وَاشْكُرُوا لِي وَلَا تَكْفُرُونَ ﴿١٥٢﴾﴾

"Më kujtoni Mua që Unë t'ju kujtoj dhe falënderomëni Mua e mos i mohoni dhuntitë e Mia!"¹

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا كَثِيرًا ﴿١٥٣﴾﴾

"O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun!"²

﴿...وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُم مَّغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا﴾

"...dhe përmendësit e Allahut në vazhdimësi dhe përmendëset e Allahut, pra për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh"³

﴿وَأَذْكُرْ رَبَّكَ فِي نَفْسِكَ تَضَرَّعًا وَخِيفَةً وَدُونَ الْجَهْرِ مِنَ الْقَوْلِ بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ

وَلَا تَكُن مِّنَ الْغَافِلِينَ ﴿١٥٤﴾﴾

"Përmende Zotin tënd më vete, i përlur dhe me frikë - jo me zë të lartë, në mëngjes e mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që janë të pavëmendshëm!"⁴

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَثَلُ الَّذِي يَذْكُرُ رَبَّهُ، وَالَّذِي لَا يَذْكُرُ رَبَّهُ، مَثَلُ الْحَيِّ وَالْمَيِّتِ».

"Shembulli i atij që e përmend Zotin dhe i atij që

¹ El-Bekare: 152.

² El-Ahzab: 41.

³ El-Ahzab: 35.

⁴ Sureja El-A'raf: 205.

nuk e përmend Atë është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit."¹

Po ashtu, Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«أَلَا أَنْبِئُكُمْ بِخَيْرِ أَعْمَالِكُمْ، وَأَزْكَاهَا عِنْدَ مَلِيكِكُمْ، وَأَرْفَعُهَا فِي دَرَجَاتِكُمْ، وَخَيْرٌ لَّكُمْ مِنْ إِنْقَاقِ الذَّهَبِ وَالْوَرِقِ، وَخَيْرٌ لَّكُمْ مِنْ أَنْ تَلْقَوْا عَدُوَّكُمْ فَتَضْرِبُوا أَعْنَاقَهُمْ وَيَضْرِبُوا أَعْنَاقَكُمْ؟» قَالُوا بَلَى. «ذِكْرُ اللَّهِ تَعَالَى».

"A t'ju tregoj për veprën tuaj më të mirë, më të pastër te Sunduesi juaj dhe më të lartë për ju në pozitë, më të mirë për ju se shpenzimi i arit dhe i argjendit dhe më të mirë për ju sesa të përballeni me armikun tuaj: t'u mëshoni në qafat e tyre dhe t'ju mëshojnë në qafat tuaja?" Ata thanë: "Patjetër." Ai tha: "Përmendja e Allahut të Lartësuar."²

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«يَقُولُ اللَّهُ تَعَالَى: أَنَا عِنْدَ ظَنِّ عَبْدِي بِي، وَأَنَا مَعَهُ إِذَا ذَكَرَنِي، فَإِنْ ذَكَرَنِي فِي نَفْسِهِ، ذَكَرْتُهُ فِي نَفْسِي، وَإِنْ ذَكَرَنِي فِي مَلَأٍ، ذَكَرْتُهُ فِي مَلَأٍ خَيْرٍ مِنْهُمْ، وَإِنْ تَقَرَّبَ إِلَيَّ شَبْرًا، تَقَرَّبْتُ إِلَيْهِ ذِرَاعًا، وَإِنْ تَقَرَّبَ إِلَيَّ ذِرَاعًا، تَقَرَّبْتُ إِلَيْهِ بَاعًا، وَإِنْ أَتَانِي يَمْسِي أَتَيْتُهُ هَرَوَلَةً».

"Allahu i Lartësuar thotë: 'Unë, për robin Tim,

¹ Buhariu në Fet'hul-Bari (11/208) me numër (6407) dhe Muslimi (1/539) me numër (779), në versionin e të cilit qëndron: "Shtëpia në të cilën përmendet Allahu dhe shtëpia në të cilën nuk përmendet Allahu, i shëmbëllen të gjallit dhe të vdekurit."

² Tirmidhiu (5/459) nr. 3377, dhe Ibn Maxhe (2/124) nr. 3790. Shih: Sahihu i Ibn Maxhes (2/316) dhe Sahihu i Tirmidhiut (3/139).

jam ashtu siç ai mendon për Mua. Jam me të kur ai më përmend: nëse më përmend në vete edhe Unë e përmend në Vete, e, nëse më përmend në grup (para të tjerëve), Unë e përmend në një grup më të mirë se ata. Nëse ai më afrohet sa një pëllëmbë, Unë i afrohem sa një kut, e nëse më afrohet sa një kut, Unë i afrohem sa një pash. Nëse ai më vjen duke ecur, Unë i shkoj duke nxituar."¹

Abdullah Ibn Busri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Një njeri vajti te Profeti (paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: 'O i Dërguari i Allahut, ligjet e Islamit janë bërë shumë, ndaj më trego ndonjë çështje përmbledhëse, që të kapem pas saj!' Ai tha:

«لَا يَزَالُ لِسَانُكَ رَطْبًا مِنْ ذِكْرِ اللَّهِ».

'Le të jetë gjuha jote gjithnjë e njomë nga përmendja e Allahut'"²

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) po ashtu ka thënë:

«مَنْ قَرَأَ حَرْفًا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ فَلَهُ بِهِ حَسَنَةٌ، وَالْحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا، لَا أَقُولُ: (الْم) حَرْفٌ، وَلَكِنْ: أَلِفٌ حَرْفٌ، وَلَا م حَرْفٌ، وَمِيمٌ حَرْفٌ».

"Ai që lexon një shkronjë nga Libri i Allahut, ka një shpërblim, i cili shtohet dhjetëfish. Nuk them se

¹ Buhariu (8/171) nr. 7405 dhe Muslimi (4/2061) nr. 2675, ndërsa teksti është i Buhariut.

² Tirmidhiu (5/458) nr. 3375, dhe Ibn Maxhe (2/1246) nr. 3793. Albani e ka vlerësuar të saktë në: "Sahih Et-Tirmidhi" (3/139) dhe "Sahih Ibn Maxhe" (2/317).

elifi, lami dhe mimi janë një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami një shkronjë dhe mimi shkronjë më vete."¹

Ukbe ibn Amiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) doli ndërsa ne ishim në Suffe dhe tha:

«أَيُّكُمْ يُحِبُّ أَنْ يَغْدُوَ كُلَّ يَوْمٍ إِلَى بُطْحَانَ، أَوْ إِلَى الْعَقِيقِ، فَيَأْتِي مِنْهُ بِنَاقَتَيْنِ كَوْمَاوَيْنِ فِي غَيْرِ إِثْمٍ وَلَا قَطِيعَةٍ رَحِمَ؟»

"Kush prej jush dëshiron të shkojë çdo ditë në But'han ose në Akik dhe të kthehet prej andej me dy deve me gunga të mëdha, pa bërë mëkat dhe pa shkëputur lidhjet farefisnore?" Ne thamë: "O i Dërguari i Allahut, të gjithë e duam një gjë të tillë." Ai tha:

«أَفَلَا يَغْدُو أَحَدُكُمْ إِلَى الْمَسْجِدِ فَيَعْلَمُ، أَوْ يَقْرَأَ آيَتَيْنِ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ خَيْرٌ لَهُ مِنْ نَاقَتَيْنِ، وَثَلَاثُ خَيْرٌ لَهُ مِنْ ثَلَاثٍ، وَأَرْبَعُ خَيْرٌ لَهُ مِنْ أَرْبَعٍ، وَمِنْ أَعْدَادِهِنَّ مِنَ الْإِبِلِ».

"A nuk mund të shkojë ndonjëri prej jush në mëngjes në xhami që të mësojë apo të lexojë dy ajete nga Libri i Allahut të Madhëruar, të cilat janë më të mira për të sesa dy deve, tri janë më të mira për të sesa tri deve, katër janë më të mira për të sesa katër deve e kështu me radhë sipas numrit të tyre

¹ Tirmidhiu (5/75) nr. 2910. Albani e ka vlerësuar të saktë në: 'Sahih et-Tirmidhi' (3/9) dhe 'Sahih el-Xhami es-Sagir' (5/340).

prej deveve."¹

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) po ashtu ka thënë:

«مَنْ قَعَدَ مَقْعَدًا لَمْ يَذْكُرِ اللَّهَ فِيهِ، كَانَتْ عَلَيْهِ مِنَ اللَّهِ تِرَةٌ، وَمَنْ اضْطَجَعَ مَضْجَعًا لَمْ يَذْكُرِ اللَّهَ فِيهِ كَانَتْ عَلَيْهِ مِنَ اللَّهِ تِرَةٌ».

"Kush ulet në një vend dhe nuk e përmend Allahun në të, ai meriton njëfarë ndëshkimi nga Allahu. E kush shtrihet në një shtrat (për të pushuar ose fjetur) dhe nuk e përmend Allahun në të, meriton njëfarë ndëshkimi nga Allahu."²

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) po ashtu ka thënë:

«مَا جَلَسَ قَوْمٌ مَجْلِسًا لَمْ يَذْكُرُوا اللَّهَ فِيهِ، وَلَمْ يُصَلُّوا عَلَى نَبِيِّهِمْ إِلَّا كَانَ عَلَيْهِمْ تِرَةٌ، فَإِنْ شَاءَ عَذَّبَهُمْ، وَإِنْ شَاءَ غَفَرَ لَهُمْ».

"Asnjë popull nuk ulet në ndonjë tubim ku nuk e përmendin Allahun dhe nuk dërgojnë salavate për Profetin e tyre, përveçse ai tubim do të jetë një arsye për ndëshkim. Nëse do, Allahu i ndëshkon, e nëse do, i fal."³

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَا مِنْ قَوْمٍ يَقُومُونَ مِنْ مَجْلِسٍ لَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ فِيهِ إِلَّا قَامُوا عَنْ مِثْلِ حَيْفَةٍ

¹ Muslimi (1/553) nr. 803.

² Ebu Davudi (4/264) nr. 4856, e të tjerë. Shih: Sahih el-Xhami (5/342).

³ Tirmidhiu (5/461) nr. 3380 dhe shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/ 140).

جَمَارٍ، وَكَانَ لَهُمْ حَسْرَةٌ».

"Asnjë popull nuk ngrihet nga një tubim në të cilin nuk e kanë përmendur Allahun, përveçse do të jetë sikur po largohen nga kufoma e një gomari dhe do të jetë shkak për pikëllimin e tyre."¹

1. Dhikri i zgjimit nga gjumi

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَحْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا، وَإِلَيْهِ النُّشُورُ».

"Falënderimi i takon Allahut që na ringjalli pas vdekjes dhe tek Ai është tubimi."²

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،
سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ
الْعَظِيمِ، رَبِّ اغْفِرْ لِي».

"S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. I lavdëruar qoftë Allahu, falënderimi i takon Allahut, s'ka të adhuruar përveç Allahut, Allahu është më i Madhi, dhe s'ka ndryshim e as fuqi, përveçse me anë të Allahut, të Lartit, Madhështorit. O Zoti im, më fal!"³

¹ Ebu Davudi (4/264) nr. 4855 dhe Ahmedi (2/389) nr. 10680 dhe shih: Sahih el-Xhami (5/176).

² Buhariu me Feth el-Bari (11/113) nr. 6314 dhe Muslimi (4/2083) nr. 2711.

³ "Atij që e thotë këtë i falen mëkatet, nëse bën lutje i pranohet dhe nëse ngrihet e merr abdes, pastaj fal namaz, i pranohet namazi." Buhariu me Fet'h el-Bari (3/39) me numër (1154) dhe të tjerë, kurse teksti është i Ibn Maxhes. Shih: Sahihu i Ibn Maxhes (2/335).

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَافَانِي فِي جَسَدِي، وَرَدَّ عَلَيَّ رُوحِي، وَأَذِنَ لِي بِذِكْرِهِ».

"Falënderimi i takon Allahut që më dha shëndet në trupin tim, ma ktheu shpirtin dhe më lejoi ta përmend Atë."¹

﴿إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ لَآيَاتٍ لِأُولِي الْأَلْبَابِ ۝ الَّذِينَ يَذْكُرُونَ اللَّهَ قِيَمًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِهِمْ وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَطْلًا سُبْحَانَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ۝ رَبَّنَا إِنَّكَ مَن تُدْخِلِ النَّارَ فَقَدْ أَخْرَجْتَهُ ۚ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ۝ رَبَّنَا إِنَّنَا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ ءَامِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَقَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ ۝ رَبَّنَا وَءَاتِنَا مَا وَعَدْتَنَا عَلَىٰ رُسْلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَمَةِ إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ ۝ فَاسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أَضِيعُ عَمَلَ عَمِلٍ مِّنْكُمْ مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أَنفَىٰ بَعْضُكُم مِّنْ بَعْضٍ فَأَلَّذِينَ هَاجَرُوا وَأُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأُودُوا فِي سَبِيلِي وَقَتَلُوا وَقُتِلُوا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَلَأُدْخِلَنَّهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ثَوَابًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۚ وَاللَّهُ عِنْدَهُ حُسْنُ الثَّوَابِ ۝ لَا يَغْرَنَّاكَ تَقَلُّبُ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي الْبَلَدِ ۝ مَتَّعٌ قَلِيلٌ ثُمَّ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَبِئْسَ الْمِهَادُ ۝ لَكِنَّ الَّذِينَ آتَقُوا رَبَّهُمْ لَهُمْ جَنَّتٌ تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا نُزُلًا مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۚ وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ لِلْأَبْرَارِ ۝ وَإِنَّ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ لَمَن يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْهِمْ خَدِيعِينَ ۚ لِلَّهِ لَا يَشْتَرُونَ بِآيَاتِ اللَّهِ ثَمَنًا قَلِيلًا أُولَٰئِكَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ۝ يَتَّيَّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَصَابِرُوا وَرَابِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ۝﴾

¹ Tirmidhiu (5/473) nr. 3401. Po ashtu shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/144).

"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët.

Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto. Ti je i Lartësuar (nga çdo e metë)! Ruana nga ndëshkimi i zjarrit!

O Zoti Ynë, këdo që Ti e fut në zjarr, e ke poshtëruar. E, për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi.

O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: "Besoni Zotin tuaj!" dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!

O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!

Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: "Unë nuk do t'ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull a femër. Ju jeni njëlloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t'ua mbuloj veprat e këqija dhe do t'i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.

Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë!

Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!

Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej Allahut. Dhe ajo që është tek Allahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë.

Midis ithtarëve të Librit, me siguri, ka të atillë që e besojnë Allahun dhe atë që ju është shpallur juve, si dhe atë që u është shpallur atyre, duke qenë të përlulur para Allahut dhe pa i shitur shpalljet e Tij me ndonjë çmim të paktë. Ata do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Vërtet, Allahu është i shpejtë në llogari!

O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!"

(Ali Imran: 190-200)¹

2. Duaja e veshjes së rrobës

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي كَسَانِي هَذَا (الثَّوْبَ) وَرَزَقْنِيهِ مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي وَلَا قُوَّةَ...».

"Falënderimi i takon Allahut, i Cili më bëri ta

¹ Buhariu me Fet'h el-Bari (8/337) nr. 4569 dhe Muslimi (1/530) nr. 256.

vesh këtë rrobë dhe më pajisi mua me të, pa forcë a fuqi nga ana ime!"¹

3. Duaja e veshjes së rrobës së re

«اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ كَسَوْتَنِيهِ، أَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِهِ وَخَيْرِ مَا صُنِعَ لَهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهِ وَشَرِّ مَا صُنِعَ لَهُ».

"O Allah! Ty të takon lavdia! Ti ma bërë rrizk këtë veshje. Të kërkoj të ma bësh të dobishme dhe të më mundësosh përdorimin e saj në të mirën për të cilën është prodhuar! Kërkoj të më mbrosh nga sherri i saj dhe nga sherri për të cilën është prodhuar!"²

4. Duaja për atë që ka veshur rrobë të re

«تُبْلِي وَيُخْلِفُ اللَّهُ تَعَالَى».

"E vjetërofsh dhe Allahu ta kompensoftë me të tjera!"³

«الْبَسَ جَدِيدًا، وَعَشَ حَمِيدًا، وَمُتَ شَهِيدًا».

"Vish rrobë të re, jeto i lavdëruar dhe vdis martir!"⁴

¹ E transmetuan autorët e Suneneve përveç Nesaiut: Ebu Davudi nr. 4023, Tirmidhiu nr. 3458 dhe Ibn Maxhe nr. 3285. Albani e ka cilësuar të mirë në: "Irvaul-Galil" (47/7).

² Ebu Davudi nr. 4020, Tirmidhiu nr. 1767 dhe Begaviu (12/40). Shih: Muhtesar Shemail et-Tirmidhi të Albanit (fq. 47).

³ Transmetoi Ebu Davudi (4/41) nr. 4020. Shih: Sahihun e Ebu Davudit (2/760).

⁴ Ibn Maxhe (2/1178) nr. 3558, dhe Begaviu (41/12). Shih: Sahihun e Ibn Maxhes (275/2).

5. Çfarë themi kur heqim rrobën?

«بِسْمِ اللَّهِ».

"Me emrin e Allahut!"¹

6. Lutja e hyrjes në tualet (nevojtores)

«بِسْمِ اللَّهِ [اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخُبْثِ وَالْخَبَائِثِ].»

"Me emrin e Allahut, O Allah! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga të ndyrët dhe të ndyrat (shejtanët dhe shejtanet)!"²

7. Lutja e daljes nga tualeti

«غُفْرَانَكَ».

"O Zot më fal!"³

8. Dhikri para abdesit

«بِسْمِ اللَّهِ».

"Me emrin e Allahut"⁴.

9. Dhikri pas përfundimit të abdesit

¹ Tirmidhiu (2/505), nr. 606 dhe të tjerë. Shih: "Irvau'l-galil", nr. 50 dhe "Sahihu'l-Xhami" (203/3).

² Transmetuan Buhariu (1/ 45) nr. 142 dhe Muslimi (1/ 283) nr. 375, ndërsa shitesën "Bismil-lah" në fillim të tij e ka transmetuar Seid bin Mensuri. Shih: Fet'hul Bari (1/ 244).

³ E transmetuan autorët e Suneneve përveç Nesaiut, i cili e ka transmetuar në "Amelul-jeum uel-lejleh" nr. 79, Ebu Davudi nr. 30, Tirmidhiu nr. 7 dhe Ibn Maxhe nr. 300, Albani e ka cilësuar të saktë në Sahihun e Sunen Ebi Davudit (1/19).

⁴ Ebu Davudi nr. 101, Ibn Maxhe nr. 397 dhe Ahmedi nr. 9418. Shih Irvaul Galil (1/122).

«أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ».

"Dëshmoj se s'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij."¹

«اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَّابِينَ وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ».

"O Allah, më bëj prej atyre që pendohen dhe më bëj prej atyre që pastrohen!"²

«سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ».

"O Allah, Ti je pa të meta. Lartësoj lavdinë Tënde! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje! Ty të kërkoj falje për gjynahet dhe te Ti kthehem me pendim!"³

10. Lutja kur të dalim nga shtëpia

«بِسْمِ اللَّهِ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ».

"Me emrin e Allahut, në Allahun u mbështeta dhe s'ka lëvizje e as forcë pa dëshirën e Allahut."⁴

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَضِلَّ، أَوْ أُضَلَّ، أَوْ أَزِلَّ، أَوْ أُزَلَ، أَوْ أَظْلِمَ، أَوْ أُظْلَمَ، أَوْ أَجْهَلَ، أَوْ يُجْهَلَ عَلَيَّ».

"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos

¹ Muslimi (1/209) nr. 234.

² Tirmidhiu (1/78) nr. 55. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (1/18).

³ Nesaïu në Amel el-jeum uel-lejleh (f. 173) Shih: Irvaul-Galil (1/135) dhe (3/94).

⁴ Ebu Davudi (4/325) nr. 5095 dhe Tirmidhiu (5/490) nr. 3426. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/151).

shkoj në humbje e të mos më dërgojë në humbje askush; kërkoj mbrojtjen Tënde të mos rrëshqas (lajthis) dhe të mos më bëjë askush të rrëshqas; kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos e dëmtoj askënd e të mos më dëmtojë askush; kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos e injoroj askënd e të mos më injorojë askush!"¹

11. Lutja kur të hyjmë në shtëpi

«بِسْمِ اللَّهِ وَلِحَنَّا، وَبِسْمِ اللَّهِ خَرَجْنَا، وَعَلَى اللَّهِ رَبَّنَا تَوَكَّلْنَا، ثُمَّ لُيُسَلِّمُ عَلَى أَهْلِهِ».

"Me emrin e Allahut hyjmë në shtëpi, me emrin e Tij dalim dhe Zotit tonë i mbështetëmi." Pastaj le t'i japë selam familjes së tij.²

12. Lutja e shkuarjes në xhami

«اللَّهُمَّ اجْعَلْ فِي قَلْبِي نُورًا، وَفِي لِسَانِي نُورًا، وَفِي سَمْعِي نُورًا، وَفِي بَصَرِي نُورًا، وَمِنْ قُوَّتِي نُورًا، وَمِنْ تَحْتِي نُورًا، وَعَنْ يَمِينِي نُورًا، وَعَنْ شِمَالِي نُورًا، وَمِنْ أَمَامِي نُورًا، وَمِنْ خَلْفِي نُورًا، وَاجْعَلْ فِي نَفْسِي نُورًا، وَأَعْظِمْ لِي نُورًا، وَعَظِّمْ لِي نُورًا، وَاجْعَلْ لِي نُورًا، وَاجْعَلْنِي نُورًا، اللَّهُمَّ أَعْظِنِي نُورًا، وَاجْعَلْ فِي عَصِي نُورًا، وَفِي خُمِي نُورًا، وَفِي دَمِي نُورًا، وَفِي شَعْرِي نُورًا، وَفِي بَشْرِي نُورًا».

¹ Autorët e Suneneve: Ebu Davudi nr. 5094, Tirmidhiu nr. 3427, Nesaiu nr. 5501 dhe Ibn Maxhe nr. 3884. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/152) dhe Sahihu i Ibn Maxhes (2/336).

² E shënon Ebu Davudi (4/325) nr. (5096), ndërsa zinxhirin e transmetimit të tij e ka vlerësuar të mirë dijetari i shquar Ibn Bazi në "Tuhfetul-Ahjar" (f. 28). Kurse në "Sahihun e Muslimit" thuhet: "Kur njeriu futet në shtëpinë e tij dhe thotë: "Bismilah" gjatë hyrjes dhe gjatë ngrënies, shejtani thotë: "S'ka konak për ju sonte e as darkë.", Muslimi nr. (2018).

"O Allah, më bëj dritë në zemrën time, dritë në gjuhën time, dritë në të dëgjuarit tim, dritë në të parët tim, dritë nga lart meje, dritë nga poshtë meje, dritë nga e djathta ime, dritë nga e majta ime, dritë para meje, dritë pas meje dhe më bëj dritë në shpirtin tim! Ma zmadho dritën, ma madhështo dritën, bëj për mua dritë dhe më bëj mua dritë! O Allah, më jep dritë, më bëj dritë në gilcat e mi, dritë në mishin tim, dritë në gjakun tim, dritë në flokët e mi dhe dritë në lëkurën time!"¹

«اللَّهُمَّ اجْعَلْ لِي نُورًا فِي قَبْرِي... وَنُورًا فِي عِظَائِي» «وَزِدْنِي نُورًا، وَزِدْنِي نُورًا» «وَهَبْ لِي نُورًا عَلَى نُورٍ».

"O Allah, më bëj dritë në varrin tim dhe dritë në eshtrat e mia.² Më shto dritë dhe më shto dritë e më shto dritë.³ Më dhuro dritë mbi dritë!"⁴

13. Lutja e hyrjes në xhami

Hyjmë me këmbën e djathtë⁵ dhe themi:

¹ Shih të gjitha këto tekste te Buhariu (11/116) nr. 3166 dhe Muslimi (1/526) nr. 529, 530 dhe 763.

² Tirmidhiu (5/483) nr. 3419.

³ E shënon Buhariu në "El-Edeb el-Mufred", nr. 695 (fq. 258). Albani e ka cilësuar të saktë zinxhirin e tij në "Sahih el-Edeb el-Mufred" nr. 536.

⁴ Këtë e ka përmendur Ibn Haxheri në "Fet'h el-Bari", dhe ia ka atribuuar Ibn Ebi Asimit në librin "Ed-Dua". Shih "El-Fet'h" (11/118), dhe ka thënë: "Kështu, nga transmetimet e ndryshme janë mbledhur njëzet e pesë veçori."

⁵ Bazuar në fjalën e Enes Ibn Malikut (Allahu qoftë i kënaqur me të!): «Prej sunetit është që kur hyn në xhami të fillosh me këmbën e djathtë dhe kur del të fillosh me këmbën e majtë.» E shënon Hakimi (1/218) dhe e cilëson të saktë sipas kushtit të Muslimit, ndërsa me vlerësimin e tij është pajtuar

«أَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ، وَبِوَجْهِهِ الْكَرِيمِ، وَسُلْطَانِهِ الْقَدِيمِ، مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ».

"Kërkoj nga Allahu i Madhërishëm, me Fytyrën e Tij Fisnike dhe me fuqinë e pushtetin e Tij të përhershëm, të më mbrojë nga shejtani i mallkuar!"¹

«بِسْمِ اللَّهِ، وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ»

"Me emrin e Allahut!² Lavdërimi dhe pagja qofshin mbi të Dërguarin e Allahut!"³

«اللَّهُمَّ افْتَحْ لِي أَبْوَابَ رَحْمَتِكَ».

"O Allah! M'i hap dyert e mëshirës Sate!"⁴

14. Lutja e daljes nga xhamia

Del me këmbën e majtë⁵ duke u lutur:

«بِسْمِ اللَّهِ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ»

"Me emrin e Allahut! Salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut."

dhe Dhehebiu. E shënon edhe Bejhëkiu (2/442). Albani e vlerëson të mirë në "Silsiletul-Ehadith es-Sahihah" (5/624) me numër (2478).

¹ Ebu Davudi nr. 466. Shih: Sahihul Xhami nr. 4591.

² Transmetuar nga Ibn Sunniu nr. 88 dhe vlerësuar i mirë nga Albani në Eth-Themerul Mustetab, fq. 607.

³ Ebu Davudi (1/126) nr. 465. Shih: Sahihul Xhami (1/528).

⁴ Muslimi (1/494) nr. 713, dhe në Sunenin e Ibn Maxhes nga hadithi i Fatimes (Allahu qoftë i kënaqur me të): "Allahummeğfir lî dhunubi, ueftah lî eb'uabe rahmetike!" - (O Allah, m'i fal gjynahet dhe m'i hap dyert e mëshirës Sate!). Albani e ka vlerësuar si të saktë për shkak të transmetimeve mbështetëse. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/128) nr. 129.

⁵ Hakimi (1/218) dhe Bejhëkiu (2/442), vlerësuar i mirë nga Albani në Silsiletul-Ehadith es-Sahihah (5/624) nr. 2478. Referencat e tij i kemi përmendur më lart.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ،

"O Allah, të lutem të më japësh nga mirësitë e Tua!"

اللَّهُمَّ اغْصِنِي مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ.

"O Allah! Më mbrojt nga shejtani i mallkuar!"¹

15. Dhikri i ezanit

Themi ashtu siç thotë muezini, përveç te fjalët "Haj-je ales-salah" dhe "Haj-je al-el-felah", ku themi:

«لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ».

"Nuk ka ndryshim dhe as forcë përveç se me Allahun."²

Ndërsa këtë dhikrin:

«وَأَنَا شَهِدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ، رَضِيتُ بِاللَّهِ رَبًّا، وَبِمُحَمَّدٍ رَسُولًا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا».

"Edhe unë dëshmoj se nuk ka zot përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka shok, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Jam i kënaqur me Allahun për Zot, me Muhamedin për të dërguar dhe me Islamin për fe."³

Këtë e themi pasi muezini të thotë shehadetin.⁴

¹ Shiko referencat e transmetimeve të hadithit të mëparshëm në lutjen e hyrjes në xhami, nr. (20) dhe shtesën: "Allahumme'shimni mineshejtanirr-raxhim" të Ibn Maxhes. Shiko: Sahih Ibn Maxhe (1/129).

² Buhari (1/152) nr. 611 dhe 613, dhe Muslimi (1/288) nr. 383.

³ Muslimi (1/290) nr.386.

⁴ Ibn Huzejme (1/220).

Dërgojmë salavate mbi Profetin (paqja qoftë mbi të!) pas përfundimit të përgjigjeve ndaj fjalëve të muezinit.¹

Dhe themi:

«اللَّهُمَّ رَبِّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ النَّامَةِ، وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ، آتِ مُحَمَّدًا الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ، وَابْعَثْهُ مَقَامًا مُحَمَّدًا الَّذِي وَعَدْتَهُ، [إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ]».

"O Allah, Zot i kësaj thirrjeje të përsosur dhe i këtij namazi që po falet, jepja Muhamedit statusin e ndërmjetësimist dhe mirësisë. Ngrije në pozitën e lartë, të cilën ia ke premtuar. Vërtet, Ti nuk e shkel premtimin!"²

Lutemi për veten tonë ndërmjet ezanit dhe ikametit, sepse lutja në këtë kohë nuk refuzohet.³

16. Duaja hyrëse (e namazit)

«اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنْ خَطَايَايَ كَمَا يُنَقَّى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْنِي مِنْ خَطَايَايَ، بِالثَّلْجِ وَالْمَاءِ وَالْبَرْدِ».

"O Allah, largomë prej gjynaheve ashtu siç e ke larguar lindjen prej perëndimit! O Allah, pastromë prej gjynaheve ashtu siç pastrohen rrobat e bardha

¹ Muslimi (1/288) nr. 384.

² Buhariu (1/152) nr. 614, ndërsa pjesa mes kllapave është e Bejhekiut (1/410). Zinxhirin e tij e ka vlerësuar të mirë dijetari i shquar Abdulaziz ibn Bazi (Allahu e mëshiroftë!) në "Tuhfetul Ahjar" (fq. 38).

³ Tirmidhiu nr. 3594 dhe 3595, Ebu Davudi nr. 525 dhe Ahmedi nr. 12200. Shih: Irvaul-Galil (1/262).

prej ndyrësisë! O Allah, pastromë prej gjynaheve me borë, ujë dhe breshër!"¹

«سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، وَتَبَارَكَ اسْمُكَ، وَتَعَالَى جَدُّكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ».

"O Allah! Ti je pa të meta. Ty të bëj lavde! Emri Yt është i bekuar, Madhëria Jote është e Lartësuar, nuk ka hyjni pos Teje!"²

«وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ، إِنَّ صَلَاتِي، وَنُسُكِي، وَمَحْيَايَ، وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الْمَلِكُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَنْتَ رَبِّي وَأَنَا عَبْدُكَ، ظَلَمْتُ نَفْسِي وَاعْتَرَفْتُ بِذُنُوبِي فَاعْفُرْ لِي كُلَّ ذَنْبٍ جَمِيعًا إِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ، وَاهْدِنِي لِأَحْسَنِ الْأَخْلَاقِ لَا يَهْدِي لِأَحْسَنِهَا إِلَّا أَنْتَ، وَاصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا إِلَّا أَنْتَ، لَكَ بَيْنِي وَبَيْنَكَ، وَالْحَقُّ كُلُّهُ بِيَدَيْكَ، وَالشَّرُّ لَيْسَ إِلَيْكَ، أَنَا بِكَ وَإِلَيْكَ، تَبَارَكْتَ وَتَعَالَيْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ».

"E drejtova fytyrën time nga Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, me besim të pastër, dhe unë nuk jam prej idhujtarëve. Me të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime i përkasin Allahut, Zotit të botëve, i Cili nuk ka ortak. Për këtë jam i urdhëruar dhe unë jam prej muslimanëve. O Allah, Ti je Sunduesi, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje. Ti je Zoti im dhe unë jam rob i Yt. I kam bërë

¹ Buhariu (1/181) nr. 744 dhe Muslimi (1/419) nr. 598.

² Muslimi nr. 399 dhe autorët e katër Suneneve: Ebu Davudi nr. 775, Tirmidhiu nr. 243, Ibn Maxhe nr. 806 dhe Nesaiu nr. 899. Shih: Sahih et-Tirmidhi (1/77) dhe Sahih Ibn Maxhe (1/135).

padrejtësi vetes sime dhe i pranoj gjynahet e mia, prandaj m'i fal të gjitha gjynahet, sepse, në të vërtetë, nuk i fal gjynahet askush tjetër përveç Teje. Më udhëzo drejt moralit më të mirë, pasi nuk udhëzon drejt tij askush tjetër përveç Teje dhe largo nga unë të këqijat e tij, pasi nuk i largon ato askush tjetër përveç Teje. Ty të përgjigjem dhe në shërbimin Tënd jam. E gjithë e mira është në Duart e Tua, ndërsa e keqja nuk të atribuhet Ty. Unë ekzistoj përmes Teje dhe te Ti kthehem. I Bekuar dhe i Lartësuar je Ti, të kërkoj falje dhe te Ti pendothem!"¹

«اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرَائِيلَ، وَمِيكَائِيلَ، وَإِسْرَافِيلَ، فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ، اهْدِنِي لِمَا اخْتُلِفَ فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ إِنَّكَ تَهْدِي مَنْ تَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ».

"O Allah, Zoti i Xhebrailit, i Mikailit dhe i Israfilit, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Njohësi i së dukshmes e i së padukshmes, o Ti do të gjykosh mes robërve të Tu për kundërshtitë që kanë pasur, më udhëzo, me lejen Tënde, tek e vërteta për të cilën ka pasur kundërshti! Vërtet, Ti udhëzon atë që do në rrugën e drejtë!"²

«اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَسُبْحَانَ اللَّهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا».

¹ Transmetoi Muslimi (1/534) nr. 771.

² Transmetoi Muslimi (1/534) nr. 770.

"Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi. Lavdërimi i takon Allahut pamasë, lavdërimi i takon Allahut pamasë, lavdërimi i takon Allahut pamasë. I Lartësuar qoftë Allahu në mëngjes dhe në mbrëmje."

Tri herë.

«أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ: مِنْ نَفْخِهِ، وَنَفْثِهِ، وَهَمْزِهِ».

"I mbështetem Allahut të më mbrojë nga shejtani: nga yshtja e tij, nga cytja e tij dhe nga ngacmimi i tij"¹

«اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ، أَنْتَ نُورُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قَيِّمُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، [وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ] [وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ] [وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مَلِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ] [وَلَكَ الْحَمْدُ] [أَنْتَ الْحَقُّ، وَوَعْدُكَ الْحَقُّ، وَقَوْلُكَ الْحَقُّ، وَلِقَاؤُكَ الْحَقُّ، وَالْجَنَّةُ حَقٌّ، وَالنَّارُ حَقٌّ، وَالنَّبِيُّونَ حَقٌّ، وَمُحَمَّدٌ ﷺ حَقٌّ، وَالسَّاعَةُ حَقٌّ] [اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَإِلَيْكَ أُنَبِّئُ، وَبِكَ خَاصَمْتُ، وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ. فَاعْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ، وَمَا أَخَّرْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ، وَمَا أَعْلَنْتُ] [وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي] [أَنْتَ الْمُقَدِّمُ، وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ] [أَنْتَ إِلَهِي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ]

¹ E transmetuan Ebu Davudi (1/203) nr. 764, Ibn Maxhe (1/265) nr. 807 dhe Ahmedi (4/85) nr. 16739. Shuajb Arnauti në recensimin e Musnedit thotë: "Hasen ligajrihi" (i mirë përmes rrugëve të ndryshme), kurse Abdulkadir Arnauti në verifikimin e librit "El-Kelim et-Tajib" të Ibn Tejmijs, nr. 78, thotë: "Ky hadith është i saktë nëpërmjet dëshmime të tij". E ka cekur gjithashtu shejh Albani në "Sahih el-Kelim et-Tajib" nr. 62. E ka transmetuar edhe Muslimi nga Ibn Umeri, me tekst të ngjashëm bashkë me një ngjarje (1/420) nr. 601.

[وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ].

"O Allah, Ty të takon lavdia.¹ Ti je drita e qiejve dhe e Tokës dhe e atyre që gjenden në to. Ty të takon lavdia, Ti je Mbajtësi i qiejve dhe i Tokës dhe i atyre që gjenden në to. Ty të takon lavdia, Ti je Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe i atyre që gjenden në to. Ty të takon lavdia, i Yti është sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe i atyre që gjenden në to. Ty të takon lavdia, Ti je Sunduesi i qiejve dhe i Tokës. Ty të takon lavdia, Ti je i Vërteti, premtimi Yt është i vërtetë, fjala Jote është e vërtetë, takimi me Ty është i vërtetë, Xheneti është i vërtetë, Zjarri është i vërtetë, pejgamberët janë të vërtetë, Muhamedi është i vërtetë dhe Kiameti është i vërtetë. O Allah, Ty të jam dorëzuar, te Ti mbështetem, Ty të besoj, te Ti kthehem me pendim, me ndihmën Tënde armiqësohem dhe te Ti drejtohem për gjykim. M'i fal mëkatet e mia të hershme dhe të mëvonshme, ato që i kam fshehur dhe ato që i kam bërë haptazi, si dhe ato për të cilat Ti je më i Dijshëm se unë! Ti je Pararenditësi dhe Ti je Praparenditësi. Askush pos Teje s'ka të drejtë të adhurohet. Ti je i Zoti im. Askush pos Teje s'ka të drejtë të adhurohet. Nuk ka

¹ Profeti (paqja qoftë mbi të!) e thoshte këtë kur ngrihej për namaz nate (tehexhud).

lëvizje e as forcë përveçse me Allahun."¹

17. Duaja që thuhet kur jemi në ruku

«سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ».

"I Pastër nga të metat është Zoti im
Madhështori."

Tri herë.²

«سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي».

"I Pastër je, o Allah! Zoti ynë! Ty të thurim lavde!
O Allah, më fal mua!"³

«سُبُّوحٌ، قُدُّوسٌ، رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ».

"I Dëlrë nga çdo mangësi, i Shenjtë, Zoti i
melekëve dhe Xhibrilit!"⁴

«اللَّهُمَّ لَكَ رَكَعْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَلَكَ أَسَلَمْتُ، خَشَعَ لَكَ سَمْعِي، وَبَصَرِي،
وَمُخِّي، وَعَظْمِي، وَعَصِي، [وَمَا اسْتَقَلَّتْ بِهِ قَدَمِي].»

"O Allah, për Ty jam përkulur, tek Ti kam besuar
dhe Ty të jam dorëzuar. Ty të janë përrulur dëgjimi
im, shikimi im, truri im, eshtrat e mia, dejt (indet) e

¹ Buhariu me Fet'hul Bari (3/3), (11/116) dhe (13/371) nr. 423, 465, 1120, 6317, 7385, 7442 dhe 7499, dhe Muslimi shkurtimisht ngjashëm me të (1/532) nr. 769.

² E transmetuan autorët e Suneneve dhe Ahmedi: Ebu Davudi nr. 870, Tirmidhiu nr. 262, Nesaiu nr. 1007, Ibn Maxhe nr. 897 dhe Ahmedi nr. 3514. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (1/83).

³ Buhariu (1/ 99) nr. 794 dhe Muslimi (1/ 350) nr. 484.

⁴ Muslimi (1/ 353) nr. 487, dhe Ebu Davudi (1/ 230) nr. 872.

mi dhe gjithçka që mbajnë këmbët e mia."¹

«سُبْحَانَ ذِي الْجَبَرُوتِ، وَالْمَلَكُوتِ، وَالْكِبَرِيَاءِ، وَالْعَظَمَةِ».

"I Dëlrë nga të metat është Ai që posedon pushtetin, sundimin, krenarinë dhe madhësitinë!"²

18. Lutja e ngritjes nga rukuja

«سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ».

"Allahu e dëgjon lavdinë e atij që i bën lavde!"³

«رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ، حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ».

"Zoti ynë, Ty të takon lavdia e panumërt, e dëlrë nga syfaqësia dhe e pafundme."⁴

«مِلْءَ السَّمَوَاتِ وَمِلْءَ الْأَرْضِ، وَمَا بَيْنَهُمَا، وَمِلْءَ مَا شِئْتَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدُ. أَهْلُ الشَّانِ وَالْمَجْدِ، أَحَقُّ مَا قَالَ الْعَبْدُ، وَكُنَّا لَكَ عَبْدُ، اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ».

"Sa të mbushet hapësira e qiejve dhe e Tokës dhe e gjithçkaje që gjendet midis tyre, si edhe po aq sa çfarëdo tjetër që dëshiron Ti pas kësaj. O i Denji për lavdërim dhe lavdi! Fjala më e drejtë që e thotë robi, dhe të gjithë ne jemi robër të Tu, është: O Allah,

¹ Transmetuan Muslimi (1/ 534) nr. 771 dhe të katër autorët e suneneve përveç Ibn Maxhes: Ebu Davudi nr. 760 dhe 761, Tirmidhiu nr. 3421 dhe Nesaiu nr. 1049, ndërsa teksti mes kllapave është i Ibn Huzejmes nr. 607 dhe Ibn Hibbanit nr. 1901.

² Ebu Davudi (1/230) nr. 873, Nesaiu nr. 1131 dhe Imam Ahmedi nr. 23980, zinxhiri i tij është i mirë.

³ Buhariu me Fet'hul Bari (2/282), nr. 796.

⁴ Buhariu me Fet'hul Bari (2/284), nr. 796.

atë që jep Ti askush nuk e pengon dhe atë që nuk e jep Ti askush nuk e mundëson. Askujt nuk mund t'i bëjë dobi pasuria në raport me Ty."¹

19. Duaja (lutja) e sexhdes

«سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى»

"I Pastër nga të metat është Zoti im, më i Larti"
Tri herë.²

«سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي.»

"I Pastër nga të metat je, o Allah! Zoti ynë! Ty të thur lavde! O Allah, më fal!"³

«سُبُّوحٌ، قُدُّوسٌ، رَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ.»

"I Dëlrë nga çdo mangësi, i Shenjtë, Zoti i melekëve dhe Xhibrilit!"⁴

«اللَّهُمَّ لَكَ سَجَدْتُ وَبِكَ آمَنْتُ، وَلَكَ أَسْلَمْتُ، سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ، وَصَوَّرَهُ، وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ، تَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ.»

"O Allah, Ty të kam bërë sexhde, tek Ti kam besuar dhe Ty të jam dorëzuar. Fytyra ime i bëri sexhde Atij që e ka krijuar, e ka formësuar dhe që ia ka hapur dëgjimin dhe shikimin. I Lartësuar është

¹ Muslimi (1/ 346) nr. 477.

² E transmetuan autorët e Suneneve dhe Ahmedi: Ebu Davudi nr. 870, Tirmidhiu nr. 262, Nesaiu nr. 1007, Ibn Maxhe nr. 897, Ahmedi nr. 3514. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (1/83).

³ Transmetuan Buhariu nr. 794 dhe Muslimi nr. 484, ka kaluar më lart nr. 34.

⁴ Muslimi (1/533) nr. 487, dhe Ebu Davudi nr. 872 ka kaluar më lart nr. 35.

Allahu, më i Miri i krijues!"¹

«سُبْحَانَ ذِي الْجَبَرُوتِ، وَالْمَلَكُوتِ، وَالْكِبَرِيَاءِ، وَالْعَظَمَةِ».

"I Dëlrë nga të metat është Ai që posedon pushtetin, sundimin, krenarinë dhe madhësitinë!"²

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذُنُوبِي كُلَّهُ: دِقَّةَ وَجَلِّهِ، وَأَوَّلَهُ وَآخِرَهُ، وَعَظَمَاتِهِ وَسِرَّهُ».

"O Allah, m'i fal të gjitha gjynahet: të vogla e të mëdha, të kaluara e të ardhme, të bëra haptas dhe ato fshehtas!"³

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سَخَطِكَ، وَبِمُعَافَاتِكَ مِنْ عُقُوبَتِكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ، لَا أَحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ، أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَى نَفْسِكَ».

"O Allah, unë kërkoj të më mbrosh nëpërmjet kënaqësisë Tënde nga hidhërimi Yt, kërkoj të më mbrosh nëpërmjet faljes Tënde nga dënimi Yt dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga Ti. Unë nuk mund t'i numëroj lavdërimet ndaj Teje. Ti je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën Tënde!"⁴

20. Lutja e uljes ndërmjet dy sexhdeve

«رَبِّ اغْفِرْ لِي، رَبِّ اغْفِرْ لِي».

¹ Muslimi (1/534) nr. 771 dhe të tjerë.

² Ebu Davudi (1/230) nr. 873, Nesaiu nr. 1131 dhe Imam Ahmedi nr. 23980. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Ebu Davudit (1/166), shiko referencat nr. 37.

³ Muslimi (1/ 230) nr. 483.

⁴ Muslimi (1/352) nr. 486.

"O Zot, më fal! O Zot, më fal!"¹

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَاجْبُرْنِي، وَعَافِنِي، وَارْزُقْنِي، وَارْقُعْنِي».

"O Allah, më fal, më mëshiro, më udhëzo, më përmirëso, më jep shëndet, më furnizo me të mira dhe më lartëso!"²

21. Lutja e sexhdes së leximit

«سَجَدَ وَجْهِي لِلَّذِي خَلَقَهُ، وَشَقَّ سَمْعَهُ وَبَصَرَهُ بِحَوْلِهِ وَقُوَّتِهِ، فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ».

"Fytyra ime i bëri sexhde Atij që e ka krijuar dhe ia ka hapur dëgjimin dhe shikimin me pushtetin dhe fuqinë e Tij. Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!"

(El-Muminun, 14)³

«اللَّهُمَّ اكْتُبْ لِي بِهَا عِنْدَكَ أَجْرًا، وَصَعْ عَنِّي بِهَا وَزْرًا، وَاجْعَلْهَا لِي عِنْدَكَ ذُخْرًا، وَتَقَبَّلْهَا مِنِّي كَمَا تَقَبَّلْتَهَا مِنْ عَبْدِكَ دَاوُدَ».

"O Allah, më shkruaj me anë të saj tek Ti një shpërblim. Më largo me anë të saj një gjynah. Bëje atë për mua thesar tek Ti dhe pranoje prej meje

¹ Ebu Davudi (1/231) nr. 874, Ibn Maxhe nr. 897. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/148).

² E transmetuan autorët e Suneneve përveç Nesaiut: Ebu Davudi (1/231) nr. 850, Tirmidhiu nr. 284 dhe 285, Ibn Maxhe nr. 898. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (1/90) dhe Sahihu Ibn Maxhe (1/148).

³ Tirmidhiu (2/474) nr. 3425, Ahmedî (6/30) nr. 24022 dhe Hakimi, i cili e ka cilësuar të saktë dhe me të është pajtuar edhe Dhehebiu (1/220), ndërsa shtesa është e tij.

ashtu siç e pranove nga robi Yt, Davudi!"¹

22. Teshehudi

«الْحَيَّاتُ لِلَّهِ، وَالصَّلَوَاتُ، وَالطَّيِّبَاتُ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ، السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ».

"Nderimet, lutjet dhe punët e mira janë për Allahun! Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, si dhe mëshira e bekimet e Allahut! Paqja qoftë me ne dhe me robërit e drejtë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij."²

23. Salavatet për Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!) pas teshehudit

«اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ، وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ، وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ».

"O Allah, lavdëroje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar! O Allah, begatoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, vërtet Ti je i Lavdishëm

¹ Tirmidhiu (2/473) nr. 579 dhe Hakimi, i cili e ka vlerësuar të saktë dhe me të është pajtuar dhe Dhehebiu (1/219).

² Buhariu me Fet'hul Barin (2/311) nr. 831 dhe Muslimi (1/301) nr. 402.

dhe i Madhëruar!"¹

«اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى أَزْوَاجِهِ وَذُرِّيَّتِهِ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مُجِيدٌ».

"O Allah, lavdëroje Muhamedin, bashkëshortet dhe pasardhësit e tij, ashtu siç lavdërove familjen e Ibrahimit, dhe begatoje Muhamedin, bashkëshortet dhe pasardhësit e tij, ashtu siç begatove familjen e Ibrahimit, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar!"²

24. Lutja pas teshehudit të fundit para selamit

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ».

"O Allah! Më ruaj nga dënimi i varrit! Më ruaj nga dënimi i Xhehenemit! Më ruaj nga sprovat gjatë jetës e pas vdekjes! Më ruaj nga sherri i sprovës së mesihut Dexhal!"³

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْمَأْثَمِ وَالْمَغْرَمِ».

"O Allah! Më ruaj nga dënimi i varrit! Më ruaj nga

¹ Buhariu me Fethul-Barin (6/ 408) nr. 3370 dhe Muslimi nr. 406.

² Buhariu me Fethul Barin (6/407) nr. 3369 dhe Muslimi (1/306) nr. 407, ndërsa teksti është i Muslimit.

³ Buhariu (2/102) nr. 1377 dhe Muslimi (1/412) nr. 588, ndërsa teksti është i Muslimit.

sprova e mesihut Dexhal! Më ruaj nga sprovat gjatë jetës e pas vdekjes! O Allah! Më ruaj nga mëkati dhe borxhi!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا، وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ، فَاعْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي، إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ».

"O Allah, unë i kam bërë shumë padrejtësi vetvetes. Askush përveç Teje nuk i fal gjynahet, ndaj më fal mua me mirësinë Tënde dhe më mëshiro, se Ti je Falës dhe Mëshirues!"²

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ، وَمَا أَخَّرْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ، وَمَا أَعْلَنْتُ، وَمَا أَسْرَفْتُ، وَمَا أَنْتَ أَعْلَمُ بِهِ مِنِّي، أَنْتَ الْمُقَدِّمُ، وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ».

"O Allah, m'i fal mëkatet e kaluara dhe të tashmet, ato që i kam fshehur dhe ato që i kam shfaqur, ato ku kam tepruar dhe ato që Ti i di më mirë se unë! Ti çon përpara kë të duash dhe lë pas kë të duash, nuk ka zot tjetër përveç Teje!"³

«اللَّهُمَّ أَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ، وَشُكْرِكَ، وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ».

"O Allah! Më ndihmo të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë!"⁴

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْبُخْلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُبْنِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ أَنْ أُرَدَّ إِلَى

¹ Transmetuan Buhariu (1/202) nr. 832 dhe Muslimi (1/412) nr. 587.

² Buhariu (8/168) nr. 834 dhe Muslimi (4/2078) nr. 2705.

³ Muslimi (1/534) nr. 771.

⁴ Ebu Davudi (2/86) nr. 1522, dhe Nesaiu (3/53) nr. 2302. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Ebu Davudit (1/284).

أَرَدَلِ الْعُمْرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الدُّنْيَا وَعَذَابِ الْقَبْرِ.

"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga koprracia, kërkoj mbrojtjen Tënde nga frikakakllëku, kërkoj mbrojtjen Tënde nga kthimi në moshën më të thyer dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga sprova e kësaj bote dhe dënimi i varrit!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْحَيَّةَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ».

"O Allah, e kërkoj prej Teje Xhenetin dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga Zjarri!"²

«اللَّهُمَّ بِعِلْمِكَ الْغَيْبَ وَقُدْرَتِكَ عَلَى الْخَلْقِ أَحْيِي مَا عَلِمْتَ الْحَيَاةَ خَيْرًا لِي، وَتَوَفَّنِي إِذَا عَلِمْتَ الْوَفَاةَ خَيْرًا لِي، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ حَشِيَّتَكَ فِي الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ، وَأَسْأَلُكَ كَلِمَةَ الْحَقِّ فِي الرِّضَا وَالْعَصَبِ، وَأَسْأَلُكَ الْقَصْدَ فِي الْغِنَى وَالْفَقْرِ، وَأَسْأَلُكَ نَعِيمًا لَا يَنْقُذُ، وَأَسْأَلُكَ قُرَّةَ عَيْنٍ لَا تَنْقَطِعُ، وَأَسْأَلُكَ الرِّضَا بَعْدَ الْقَضَاءِ، وَأَسْأَلُكَ بَرْدَ الْعَيْشِ بَعْدَ الْمَوْتِ، وَأَسْأَلُكَ لَذَّةَ النَّظَرِ إِلَى وَجْهِكَ، وَالشَّوْقَ إِلَى لِقَائِكَ فِي غَيْرِ صَرَاءٍ مُضِرَّةٍ، وَلَا فِتْنَةٍ مُضِلَّةٍ، اللَّهُمَّ زَيِّنَا بِزِينَةِ الْإِيمَانِ، وَاجْعَلْنَا هُدَاةً مُهْتَدِينَ».

"O Allah, me dijen Tënde për të fshehtën dhe fuqinë Tënde mbi krijesat, më bëj të jetoj për sa kohë që e di se jeta është më e mirë për mua dhe më bëj të vdes kur e di se vdekja është më e mirë për mua! O Allah, kërkoj prej Teje frikën ndaj Teje në vetmi dhe në publik, kërkoj prej Teje të them fjalën e së vërtetës në kënaqësi dhe në zemërim, kërkoj

¹ Buhariu me Fet'hul Bari (6/35) nr. 2822 dhe 6390.

² Ebu Davudi nr. 792 dhe Ibn Maxhe nr. 910. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/328).

prej Teje maturinë në pasuri dhe në varfëri, kërkoj prej Teje begati që nuk shteron, kërkoj prej Teje lumturi që nuk ndërpritet, kërkoj prej Teje kënaqësinë pas caktimit, kërkoj prej Teje qetësinë e jetës pas vdekjes, kërkoj prej Teje kënaqësinë e shikimit në Fytyrën Tënde dhe mallin për takimin me Ty, pa fatkeqësi të dëmshme dhe pa sprovë devijuese! O Allah, na zbukuro me stolinë e besimit dhe na bëj udhërrëfyes të udhëzuar!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ يَا اللَّهُ بِأَنَّكَ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الصَّمَدُ الَّذِي لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ، وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ، أَنْ تَغْفِرَ لِي ذُنُوبِي إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ».

"O Allah, unë Të lutem Ty, o Allah, ngase Ti je i Vetmi, i Pashoqi, Absoluti, i Cili as nuk ka lindur dhe as nuk është i lindur, dhe të Cilit askush nuk i është i barabartë, të m'i falësh gjynahet e mia! Vërtet, Ti je Falësi, Mëshirëploti!"²

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِأَنَّ لَكَ الْحَمْدَ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ، الْمَتَّانُ، يَا بَدِيعَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ، يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ».

"O Allah, kërkoj prej Teje, sepse Ty të takon falënderimi, askush pos Teje s'ka të drejtë të adhurohet, i Vetëm, Ti nuk ke ortak, Bamirësi, o

¹ Nesaiu (3/54) (55) nr. 1304, dhe Ahmedi (4/364) nr. 21666. Albani e ka vlerësuar të saktë në "Sahih en-Nesai" (1/281).

² E transmetuan Nesaiu, (3/ 52) nr. 1300 me tekstin e tij, dhe Ahmedi (4/338) nr. 18974, Albani e ka cilësuar të saktë në "Sahih en-Nesai" (1/280).

Krijues i qiejve dhe i Tokës, o Zotërues i Madhështisë dhe i Nderimit, o i Gjallë, o i Përjetshëm! E kërkoj prej Teje Xhenetin dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga Zjarri!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِأَنِّي أَشْهَدُ أَنَّكَ أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ الْأَحَدُ الصَّمَدُ الَّذِي لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ».

"O Allah! Unë të lutem Ty duke dëshmuar se Ti je Allahu, s'ka të adhuruar të denjë përveç Teje, i Vetmi, i Vetëmjaftueshmi, i Cili nuk ka lindur askënd, as nuk është i lindur dhe askush nuk është i barabartë me Të."²

25. Dhikri pas mbarimit të namazit

«أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ»

"Kërkoj falje nga Allahu!"

Tri herë.

«اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ، وَمِنْكَ السَّلَامُ، تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ».

"O Allah! Ti je Paqedhënësi dhe vetëm prej Teje vjen paqja! Ti je i Begatë, o Zotëruesi i madhështisë dhe nderimit!"³

¹ Transmetuan autorët e Suneneve: Ebu Davudi nr. 1495, Tirmidhiu nr. 3544, Ibn Maxhe nr. 3858 dhe Nesaiu nr. 1299. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/329).

² Ebu Davudi (2/ 62) nr. 1493, Tirmidhiu (5/515) nr. 3475, Ibn Maxheja (2/1267) nr. 3857, Nesaiu nr. 1300 me tekstin e tij, dhe Imam Ahmedi nr. 18974. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Nesaiut (1/280). Shih gjithashtu: Sahihun e Ibn Maxhes (2/ 329) dhe Sahihun e Tirmidhiut (3/163).

³ Muslimi (1/414) nr. 591.

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"La ilahe il-laAllahu uahdehu la sherike leh, lehul-mulku ue lehul-ḥamdu ue Huve ala kul-li shej'in kadir."

Tri herë.

اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ.

"O Allah, atë që jep Ti askush nuk e pengon, e atë që nuk e jep Ti askush nuk e jep. Askujt nuk mund t'i bëjnë dobi pasuria dhe pozita në raport me Ty."¹

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَلَا نَعْبُدُ إِلَّا إِيَّاهُ لَهُ التَّعَمُّهُ وَلَهُ الْفَضْلُ وَلَهُ الثَّنَاءُ الْحَسَنُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ».

"S'ka të adhuroar përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. S'ka ndryshim e as fuqi, përveçse me Allahun. S'ka të adhuroar përveç Allahut dhe nuk adhurojmë askënd përveç Tij. E Tija është çdo mirësi, e Tija është çdo vlerë dhe Atij i takon lavdërimi më i mirë. S'ka të adhuroar përveç Allahut, vetëm Atij i përkushtohemi në fenë e drejtë, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë këtë."²

«سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ

"I Patëmeta është Allahu. Lavdia i takon Allahut.

¹ Transmetuan Buhariu (1/255) nr. 844 dhe Muslimi (1/414) nr. 593.

² Muslimi (1/415) nr. 594.

Allahu është më i madhi."

Tridhjetë e tri herë.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

"S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë."¹

{قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝}

Kul huvallāhu eḥad.

Allāhuṣ-ṣamed.

Lem jelim ue lem jūled.

Ue lem jekun lehū kufuven eḥad. (El Ihlas, 1-4)

{قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ۝ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ۝ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ۝ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ۝ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ۝}

Kul e'ūdhu bi-rabbil-feleḵ.

Min sherr-rrī mā ḥaleḵ.

Ue min sherr-rrī ḡāsikin idhā ueḵab.

Ue min sherr-rrin-nef-fāthāti fil-'uḵad

Ue min sherr-rrī ḥāsīdin idhā ḥased.

(El-Felek: 1-5)

{قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ۝ مَلِكِ النَّاسِ ۝ إِلَهِ النَّاسِ ۝ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ۝ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ۝ مِنَ الْخِيفَةِ وَالنَّاسِ ۝}

¹ Muslimi (1/418) me numër (597), ku gjithashtu thuhet: "Atij që e thotë këtë pas çdo namazi, i falen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit."

Kul e'ūdhu bi-rabbin-nās.
 Melikin-nās.
 Ilāhin-nās.
 Min sherr-rril-ues'uāsil-hannās.
 El-ledhī juvesvisu fī şudūrin-nās.
 Minel-xhinneti uen-nās. (En-Nas, 1-6)
 Pas çdo namazi.¹

﴿اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ﴾

All-Ilāhu lā ilāhe il-lā huvel Ḥajjul Kaĵjūm. Lā te'ħudhuhu sinetun ue lā neum. Lehu mā fis-semāvāti ue mā fil-erḍ. Men dhel-ledhī jeshfe'u 'indehū il-lā bi idhnihi. Ja'ëlemu mā bejne ejdihim ue mā ħalfehum, ue lā juḥiṭūne bi shej'in min 'ilmihī il-lā bimā shāe. Uesi'a kursijjuhus-semāvāti uel-erḍa, ue lā je'ūduhu ḥifḍhuhumā ue huvel-'Alijjul-'Aḍhīm.

(El Bekare, 255) Pas çdo namazi.²

¹ Ebu Davudi (2/86) nr. 1523, Tirmidhiu nr. 2903, dhe Nesaiu (3/68) nr. 1335. Shih: Sahih et-Tirmidhi (2/8). Këto tri suret quhen: El-Muav-vidhat. Shih: Fet'hul Bari (9/62).

² "Atë që e lexon atë pas çdo namazi, nuk e pengon të hyjë në Xhenet asgjë përveç vdekjes." Transmetoi Nesaiu në Amel el-jeum uel-lejleh nr.100 dhe Ibn es-Sunni nr.121. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahih el-Xhami (5/339) dhe Silsilat el-Ehadiith es-Sahih (2/697), nr.972.

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ».

"S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdi. Ai jep jetë dhe merr jetë. Ai ka fuqi për çdo gjë."

Dhjetë herë pas namazit të akshamit dhe të sabahut.¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَرِزْقًا طَيِّبًا، وَعَمَلًا مُتَقَبَّلًا».

"O Allah, unë kërkoj prej Teje dituri të dobishme, furnizim të mirë dhe vepër të pranuar!"

بَعْدَ السَّلَامِ مِنْ صَلَاةِ الْفَجْرِ.

Pas selamit nga namazi i sabahut.²

26. Duaja e namazit të istihares

Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) na e mësonte namazin e istihares për çdo gjë, siç na mësonte ndonjë sure kuranore. Ai thoshte:

«إِذَا هَمَّ أَحَدُكُمْ بِالْأَمْرِ فَلْيَرْكَعْ رَكَعَتَيْنِ مِنْ غَيْرِ الْقَرِصَةِ، ثُمَّ لِيَقُلْ:

'Kur ndonjëri prej jush ka ndërmend të bëjë një punë, le t'i falë dy rekate jashtë farzit, pastaj le të thotë:

¹ E shënojnë Tirmidhiu (5/515) nr. 3474 dhe Ahmedi (4/227) nr. 17990. Shih referencat e tij në Zadul Mead (1/300).

² Ibn Maxhe nr. 925 dhe Nesaiu në "Amel el-Jeum uel-Lejleh" nr. 102. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/152) dhe Mexhma ez-Zevaid (10/111), si dhe do të vijë me nr. 95.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْتَخِيرُكَ بِعِلْمِكَ، وَأَسْتَقْدِرُكَ بِقُدْرَتِكَ، وَأَسْأَلُكَ مِنْ فَضْلِكَ الْعَظِيمِ؛ فَإِنَّكَ تَقْدِرُ وَلَا أَقْدِرُ، وَتَعْلَمُ وَلَا أَعْلَمُ، وَأَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ، اللَّهُمَّ إِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ أَنَّ هَذَا الْأَمْرَ - وَيُسَمِّي حَاجَتَهُ - خَيْرٌ لِي فِي دِينِي وَمَعَاشِي وَعَاقِبَةِ أَمْرِي - أَوْ قَالَ: عَاجِلِهِ وَأَجَلِهِ - فَأَقْدِرْهُ لِي وَيَسِّرْهُ لِي ثُمَّ بَارِكْ لِي فِيهِ، وَإِنْ كُنْتَ تَعْلَمُ أَنَّ هَذَا الْأَمْرَ شَرٌّ لِي فِي دِينِي وَمَعَاشِي وَعَاقِبَةِ أَمْرِي - أَوْ قَالَ: عَاجِلِهِ وَأَجَلِهِ - فَاصْرِفْهُ عَنِّي وَاصْرِفْنِي عَنْهُ وَاقْدِرْ لِي الْخَيْرَ حَيْثُ كَانَ، ثُمَّ أَرْضِنِي بِهِ.

"O Allah, me diturinë Tënde kërkoj mbarësi, me fuqinë Tënde kërkoj mundësi dhe kërkoj të mirat e Tua të shumta; sepse Ti ke mundësi, kurse unë nuk kam, Ti di, kurse unë nuk di dhe Ti i di fshehtësitë. O Allah, nëse e di se kjo punë – dhe përmend nevojën e tij – është e mirë për mua, për fenë, jetën dhe të ardhmen time – ose ka thënë: të tashmen dhe të ardhmen –, ma mundëso këtë, ma lehtëso, e më pas më beko në të. E, nëse e di se kjo punë është e keqe për mua, për fenë, jetën dhe të ardhmen time – ose ka thënë: të tashmen dhe të ardhmen –, largoje atë prej meje dhe mua prej saj, ma cakto të mirën, kudo që të jetë, pastaj më bëj të kënaqur me të!"¹

Nuk bëhet pishman ai që i kërkon Krijuesit zgjedhjen e duhur, këshillohet me njerëzit besimtarë dhe vepron me maturi në çështjen e tij, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë:

¹ Buhariu (7/ 162) nr. 1162.

﴿...وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ...﴾.

"...dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. E kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu..."¹

27. Dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes

"Elḥamdu lil-lāhi uaḥdeh, ueṣ-ṣalātu ues-selāmu 'alā men lā nebijje ba'deh."²

(Çdo lavdërim i takon vetëm Allahut, ndërsa salavatet dhe selamet qofshin për atë pas të cilit nuk ka profet tjetër.)

"E'ūdhu bil-lāhi minesh-shejtānirr-rraxhīm."

(Lus Allahun të më mbrojë prej shejtanit të mallkuar!)

﴿اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ﴾

All-llāhu lā ilāhe il-lā huvel Ḥajjul Kaḥjūm. Lā

¹ Ali Imran: 159.

² Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Të ulem me një grup njerëzish që përmendin Allahun e Lartësuar nga namazi i sabahut derisa të lindë dielli është më e dashur për mua sesa të liroj katër (robër) prej pasardhësve të Ismailit, si dhe të ulem me një grup njerëzish që përmendin Allahun nga namazi i ikindisë derisa të perëndojë dielli është më e dashur për mua sesa të liroj katër (robër)." Transmetoi Ebu Davudi nr. 3667. Albani e ka vlerësuar si të gradës së mirë në "Sahih Ebu Davud" (2/698).

te'ħudhuhu sinetun ue lā neum. Lehu mā fis-semāvāti ue mā fil-erḍ. Men dhel-ledhī jeshfe'u 'indehū il-lā bi idhnihi. Ja'ëlemu mā bejne ejdīhim ue mā ħalfehum, ue lā juħiṭūne bi shej'in min 'ilmihī il-lā bimā shāe. Uesi'a kursijjuhus-semāvāti uel-erḍa, ue lā je'ūduhu ħifḍhuhumā ue huvel-'Alijjul-'Aḥīm. (El Bekare, 255).¹

{قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝}

Kul huvallāhu eħad.

Allāhuṣ-ṣamed.

Lem jelid ue lem jūled.

Ue lem jekun lehū kufuven eħad. (El Ihlas, 1-4)

{قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ۝ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ۝ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ۝ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ۝ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ۝}

Kul e'ūdhu birabbil-feleḵ.

Min sherr-rrī mā ħaleḵ.

Ue min sherr-rrī gāsikin idhā ueḵab.

Ue min sherr-rrin-neffāthāti fil-'uḵad.

Ue min sherr-rrī ḥāsidin idhā ḥased.

(El-Felek: 1-5)

¹ «Ai që e thotë këtë lutje në mëngjes, mbrohet nga xhinët deri në mbrëmje, sikurse ai që e thotë atë në mbrëmje, mbrohet prej tyre deri në mëngjes». E shënon Hakimi (1/562), ndërsa Albani e ka cilësuar të saktë në "Sahih et-Tergib vet-Terhib" (1/273), duke ia atribuar Nesaiut dhe Taberaniut dhe ka thënë: "Zinxhiri i transmetuesve të Taberaniut është i mirë".

﴿قُلْ أَغُوذُ بِرَبِّ الْنَّاسِ ﴿١﴾ مَلِكِ الْنَّاسِ ﴿٢﴾ إِلَهِ الْنَّاسِ ﴿٣﴾ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ
الْخَنَّاسِ ﴿٤﴾ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿٥﴾ مِنَ الْغِنَّةِ وَالنَّاسِ ﴿٦﴾﴾

Kul e'ūdhu birabbīn-nās.

Melikin-nās.

Ilāhin-nās.

Min sherr-rril ues'uāsil hannās.

El-ledhī juvesvisu fī şudūrin-nās.

Minel xhinneti uen-nās. (En-Nas, 1-6) Tri herë.¹

«أَصْبَحْنَا وَأَصْبَحَ الْمَلِكُ لِلَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، رَبِّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَخَيْرَ مَا بَعْدَهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهُ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَسُوءِ الْكِبَرِ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابٍ فِي النَّارِ وَعَذَابٍ فِي الْقَبْرِ».

"E arritëm mëngjesin e tërë sundimi i takon Allahut dhe falënderimet janë vetëm për Allahun. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, i Cili është Një dhe i Pashoq. Atij i përket sundimi dhe falënderimi. Ai për çdo gjë është i Plotfuqishëm. O Zot, unë kërkoj prej Teje mirësinë e kësaj dite dhe mirësinë e asaj që vjen pas saj. Kërkoj të më mbrosh nga e keqja e saj dhe e ditëve të tjera pas saj! O Zot, kërkoj mbrojtjen tënde nga përtacia dhe nga e keqja e pleqërisë së thellë! O Zot, më mbroj nga dënimi i zjarrit të Xhehenemit dhe

¹ "Kush e thotë atë tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje, i mjafton për çdo gjë." E shënon Ebu Davudi (4/322) me numër (5082), dhe Tirmidhiu (5/567) me numër (3575). Shih: Sahihu i Tirmidhiut(3/182).

dënimi i varrit!"¹

Ndërkaq, kur ngrysej, thoshte:

«أَمْسَيْنَا وَأَمْسَى الْمُلْكُ لِلَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، رَبِّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذِهِ اللَّيْلَةِ، وَخَيْرَ مَا بَعْدَهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِي هَذِهِ اللَّيْلَةِ، وَشَرِّ مَا بَعْدَهَا، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَسُوءِ الْكِبَرِ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابٍ فِي النَّارِ وَعَذَابٍ فِي الْقَبْرِ».

"U ngrysem e tërë sundimi i takon Allahut dhe falënderimet janë vetëm për Allahun. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe i Pashoq. Atij i përket sundimi dhe falënderimi. Ai për çdo gjë është i Plotfuqishëm. O Zot, unë kërkoj prej Teje mirësinë e kësaj nate dhe mirësinë e asaj që vjen pas saj. Kërkoj të më mbrosh nga e keqja e saj dhe e netëve të tjera pas saj! O Zot, kërkoj mbrojtjen tënde nga përtacia dhe nga e keqja e pleqërisë së thellë! O Zot, më mbroj nga dënimi i zjarrit të Xhehenemit dhe dënimi i varrit!"²

«اللَّهُمَّ بِكَ أَصْبَحْنَا، وَبِكَ أَمْسَيْنَا، وَبِكَ نَحْيَا، وَبِكَ نَمُوتُ وَإِلَيْكَ النُّشُورُ».

"O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin dhe me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim dhe tek Ti është ringjallja."³

Ndërkaq, kur ngrysej, thoshte:

¹ Muslimi (4/2088) nr. 2723.

² Burimi i mësipërm.

³ Tirmidhiu (5/466) nr. 3391. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/142).

«اللَّهُمَّ بِكَ أَمْسَيْنَا، وَبِكَ أَصْبَحْنَا، وَبِكَ نَحْيَا، وَبِكَ نَمُوتُ، وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ».

"O Allah, me emrin Tënd e arrijmë mbrëmjen dhe me emrin Tënd e arrijmë mëngjesin, me emrin Tënd ngjallemi dhe me emrin Tënd vdesim dhe tek Ti është ringjallja."¹

«اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ، وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ، وَأَبُوءُ بِذَنْبِي فَاغْفِرْ لِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ».

"O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje. Ti më ke krijuar dhe unë jam rob i Ty, do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit Tënd sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar, unë jam mirënjohës² ndaj dhuntive të Tua, i pranoj mëkatet e mia, andaj më fal, sepse mëkatet nuk i fal askush tjetër përveç Teje!"³

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَصْبَحْتُ أُشْهِدُكَ، وَأُشْهِدُ حَمَلَةَ عَرْشِكَ، وَمَلَائِكَتِكَ، وَجَمِيعَ خَلْقِكَ، أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ، وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ».

"O Allah! Unë u gdhiva duke të pasur Ty si dëshmitar, si dhe mbajtësit e arshit Tënd, melekët e

¹ Burimi i mëparshëm.

² Pohoj dhe pranoj.

³ "Ai që i thotë ato me bindje në mbrëmje dhe vdes po atë natë, hyn në Xhenet, po ashtu edhe nëse i thotë në mëngjes." Shënon Buhariu (7/150) me numër (6306).

Tu dhe të gjitha krijesat e Tua për faktin se unë pohoj që Ti je Allahu, se s'ka të adhuroar përveç Teje, se Ti je i Vetëm, i Pashoq, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari Yt."

Katër herë.¹

Ndërkaq, kur ngrysej, thoshte:

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَمْسَيْتُ أَشْهَدُكَ، وَأُشْهَدُ حَمَلَةَ عَرْشِكَ، وَمَلَائِكَتَكَ، وَجَمِيعَ خَلْقِكَ، أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ، وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ».

"O Allah! Unë u ngrysa duke të pasur Ty si dëshmitar, si dhe mbajtësit e arshit Tënd, melekët e Tu dhe të gjitha krijesat e Tua për përveç Teje, se Ti je i Vetëm, i Pashoq, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari Yt."

Katër herë.²

«اللَّهُمَّ مَا أَصْبَحَ بِي مِنْ نِعْمَةٍ أَوْ بِأَحَدٍ مِنْ خَلْقِكَ فَمِنْكَ وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ، فَלَكَ الْحَمْدُ وَلَكَ الشُّكْرُ».

"O Zoti im, në këtë mëngjes, ajo që më është dhënë mua ose ndokujt prej krijesave të Tua nga begatitë është vetëm nga Ti që Je i pashoq; Ty të

¹ "Kush e thotë këtë në mëngjes ose në mbrëmje katër herë, Allahu do ta lirojë atë nga zjarri i Xhehenemit." Transmetoi Ebu Davudi (4/317) nr. 5071, Buhariu në "El-Edeb el-Mufred" nr. 1201, Nesaiu në "Amelul-Jeum uel-Lejleh" nr. 9 dhe Ibn es-Sunni nr. 70. Shejh Ibn Bazi, Allahu e mëshiroftë, e ka vlerësuar të mirë zinxhirin e transmetimit të Nesaiut dhe të Ebu Davudit në "Tuhfetul-Ahjar" (fq. 23).

² Burimi i mëparshëm.

takon lavdërimi dhe falënderimi."¹

Ndërkaq, në mbrëmje thoshte:

«اللَّهُمَّ مَا أَمْسَى بِي مِنْ نِعْمَةٍ أَوْ بِأَحَدٍ مِنْ خَلْقِكَ فَمِنْكَ وَحْدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ،
فَلَكَ الْحَمْدُ وَلَكَ الشُّكْرُ».

"O Zoti im, në këtë mbrëmje, ajo që më është dhënë mua ose ndonjërit prej krijesave të Tua nga begatitë, është vetëm nga Ti që Je i pashoq; Ty të takon lavdërimi dhe falënderimi."²

«اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي بَدَنِي، اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي سَمْعِي، اللَّهُمَّ عَافِنِي فِي بَصَرِي، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكُفْرِ، وَالْفَقْرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ».

"O Zoti im, më dhuro mirëqenie në trupin tim, O Zoti im, më dhuro mirëqenie në dëgjimin tim, O Zoti im, më dhuro mirëqenie në shikimin tim! Nuk ka hyjni tjetër veç Teje! O Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga mosbesimi dhe varfëria, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi i varrit! Nuk ka hyjni tjetër veç Teje!"

Tri herë.³

¹ "Kush e thotë këtë në mëngjes, e ka kryer falënderimin e ditës së tij dhe kush e thotë në mbrëmje, e ka kryer falënderimin e natës së tij." E shënon Ebu Davudi (4/ 318) me nr. (5075), Nesaiu në "Amelul-jeumi uel-lejleh" me nr. (7), Ibn Sunniu me nr. (41) dhe Ibn Hibbani (Meuarid) nr. (2361). Ibn Bazi (Allahu e mëshiroftë!) e ka vlerësuar zinxhirin e tij të transmetimit si të mirë në "Tuhfetul-Ahjar" (fq. 24).

² Burimi i mëparshëm.

³ Ebu Davudi (4/324) nr. 5092, Ahmedi (5/42) nr. 20430, Nesaiu në "Amelul-jeumi uel-lejleh" nr. 22, Ibn Sunniu nr. 69 dhe Buhariu në "Edebul-mufred"

«حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ».

"Më mjafton Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh."

Shtatë herë.¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ: فِي دِينِي وَدُنْيَايَ وَأَهْلِي، وَمَالِي، اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَاتِي، وَآمِنْ رَوْعَاتِي، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَيْنِ يَدَيْ، وَمِنْ خَلْفِي، وَعَنْ يَمِينِي، وَعَنْ شِمَالِي، وَمِنْ قَوْفِي، وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي».

"O Zoti im, kërkoj nga Ti falje dhe mirëqenie në këtë botë dhe në botën tjetër. Zoti im, kërkoj që të më falësh dhe të më dhurosh mirëqenie në fenë time, në jetën time dhe në familjen e pasurisë time! O Zoti im, m'i mbulo të metat e mia dhe më qetëso në çastet trishtuese! O Zot, më ruaj nga para dhe prapa, nga e djathta, nga e majta dhe nga lart; kërkoj mbrojtje përmes madhësisë Sate të mos më përpijë Toka!"²

«اللَّهُمَّ عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، رَبَّ كُلِّ شَيْءٍ وَمَلِيكُهُ،

nr. 701. Senedin e tij e ka vlerësuar të mirë dijetari i madh Ibn Bazi, Allahu e mëshiroftë, në "Tuhfetul-ahjar" (fq. 26).

¹ "Ai që e thotë këtë shtatë herë mëngjes e mbrëmje, Allahu i mjafton për çkado që e brengos nga çështjet e dunjasë dhe të ahiretit." E shënon Ibn es-Sunni me numër (71) si merfu (fjalë të Profetit) dhe Ebu Davudi si mevkuf (fjalë të sahabiut) (4/321) me numër (5081), ndërsa senedin e tij e kanë vlerësuar të saktë Shuajb Arnauti dhe Abdulkadër Arnauti. Shih: Zatul-Mead (2/376).

² Ebu Davudi nr. 5074, Ibn Maxhe nr. 3871. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/332).

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي، وَمِنْ شَرِّ الشَّيْطَانِ وَشَرِّكَهٖ، وَأَنْ
أَقْتَرَفَ عَلَى نَفْسِي سُوءًا، أَوْ أَجْرَهُ إِلَى مُسْلِمٍ».

"O Allah! Ti je Ai që di të fshehtën dhe të dukshmen, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Zoti i gjithçkaje dhe Sunduesi i tyre, dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e vetes sime, nga e keqja e shejtanit dhe e thirrjes së tij për në shirk! Kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos i bëj dëm vetes sime ose ndonjë muslimani!"¹

«بِسْمِ اللَّهِ الَّذِي لَا يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ».

"Me emrin e Allahut, me emrin e të Cilit nuk mund të bëjë dëm asgjë në Tokë e as në qiell. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdijshmi."

Tri herë.²

«رَضِيتُ بِاللَّهِ رَبًّا، وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا، وَبِمُحَمَّدٍ ﷺ نَبِيًّا».

"Jam i kënaqur me Allahun për Zot, me Islamin për fe dhe me Muhamedin për profet."

¹ Tirmidhiu nr. 3392 dhe Ebu Davudi nr. 5067. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/142).

² "Kush e thotë këtë tri herë në mëngjes dhe tri herë në mbrëmje, asgjë nuk mund ta dëmtojë." E shënojnë Ebu Davudi (4/ 323), nr. 5088, Tirmidhiu (5/ 465), nr. 3388, Ibn Maxhe, nr. 3869 dhe Ahmedi, nr. 446. Shih: "Sahihu i Ibn Maxhes" (2/332), ndërsa zinxhirin e tij të transmetimit e ka vlerësuar të mirë dijetari i madh Ibn Bazi, Allahu e mëshiroftë, në "Tuhfetul-Ahjar" (fq. 39).

Tri herë.¹

«يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغِيْثُ أَصْلِحْ لِي شَأْنِي كُلَّهُ وَلَا تَكِلْنِي إِلَى نَفْسِي طَرْفَةَ عَيْنٍ».

"O i Gjallë, o i Përjetshëm, kërkoj ndihmë me mëshirën Tënde! Ma përmirëso tërë gjendjen time dhe mos më lër të mbështetem në veten time as sa një pulitje e syrit!"²

«أَصْبَحْنَا وَأَصْبَحَ الْمُلْكُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذَا الْيَوْمِ: فَتَحَهُ، وَنَصْرَهُ، وَنُورَهُ، وَبَرَكَاتَهُ، وَهُدَاهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِيهِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهُ».

"E arritëm mëngjesin e tërë sundimi i takon Allahut, Zotit të botëve. O Allah, kërkoj prej Teje mirësinë e kësaj dite: çlirimin e saj, fitoren e saj, dritën e saj, begatinë e saj dhe udhëzimin e saj dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga e keqja e saj dhe e keqja e asaj që vjen pas saj."³

Ndërkaq, kur ngrysej, thoshte:

«أَمْسَيْنَا وَأَمْسَى الْمُلْكُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذِهِ اللَّيْلَةِ:

¹ "Kush e thotë këtë tri herë në mëngjes dhe tri herë në mbrëmje është hak (detyrë) për Allahun që ta kënaqë atë në Ditën e Kiametit." Ahmedi (4/337) nr. 18967, Nesaiu në "Amel el-Jeumi uel-Lejleh" nr. 4, Ibn es-Sunni nr. 68, Ebu Davudi (4/318) nr. 1531 dhe Tirmidhiu (5/465) nr. 3389. Ibn Bazi (Allahu e mëshiroftë!) e ka vlerësuar atë hasen (të mirë) në "Tuhfetul-Ahjar" (fq. 39).

² E ka transmetuar Hakimi dhe e ka vlerësuar të saktë dhe me të është pajtuar dhe Dhehebiu (1/545). Shih: 'Sahih et-Tergib uet-Terhib' (1/273).

³ Ebu Davudi (4/322) nr. 5084, e kanë vlerësuar të mirë zinxhirin e tij të transmetimit Shuajb Arnauti dhe Abdulkadër Arnauti në verifikimin e "Zadul Mead" (2/373).

فَتَحَّهَا، وَنَصَرَهَا، وَنُورَهَا، وَبَرَكَتَهَا، وَهَذَاهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِيهَا، وَشَرِّ مَا بَعْدَهَا».

"E arritëm mbrëmjen dhe i tërë sundimi i takon Allahut, Zotit të botëve! O Allah, unë kërkoj prej Teje mirësinë e kësaj nate: çlirimin, fitoren, dritën, begatinë dhe udhëzimin e saj, si dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga e keqja e saj dhe e asaj që vjen pas saj."¹

«أَصْبَحْنَا عَلَى فِطْرَةِ الْإِسْلَامِ، وَعَلَى كَلِمَةِ الْإِخْلَاصِ، وَعَلَى دِينِ نَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ ﷺ، وَعَلَى مِلَّةِ أَبِينَا إِبْرَاهِيمَ، حَنِيفًا مُسْلِمًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ».

"Kemi gdhirë në natyrshmërinë e Islamit, në fjalën e singeritetit, në fenë e pejgamberit tonë Muhamedit (paqja dhe bekimet qofshin mbi të!) dhe në fenë e pastër të babait tonë Ibrahimit, i cili ishte musliman, që nuk ka qenë prej idhujtarëve."²

Ndërkaq, kur ngrysej, thoshte:

«أَمْسَيْنَا عَلَى فِطْرَةِ الْإِسْلَامِ، وَعَلَى كَلِمَةِ الْإِخْلَاصِ، وَعَلَى دِينِ نَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ ﷺ، وَعَلَى مِلَّةِ أَبِينَا إِبْرَاهِيمَ، حَنِيفًا مُسْلِمًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ».

"E arritëm mbrëmjen në natyrshmërinë e Islamit, në fjalën e singeritetit, në fenë e profetit tonë Muhamedit (paqja qoftë mbi të!) dhe në fenë e pastër të babait tonë Ibrahimit, i cili ishte i pastër,

¹ Burimi i mëparshëm.

² Ahmedi (3/406) dhe (407) nr. 15360 dhe 15563, dhe Ibn es-Sunniu në "Amelul-jeumi uel-lejle" nr. 34, shih: Sahihul-Xhami (4/209).

musliman dhe nuk ka qenë prej idhujtarëve."¹

«سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ»

"I Patëmëta është Allahu dhe Atij i takon lavdërimi."

Njëqind herë.²

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ».

"Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Atij i takon sundimi dhe lavdia. Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka."

Dhjetë herë³ ose një herë në rast përtese⁴.

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ».

"Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Atij i takon sundimi dhe lavdia. Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka."

Njëqind herë në mëngjes.⁵

¹ Burimi i mëparshëm.

² "Ai që e thotë këtë njëqind herë mëngjes e mbrëmje, askush nuk do të vijë në Ditën e Kiametit me vepër më të mirë se të atij, përveç atij që ka thënë po aq ose më shumë." Muslimi (4/2071) me numër (2692).

³ Nesaiu në Amel el-Jeum uel-Lejleh nr. 24. Shih: Sahih et-Tergib uet-Terhib (1/272) dhe Tuhfet el-Ahjar të Ibn Bazit (Allahu e mështëiroftë) (fq. 44), dhe shih vlerën e saj në (fq. 146) hadithi nr. 255.

⁴ Ebu Davudi nr. 5077, Ibn Maxhe nr. 3798 dhe Imam Ahmedi nr. 8719. Shih: Sahih et-Tergib uet-Terhib (1/270), Sahih Ebi Davud (3/957), Sahih Ibn Maxhe (2/331) dhe Zadul-Mead (2/377).

⁵ "Kush e thotë këtë njëqind herë në ditë, i vlen sa lirimi i dhjetë robërve, i shkruhen njëqind të mira, i fshihen njëqind të këqija, do të jetë për të mbrojtje nga shejtani atë ditë derisa të ngryset dhe askush nuk ka bërë diçka më të mirë se ajo që ka bërë ai, përveç dikujt që e ka bërë më shumë

«سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ: عَدَدَ خَلْقِهِ، وَرِضَا نَفْسِهِ، وَزِنَةَ عَرْشِهِ، وَمَدَادَ كَلِمَاتِهِ».

"I Patëmeta është Allahu dhe Atij i takon lavdërimi, sa numri i krijesave të Tij, aq sa të jetë Ai i kënaqur, sa pesha e Arshit të Tij dhe sa ngjyra e fjalëve të Tij."

Tri herë në mëngjes.¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَرِزْقًا طَيِّبًا، وَعَمَلًا مُتَقَبَّلًا».

"O Allah, unë kërkoj prej Teje dituri të dobishme, furnizim të mirë dhe vepër të pranuar!"

Kur gdhihet.²

«أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ».

"I kërkoj falje Allahut dhe pendothem tek Ai!"

Njëqind herë në ditë.³

«أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ».

"Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut prej së keqes së çdo gjëje që Ai ka krijuar!"

Tri herë në mbrëmje.⁴

se aq." Buhariu (4/ 95) me numër (3293) dhe Muslimi (4/ 2071) me numër (2691).

¹ Muslimi (4/2090) nr. 2726.

² E transmetuan Ibn Sunniu në Amelul jeum uel lejleh nr. 54 dhe Ibn Maxhe nr. 925, ndërsa zinxhirin e tij të transmetuesve e vlerësuan të mirë Abdulkadir Arnauti dhe Shuaib Arnauti në verifikimin e Zadul Mead 2/375, shikoje më lart me nr. 73.

³ Buhariu me Fet'hul Barin (11/101) nr. 6307 dhe Muslimi (4/2075) nr. 2702.

⁴ "Kush e thotë këtë në mbrëmje tri herë, nuk e dëmton pickimi i insekteve helmuese atë natë." Transmetuan Ahmedi (2/290) nr. 7898, Nesaiu në "Amel el-Jeum uel-Lejleh" nr. 590 dhe Ibn Sunniu nr. 68. Shih: "Sahih et-

«اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَى نَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ».

"O Allah, lavdëroje dhe bekoje profetin tonë Muhamedin!"

Dhjetë herë.¹

28. Lutjet e gjumit

I bashkon shuplakat, fryn në to dhe lexon:

{قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝}

Ḳul huvallāhu eḥad.

Allāhuṣ-ṣamed.

Lem jelid ue lem jūled.

Ue lem jekun lehū kufuven eḥad. (El Ihlas, 1-4)

{قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ۝ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ۝ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ۝ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ۝ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ۝}

Ḳul e'ūdhu birabbil-feleḵ.

Min sherr-rrī mā ḥaleḵ.

Ue min sherr-rrī ḡāsikin idhā ueḵab.

Ue min sherr-rrin-neffāthāti fil-'uḵad.

Ue min sherr-rrī ḥāsidin idhā ḥased.

Tirmidhi" (3/187), "Sahih Ibn Maxhe" (2/266) dhe "Tuhfetul-Ahjar" të Ibn Bazit (fq. 45).

¹ "Ai që dërgon salavate për mua dhjetë herë në mëngjes dhe dhjetë herë në mbremje do të përfshihet në ndërmjetësimin tim në Ditën e Kiametit." E shënon Taberaniu me dy zinxhirë transmetimi, njëri prej të cilëve është i mirë. Shih: Mexhme'u ez-Zevaid (10/120) dhe Sahih et-Tergib uet-Terhib (1/273).

(El-Felek: 1-5)

﴿قُلْ أَعوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ۝ مَلِكِ النَّاسِ ۝ إِلَهِ النَّاسِ ۝ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ۝ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ۝ مِنَ الْغِيْثَةِ وَالنَّاسِ ۝﴾

Kul e'ūdhu birabbīn-nās.

Melikin-nās.

Ilāhin-nās.

Min sherr-rril ues'uāsīl hannās.

El-ledhī juvesvisu fī şudūrin-nās.

Minel xhinneti uen-nās. (En-Nas, 1-6)

Pastaj fërkon me to aq sa mundet nga trupi i tij, duke e nisur nga koka, fytyra dhe pjesa e përparme e trupit. (Këtë e bën tri herë)¹

﴿اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ﴾

All-ilāhu lā ilāhe il-lā huvel Ḥajjul Ḳajjūm. Lā te'ħudhuhu sinetun ue lā neum. Lehu mā fis-semāvāti ue mā fil-erḍ. Men dhel-ledhī jeshfe'u 'indehū il-lā bi idhnihi. Ja'ëlemu mā bejne ejdīhim ue mā ħalfehum, ue lā juḥīṭūne bi shej'in min 'ilmihi il-lā bimā shāe. Uesi'a kursijjuhus-semāvāti uel-erḍa, ue lā je'ūduhu ḥifḍhuhumā ue huvel-'Alijjul-'Aḍhīm. (

¹ Buhariu me Fet'hul Barin (9/62) nr. 5017 dhe Muslimi nr. 2192.

El Bekare, 255)¹

﴿ءَامَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ ءَامَنَ بِاللّٰهِ وَمَلَائِكَتِهِ
وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا
وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ﴿٢٥٥﴾ لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا لَهَا مَا كَسَبَتْ وَعَلَيْهَا مَا
اَكْتَسَبَتْ رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِن نَّسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إَصْرًا كَمَا
هَمَلْتَهُ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ وَاعْفُ عَنَّا وَاعْفِرْ
لَنَا وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿٢٥٦﴾﴾

"Āmenerr-rasūlu bimā unzile ilejhi mirr-
rrabbihi uel-mu'minūn. Kul-lun āmene bil-lāhi ue
melā'iketihī ue kutubihī ue rusulih. Lā nuferr-rriku
bejne eħadin mirr-rrusulih. Ue qālū semi'nā ue
eṭa'nā, ġufrāneke rabbenā ue ilejkel-meşīr.

Lā jukele-lifullāhu nefsen il-lā uus'ahā.

Lehā mā kesebet ue alejhā mektesebet.

Rab-benā lā tuāhidhnā in-nesinā eu aḥṭa'nā.

Rab-benā ue lā taħmil alejnā iṣran kemā
ħameltehū alel-ledhīne min kablinā. Rab-benā ue lā
tuħam-milnā mā lā ṭākate lenā bih. Ua'fu an-nā,
uaġfir lenā, uerħamnā. Ente meulānā fenşurnā alel-
kaumil-kāfirīn." (El Bekare, 285-286)²

﴿بِاسْمِكَ رَبِّي وَضَعْتُ جَنِي، وَبِكَ أَرْفَعُهُ، فَإِنْ أُمِسَّتْ نَفْسِي فَأَرْحَمْهَا، وَإِنْ

¹ "Kushdo që e lexon atë kur bie në shtratin e tij, mbi të do të ketë një ruajtës nga Allahu, dhe nuk i afrohet asnjë shejtan deri në mëngjes." Buhariu në Fethul Bari (4/487) me numër (2311).

² "Atij që i lexon ato të dyja gjatë natës, do t'i mjaftojnë." Buhariu në Fet-hul-Bari (9/94) nr. 4008 dhe Muslimi (1/554) nr. 807.

أَرْسَلْتَهَا فَاحْفَظْهَا، بِمَا تَحْفَظُ بِهِ عِبَادَكَ الصَّالِحِينَ».

"Me emrin Tënd¹, o Zoti im, e shtriva anën time të trupit dhe me Ty e ngre atë. Nëse ma merr shpirtin, mëshiroje atë, e nëse e kthen atë, mbroje ashtu siç i mbron robërit e Tu të mirë!"²

«اللَّهُمَّ إِنَّكَ خَلَقْتَ نَفْسِي وَأَنْتَ تَوَفَّاهَا، لَكَ مَمَاتُهَا وَحَيَاتُهَا، إِنَّ أَحْيَيْتَهَا فَاحْفَظْهَا، وَإِنْ أَمَتَهَا فَاعْفِرْ لَهَا، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَافِيَةَ».

"O Allah, Ti e krijove shpirtin tim dhe Ti ia merr; Ty të përket vdekja dhe jeta e tij. Nëse e lë të jetojë, ruaje atë, e nëse i jep vdekjen, fale atë! O Allah, unë kërkoj nga Ti mirëqenie!"³

«اللَّهُمَّ قِنِي عَذَابَكَ يَوْمَ تَبْعُثُ عِبَادَكَ».

"O Allah, më ruaj⁴ nga dënimi Yt ditën kur do t'i ringjallësh robërit e Tu!"⁵

«بِاسْمِكَ اللَّهُمَّ أَمُوتُ وَأَحْيَا».

¹ "Kur ndonjëri prej jush ngrihet nga shtrati i tij dhe pastaj kthehet në të, le ta shkundë atë me skajin e rrobës së tij tri herë dhe le të përmendë emrin e Allahut, sepse ai nuk e di se çfarë ka zënë vend në të pas tij. E kur të shtrihet, le të thotë:..." - Hadithi. [Kuptimi i shprehjes "me skajin e rrobës së tij": cepi i saj që ndodhet pranë thekëve]. "En-Nihaje fi Garib el-hadith uel-ether."

² Buhariu në Fet'hul-Bari (11/126) nr. 6320 dhe Muslimi (4/2084) nr. 2714.

³ E transmetuan Muslimi (4/2083) nr. 2712 dhe Ahmed i me tekstin e tij (2/79) nr. 5502.

⁴ "Kur Profeti (paqja qoftë mbi të!) dëshironte të flinte, vendoste dorën e djathtë nën faqen e tij, e më pas thoshte: ..." Hadithi.

⁵ Ebu Davudi me tekstin e tij (4/311) nr. 5045 dhe Tirmidhiu nr. 3398. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/143) dhe Sahihu i Ebu Daudit (3/240).

"O Allah! Me emrin Tënd vdes dhe jetoj!"¹.

«سُبْحَانَ اللَّهِ»

"I Patëmeta është Allahu!"

(ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ)،

(Tridhjetë e tri herë)

وَالْحَمْدُ لِلَّهِ

"Uel-ḥamdulil-lah"

(ثَلَاثًا وَثَلَاثِينَ)،

(Tridhjetë e tri herë)

وَاللَّهُ أَكْبَرُ

"Allahu është më i madhi."

(أَرْبَعًا وَثَلَاثِينَ)».

(tridhjetë e katër herë)²

«اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَرَبَّ الْأَرْضِ، وَرَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، رَبَّنَا وَرَبَّ كُلِّ شَيْءٍ، فَالِقَ الْحَبِّ وَالنَّوَى، وَمُنْزِلَ التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ، وَالْفُرْقَانِ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ كُلِّ شَيْءٍ أَنْتَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهِ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الْأَوَّلُ فَلَيْسَ قَبْلَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الْآخِرُ فَلَيْسَ بَعْدَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الظَّاهِرُ فَلَيْسَ فَوْقَكَ شَيْءٌ، وَأَنْتَ الْبَاطِنُ فَلَيْسَ دُونَكَ شَيْءٌ، اقْضِ عَنَّا الدَّيْنَ وَأَغْنِنَا مِنَ الْفَقْرِ».

¹ Buhariu në Fet'hul-Bari (11/113) nr. 6324 dhe Muslimi (4/2083) nr. 2711.

² «Kush e thotë këtë kur bie në shtratin e tij, është më e mirë për të sesa një shërbëtor.» Buhariu me Fet'hul Barin (7/71) nr. 3705 dhe Muslimi (4/2091) nr. 2726.

"O Allah, Zoti i shtatë qiejve, Zoti i Tokës dhe Zoti i Arshit të Madh! O Zoti ynë dhe Zoti i gjithçkaje! O Zbërthyes i farës dhe i bërthamës! O Ti që ke zbritur Teuratin, Inxhilin dhe Furkanin (Kuranin)! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e çdo gjëje që Ti e ke nën sundimin Tënd të plotë. O Allah, Ti je i Pari dhe para Teje nuk ka asgjë, Ti je i Fundit dhe pas Teje nuk ka asgjë. Ti je i Dukshmi dhe mbi Ty nuk ka asgjë, Ti je i Fshehti dhe përtej Teje nuk ka asgjë. Na i shlyej borxhet dhe na shpëto nga varfëria!"¹

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَنَا وَسَقَانَا، وَكَفَانَا، وَأَوَانَا، فَكَمْ مِمَّنْ لَا كَافِيَ لَهُ وَلَا مُؤَوِّي».

"Lavdërimi i takon Allahut që na ushqueu dhe na dha të pimë, na mjaftoi dhe na strehoi, sa e sa njerëz nuk kanë kush t'u mjaftojë dhe as kush t'i strehojë."²

«اللَّهُمَّ عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ، رَبَّ كُلِّ شَيْءٍ وَمَلِيكُهُ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي، وَمِنْ شَرِّ الشَّيْطَانِ وَشَرِّكَ، وَأَنْ أَقْتَرِفَ عَلَى نَفْسِي سُوءًا، أَوْ أَجْرَهُ إِلَى مُسْلِمٍ».

"O Allah! Ti je Ai që di të fshehtën dhe të dukshmen, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Zoti i gjithçkaje dhe Sunduesi i tyre. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e vetes sime, nga e keqja e shejtanit dhe e thirrjes së tij për në shirk!

¹ Muslimi (4/2084) nr. 2713.

² Muslimi (4/2085) nr. 2715.

Kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos i bëj dëm vetes sime ose ndonjë muslimani!"¹

«يَقْرَأُ (الم) تَنْزِيلَ السَّجْدَةِ، وَتَبَارَكَ الَّذِي بِيَدِهِ الْمُلْكُ».

"Këndon suren 'Elif Lam Mim (Tenzil - Sexhde)' dhe suren 'Tebarakel-ledhë bijedihil mulk'"².

«اللَّهُمَّ أَسَلَمْتُ نَفْسِي إِلَيْكَ، وَفَوَّضْتُ أَمْرِي إِلَيْكَ، وَوَجَّهْتُ وَجْهِي إِلَيْكَ، وَأَلْجَأْتُ ظَهْرِي إِلَيْكَ، رَغْبَةً وَرَهْبَةً إِلَيْكَ، لَا مَلْجَأَ وَلَا مَنْجَا مِنْكَ إِلَّا إِلَيْكَ، آمَنْتُ بِكِتَابِكَ الَّذِي أَنْزَلْتَ، وَبِرَسُولِكَ الَّذِي أَرْسَلْتَ».

"O Allah³, Ty ta kam dorëzuar veten time, tek Ti e kam lënë çështjen time, nga Ti e kam kthyer fytyrën time dhe tek Ti e kam mbështetur shpinën time, me shpresë dhe frikë te Ti. Nuk ka strehim dhe as shpëtim prej Teje, përveçse te Ti. Kam besuar në Librin Tënd që ke zbritur dhe në Profetin Tënd që ke dërguar."⁴

29. Lutja kur rrotullohemi natën në shtrat.

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ، رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الْعَزِيزُ الْغَفَّارُ».

¹ Ebu Davudi (4/317) nr. 5067 dhe Tirmidhiu nr. 3629. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/142).

² Tirmidhiu nr. 3404 dhe Nesaiu në Amel el-jeum uel-lejleh nr. 707. Shih: Sahih el-Xhami (4/255).

³ "Kur të biesh në shtrat, merr abdes si për namaz, pastaj shtrihu në krahun e djathtë e më pas thuaj: ..." Hadithi.

⁴ Ai (paqja qoftë mbi të!) i tha atij që e tha këtë lutje: «Nëse vdes, ke vdekur në natyrshmëri». Buhariu në Fet'hul-Bari (11/113) nr. 6313 dhe Muslimi (4/2081) nr. 2710.

"Nuk ka të adhurar tjetër përveç Allahut, të Vetmit, Mposhtësit, Zotit të qiejve dhe të Tokës dhe çfarë ka ndërmjet tyre, të Plotfuqishmit, Falësit të Madh."¹

30. Lutja kur trembemi në gjumë dhe ndiejmë vetmi

«أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ غَضَبِهِ وَعِقَابِهِ، وَشَرِّ عِبَادِهِ، وَمِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ وَأَنْ يَحْضُرُونِ».

"Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut prej zemërimit dhe ndëshkimit të Tij, prej së keqes së robërve të Tij, prej ngacmimeve të shejtanëve dhe nga prania e tyre pranë meje!"²

31. Çfarë duhet të bëjmë kur shohim ëndërr?

"Pështyjmë lehtë majtas, tri herë."³

"Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga shejtani dhe nga e keqja e ëndrrës që kemi parë, tri herë."⁴

"Të mos ia tregojmë askujt ëndrrën."⁵

¹ Këtë e themi kur rrotullohemi nga njëri krah në tjetrin gjatë natës. Transmetoi Hakimi, dhe e vlerësoi të saktë dhe Dhehebiu është pajtuar me të (1/540). E ka transmetuar edhe Nesaiu në "Amel el-Jeum uel-Lejleh" nr. 202 dhe Ibn es-Sunniu nr. 757. Shih: "Sahih el-Xhami" (4/213).

² Ebu Davudi (4/12) nr. 3893 dhe Tirmidhiu nr. 3528. Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/171).

³ Muslimi (4/1772) nr. 2261.

⁴ Muslimi (4/1772) (1773) nr. 2261 dhe 2262.

⁵ Muslimi (4/1772) nr. 2261 dhe 2263.

"Ndërrojmë krahun në të cilin ishim duke fjetur."¹

"Çohemi dhe falemi, nëse kemi dëshirë."²

32. Duaja e kunutit të vitrit

«اللَّهُمَّ اهْدِنِي فِيمَنْ هَدَيْتَ، وَعَافِنِي فِيمَنْ عَافَيْتَ، وَتَوَلَّنِي فِيمَنْ تَوَلَّيْتَ، وَبَارِكْ لِي فِيمَا أَعْطَيْتَ، وَقِنِي شَرَّ مَا قَضَيْتَ؛ فَإِنَّكَ تَقْضِي وَلَا يُقْضَى عَلَيْكَ، إِنَّهُ لَا يَدُلُّ مَنْ وَالَيْتَ، [وَلَا يَعِزُّ مَنْ عَادَيْتَ]، تَبَارَكْتَ رَبَّنَا وَتَعَالَيْتَ».

"O Allah, më udhëzo bashkë me ata që i ke udhëzuar, më jep shëndet bashkë me ata që u ke dhënë shëndet, merrmë nën kujdesin Tënd bashkë me ata që i ke marrë nën kujdes, më beko në atë që ma ke dhënë dhe më ruaj nga e keqja e asaj që ke caktuar; sepse Ti cakton dhe askush nuk mund të caktojë kundër Teje. Vërtet, nuk poshtërohet ai që Ti e ke marrë nën mbrojtje dhe nuk lartësohet ai që Ti e ke armik. I bekuar dhe i Lartësuar je, o Zoti ynë!"³

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سَخَطِكَ، وَبِمُعَافَاتِكَ مِنْ عُقُوبَتِكَ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ، لَا أَحْصِي ثَنَاءً عَلَيْكَ، أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَى نَفْسِكَ».

¹ Muslimi (4/1773) nr. 2261.

² Muslimi (4/1773) nr. 2263.

³ E transmetuan autorët e katër Suneneve, Ahmedi, Darimiu dhe Bejhakiu: Ebu Davudi, nr. 1425, Tirmidhiu, nr. 464, Nesaiu, nr. 1744, Ibn Maxhe, nr. 1178, Ahmedi, nr. 1718, Darimiu, nr. 1592, Hakimi (3/172) dhe Bejhakiu (2/209), ndërsa pjesa mes kllapave i përket Bejhakiut. Shih gjithashtu: "Sahih et-Tirmidhi" (1/144), "Sahih Ibn Maxhe" (1/194) dhe "Irvaul-Galil" të Albanit (2/172).

"O Allah, unë kërkoj të më mbrosh nëpërmjet kënaqësisë Tënde nga hidhërimi Yt dhe me faljen Tënde nga dënimi Yt, si dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga Ti. Unë nuk mund t'i numëroj lavdërimet ndaj Teje, Ti je ashtu siç e ke lavdëruar Vetën Tënde!"¹

«اللَّهُمَّ إِنَّاكَ نَعْبُدُ، وَلَكَ نُصَلِّي وَنَسْجُدُ، وَإِلَيْكَ نَسْعَى وَنَخْشَى، تَرْجُو رَحْمَتَكَ، وَتَخْشَى عَذَابَكَ، إِنَّ عَذَابَكَ بِالْكَافِرِينَ مُلْحِقٌ، اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْتَغِيثُكَ، وَنَسْتَغْفِرُكَ، وَنُثْنِي عَلَيْكَ الْحَمْدَ، وَلَا نَكْفُرُكَ، وَنُؤْمِنُ بِكَ، وَنَخْضَعُ لَكَ، وَنَخْلَعُ مَنْ يَكْفُرُكَ».

O Allah, vetëm Ty të adhurojmë, për Ty falemi dhe biem në sexhde, drejt Teje nxitojmë dhe përpiqemi. Shpresojmë në mëshirën Tënde dhe i frikësohemi dënimit Tënd; vërtet, dënimi Yt i kap jobsimtarët. O Allah, ne vërtet kërkojmë ndihmën Tënde, kërkojmë faljen Tënde, të lavdërojmë me çdo të mirë, nuk të mohojmë, të besojmë Ty, të nënshtrohemi Ty dhe e braktisim atë që të mohon!²

33. Dhikri pas selamit të vitrit

«سُبْحَانَ الْمَلِكِ الْقُدُّوسِ»

"I Dëlirë nga të metat është Sunduesi, i Shenjti!"

¹ E transmetuan autorët e katër Suneneve dhe Ahmedi: Ebu Davudi, nr. 1427, Tirmidhiu, nr. 3566, Nesaiu, nr. 1746, Ibn Maxhe, nr. 1179 dhe Ahmedi, nr. 751. Shih: "Sahih et- Tirmidhi" (3/180), "Sahih Ibn Maxhe" (1/194) dhe "El-Irva" (2/175).

² Transmetoi Bejhëku në Sunen el-Kubra dhe e vlerësoi të saktë zinxhirin e tij [2/211], ndërsa Shejh Albani në "Irva el-Galil" thotë: "Ky është zinxhir i saktë" [2/170]. Ky transmetim është fjalë e Umerit.

Kjo përsëritet tri herë.

وَالْقَالَةَ يُحْمَرُ بِهَا وَيَمْدُ بِهَا صَوْتُهُ يَقُولُ:

Herën e tretë e ngre zërin, e zgjat dhe thotë:

«رَبِّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ».

"Zoti i melekëve dhe Xhibrilit."¹

34. Duaja (lutja) e brengës dhe pikëllimit

«اللَّهُمَّ إِنِّي عَبْدُكَ، ابْنُ عَبْدِكَ، ابْنُ أُمَّتِكَ، نَاصِيَتِي بِيَدِكَ، مَاضٍ فِي حُكْمِكَ، عَدُلٌ فِي قَضَائِكَ، أَسْأَلُكَ بِكُلِّ اسْمٍ هُوَ لَكَ، سَمَّيْتَ بِهِ نَفْسَكَ، أَوْ أُنْزَلَتْهُ فِي كِتَابِكَ، أَوْ عَلَّمْتَهُ أَحَدًا مِنْ خَلْقِكَ، أَوْ اسْتَأْثَرْتَ بِهِ فِي عِلْمِ الْغَيْبِ عِنْدَكَ، أَنْ تَجْعَلَ الْقُرْآنَ رِبْعَ قَلْبِي، وَنُورَ صَدْرِي، وَجَلَاءَ حُزْنِي، وَذَهَابَ هَمِّي».

"O Allah, unë jam rob i Yt, i biri i robit Tënd, i biri i robëreshës Sate; balli im është në Dorën Tënde, gjykimi Yt mbi mua është i pakthyeshëm, caktimi Yt për mua është i drejtë. Të lutem me çdo emër që është Yti, me të cilin ke emërtuar Vetën Tënde, ose që e ke zbritur në Librin Tënd, ose që ia ke mësuar ndonjërit prej krijesave të Tua, ose që e ke mbajtur për Vete në dijen e së fshehtës të Ti, që ta bësh Kuranin pranverë të zemrës sime, dritë të gjoksit tim, largim të pikëllimit tim dhe heqje të brengës

¹ Transmetuan Nesai (3/244) nr. 1734, Darakutniu (2/31) dhe të tjerë, ndërsa ajo që është mes kllapave është shtesë e Darakutniut (2/31) nr. 2. Zinxhiri i tij është i saktë. Shih: Zad el-Mead me verifikim të Shuajb Arnautit dhe Abdulkadër Arnautit (1/337).

sime!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحَزَنِ، وَالْعَجْزِ وَالْكَسَلِ، وَالْبُخْلِ وَالْحَجْنِ، وَضَلَعِ الدِّينِ وَغَلَبَةِ الرِّجَالِ».

"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga brengat e pikëllimi, nga pamundësia e përtacia, nga koprracia e frikacakllëku, nga barra e rëndë e borxhit dhe nga shtypja e njerëzve."²

35. Duaja e brengosjes (ankthit)

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْعَظِيمُ الْحَلِيمُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَرَبُّ الْأَرْضِ وَرَبُّ الْعَرْشِ الْكَرِيمِ».

"S'ka të adhuruar përveç Allahut, Madhështorit, të Butit. S'ka të adhuruar përveç Allahut, Zotit të Arshit të Madh. S'ka të adhuruar përveç Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të Tokës dhe Zotit të Arshit fisnik."³

«اللَّهُمَّ رَحْمَتَكَ أَرْجُو، فَلَا تَكِلْنِي إِلَى نَفْسِي طَرْفَةَ عَيْنٍ، وَأَصْلِحْ لِي شَأْنِي كُلَّهُ، لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ».

"O Allahu! Shpresoj në mëshirën Tënde, ndaj mos më lër të mbështetem në veten time as sa një pulitje e syrit! Ma përmirëso tërë gjendjen time!

¹ Ahmedi (1/391) nr. 3712. Albani e ka vlerësuar të saktë në Silsiletul-Ehadith es-Sahiha (1/337).

² Buhariu (7/158) nr. 2893. I Dërguari (paqja qoftë mbi të!) e thoshte shpesh këtë lutje. Shih: Buhariu në Fet'hul-Bari (11/173). Do të vijë gjithashtu në (f. 89) nr. 137.

³ Buhariu (7/154) nr. 6345 dhe Muslimi (4/2092) nr. 2730.

Nuk ka hyjni tjetër veç Teje."¹

«لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ».

"Nuk ka të adhuruar tjetër veç Teje. I Pastër je Ti. Unë isha prej të padrejtëve."²

«اللَّهُ اللَّهُ رَبِّي لَا أُشْرِكُ بِهِ شَيْئًا».

"Allahu, Allahu është Zoti im, nuk i bëj ortak asgjë."³

36. Lutja gjatë përballjes me armikun dhe pushtetarin

«اللَّهُمَّ إِنَّا نَجْعَلُكَ فِي حُورِهِمْ، وَنَعُوذُ بِكَ مِنْ شُرُورِهِمْ».

"O Allah! Ne Të vëmë Ty përballë tyre dhe kërkojmë mbrojtjen Tënde prej sherrit të tyre!"⁴

«اللَّهُمَّ أَنْتَ عَزُودِي، وَأَنْتَ نَصِيرِي، بِكَ أَحُولُ وَبِكَ أَصُولُ، وَبِكَ أُقَاتِلُ».

"O Allah! Ti je krahu im, Ti je ndihmësi im, me ndihmën Tënde arrij të shmang kurthin e armikut,

¹ Ebu Davudi (4/324) nr. 5090, dhe Ahmedi (5/42) nr. 20430. Albani e ka vlerësuar të mirë në Sahihun e Ebu Davudit (3/959).

² E kanë transmetuar Tirmidhiu 5/529 nr. 3505, dhe Hakimi, Hakimi e ka vlerësuar të saktë dhe Dhehebiu është pajtuar me vlerësimin e tij 1/505. Shih gjithashtu: Sahih et- Tirmidhi 3/168.

³ E transmetuan Ebu Davudi (2/87) nr. 1525 dhe Ibn Maxhe nr. 3882. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/335).

⁴ Ebu Davudi (2/89) nr. 1537. Hakimi dhe Dhehebiu e kanë vlerësuar të saktë (2/142).

të bëj mësymje shpartalluese dhe t'i luftoj armiqtë."¹

«حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ».

"Na mjafton Allahu, sa Mbrotës i mirë është Ai!"²

37. Lutja kur i druhemi padrejtësisë së sundimtarit

«اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ، وَرَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ، كُنْ لِي جَارًا مِنْ فُلَانِ بْنِ فُلَانٍ، وَأَحْزَابِهِ مِنْ خَلْقِكَ، أَنْ يَفْرُطَ عَلَيَّ أَحَدٌ مِنْهُمْ أَوْ يَطْعَى، عَزَّ جَارُكَ، وَجَلَّ ثَنَاؤُكَ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ».

"O Allah, Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Arshit të Madh, bëhu mbrojtësi im nga filani, i biri i filanit dhe nga pasuesit e tij prej krijesave të Tua, që asnjëri prej tyre të mos nxitojë të më bëjë keq apo të kalojë kufijtë. Krenar është i mbrojturi Yt, e lartë është lavdia Jote dhe s'ka të adhuruar përveç Teje!"³

«اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَعَزُّ مِنْ خَلْقِهِ جَمِيعًا، اللَّهُ أَعَزُّ مِمَّا أَخَافُ وَأَحْذَرُ، أَعُوذُ بِاللَّهِ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ، الْمُمْسِكِ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ أَنْ يَقَعَنَّ عَلَى الْأَرْضِ إِلَّا بِإِذْنِهِ، مِنْ شَرِّ عَبْدِكَ فُلَانٍ، وَجُنُودِهِ وَأَتْبَاعِهِ وَأَشْيَاعِهِ، مِنَ الْجِنَّ وَالْإِنْسِ، اللَّهُمَّ كُنْ لِي جَارًا مِنْ شَرِّهِمْ، جَلَّ ثَنَاؤُكَ وَعَزَّ جَارُكَ، وَتَبَارَكَ اسْمُكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ».

"Allahu është më i Madhi! Allahu është më i

¹ Ebu Davudi (3/42) nr. 2632, dhe Tirmidhiu (5/572) nr. 3584. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/183).

² Buhariu (5/172) nr. 4563.

³ Buhariu në "El-Edeb el-Mufred" nr. 707. Albani e ka vlerësuar të saktë në "Sahih el-Edeb el-Mufred" nr. 545.

fuqishëm se të gjitha krijesat e Tij. Allahu është më i fuqishëm se çdo gjë që kam frikë dhe i ruhem. Kërkoj mbrojtje tek Allahu, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, Ai që mban të shtatë qiejt të mos bien mbi Tokë përveçse me lejen e Tij, nga e keqja e robit Tënd (filanit), nga ushtria e tij, pasuesit dhe mbështetësit e tij prej xhinëve dhe njerëzve. O Zoti im, bëhu Mbrojtësi im nga e keqja e tyre. E lartësuar qoftë lavdia Jote, e fortë është mbrojtja Jote, i bekuar është emri Yt dhe nuk ka zot tjetër përveç Teje!"

ثَلَاثَ مَرَّاتٍ.

Këtë e themi tri herë.¹

38. Lutja kundër armikut

«اللَّهُمَّ مُنْزِلَ الْكِتَابِ، سَرِيعَ الْحِسَابِ، اهْزِمِ الْأَحْزَابَ، اللَّهُمَّ اهْزِمْهُمْ وَزَلِّهُمْ».

"O Allah, Zbritësi i Librit, i Shpejti në llogari, shpartalloi palët armike! O Allah, shpartalloi ata dhe tronditi!"²

39. Çfarë themi kur i druhami një grupi të njerëzve

«اللَّهُمَّ اكْفِنِيهِمْ بِمَا شِئْتَ».

"O Allah, më mbro prej tyre me çfarë të duash

¹ Buhariu në "El-Edeb el-Mufred" nr. 708. E ka vlerësuar të saktë Albani në "Sahih el-Edeb el-Mufred" nr. 546.

² Muslimi (3/1362) nr. 1742.

Ti!"¹

40. Lutja kur kemi cytje në besim

"I kërkojmë mbrojtje Allahut!"² Them: "I mbështetem Allahut të më mbrojë nga shejtani i mallkuar!"

"Ndalojmë së menduari për cytjen."³

Them:

(أَمَنْتُ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ).

"Kam besuar në Allahun dhe të dërguarit e Tij."⁴
"Këndojmë fjalën e Allahut të Lartësuar:

(هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٣﴾)

"Huvel-evvelu uel-âhiru uedh-dhâhiru uel-bâtînu ue huve bi-kul-li shej'in 'alîm." (El Hadid, 3).⁵

41. Duaja për shlyerjen e borxhit

«اللَّهُمَّ اكْفِنِي بِحَلَالِكَ عَنْ حَرَامِكَ، وَأَغْنِنِي بِفَضْلِكَ عَمَّنْ سِوَاكَ».

"O Allah, bëj që të më mjaftojë hallalli Yt nga harami Yt dhe më pasuro me mirësinë Tënde nga çdokush tjetër veç Teje!"⁶

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحَزَنِ، وَالْعَجْزِ وَالْكَسَلِ، وَالْبُخْلِ وَالْجُبْنِ، وَضَلَعِ

¹ Muslimi (4/2300) nr. 3005.

² Buhariu në Fet'hul-Bari (6/336) nr. 3276 dhe Muslimi (1/120) nr. 134.

³ Buhariu në Fet'hul-Bari (6/336) nr. 3276 dhe Muslimi (1/120) nr. 134.

⁴ Muslimi (1/119-120) nr. 134.

⁵ Ebu Davudi (4/329) nr. 5110. Albani e vlerësoi të mirë në Sahihun e Ebu Davudit (3/962).

⁶ Tirmidhiu (5/560) nr. 3563. Shih gjithashtu: Sahih et-Tirmidhi (3/180).

الدِّينِ وَغَلَبَةِ الرِّجَالِ».

"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga brengat e pikëllimi, nga pamundësia e përtacia, nga koprracia e frikacakllëku, nga barra e rëndë e borxhit dhe nga shtypja e njerëzve."¹

42. Lutja kundër cytjeve gjatë namazit dhe këndimit të Kuranit

«أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ،

"Lus Allahun të më mbrojë nga shejtani i mallkuar!"

وَاتَّقِ عَلَى يَسَارِكَ (ثَلَاثًا)).

"Pastaj pështyjmë lehtë në anën e majtë (tri herë)."²

43. Dua (lutja) kur na vështirësohet një çështje

«اللَّهُمَّ لَا سَهْلَ إِلَّا مَا جَعَلْتَهُ سَهْلًا، وَأَنْتَ تَجْعَلُ الْحَزْنَ إِذَا شِئْتَ سَهْلًا».

"O Allah! Nuk ka të lehtë përveç asaj që Ti e bën të lehtë dhe Ti e bën të vështirën të lehtë nëse dëshiron!"³

¹ Buhariu (7/158) nr. 2893. Ka kaluar gjithashtu (f. 83) nr. 121.

² Muslimi (4/1729) nr. 2203, nga Uthman Ibn Ebil Asi, Allahu qoftë i kënaqur me të, e në të thuhet: veprovë kështu, dhe Allahu ma largoi atë.

³ Transmetuan Ibn Hibani në Sahihun e tij nr. 2427 (Meuarid) dhe Ibn Sunni nr. 351. Hafizi (Ibn Haxheri) ka thënë: "Ky hadith është i saktë", si dhe Abdul-Kadir Arnauti e ka cilësuar si të saktë në "Tahrixh el-Edhkar" të Neveviut (fq. 106).

44. Çfarë themi kur bëjmë ndonjë gjynah?

«مَا مِنْ عَبْدٍ يُذْنِبُ ذَنْبًا فَيُحْسِنُ الطُّهُورَ، ثُمَّ يَقُومُ فَيُصَلِّي رَكَعَتَيْنِ، ثُمَّ يَسْتَغْفِرُ اللَّهَ إِلَّا غَفَرَ اللَّهُ لَهُ».

"Nuk ka njeri që bën ndonjë gjynah, pastaj merr abdes mirë, e pastaj ngrihet dhe i fal dy rekate, e më pas i kërkon falje Allahut, përveçse Allahu do ta falë."¹

45. Lutja për largimin e shejtanit dhe cytjeve të tij

Themi: "Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar!"²

"Themi ezanin."³

Dhikri dhe këndimi i Kuranit

«لَا تَجْعَلُوا بُيُوتَكُمْ مَقَابِرَ، إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْفِرُ مِنَ الْبَيْتِ الَّذِي تُقْرَأُ فِيهِ سُورَةُ الْبَقَرَةِ».

"Shtëpitë tuaja mos i bëni varreza, se shejtani ikën prej shtëpisë në të cilën këndohet surja el-Bekare."⁴

Prej gjërave që e largojnë shejtanin janë dhikret e mëngjesit dhe të mbrëmjes, të rënies në gjumë

¹ Ebu Davudi (2/86) nr. 1521, dhe Tirmidhiu (2/257) nr. 406. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Ebu Davudit (1/283).

² Ebu Davudi nr. (1/203), dhe Ibn Maxhe (1/265) nr. 807. Referencat e tij janë cekur më lart nr. 31. Shih gjithashtu: suren El-Muminun: [97-98].

³ Muslimi (1/291) nr. 389 dhe Buhariu (1/151) nr. 608.

⁴ Transmetoi Muslimi (1/539) nr. 780.

dhe të zgjimit, dhikret e hyrjes në shtëpi dhe të daljes prej saj, dhikret e hyrjes në xhami dhe të daljes prej saj, si dhe dhikret e tjera të ligjshme, siç janë: këndimi i Ajetul Kursisë kur biem në gjumë dhe i dy ajeteve të fundit të sures el-Bekare. Kush thotë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Ai është i Vetmi pa ortak. Atij i përket sundimi e lavdia. Ai është i plotfuqishëm për çdo gjë."

مِائَةً مَرَّةً، كَانَتْ لَهُ حِرْزًا مِنَ الشَّيْطَانِ يَوْمَهُ كُلَّهُ،

njëqind herë, do t'i jetë mbrojtje nga shejtani gjatë gjithë ditës.¹ Po ashtu, edhe ezani e largon shejtanin.

46. Lutja kur na ndodh diçka e pakëndshme ose kur na del situata nga kontrolli

«قَدَّرُ اللَّهُ وَمَا شَاءَ فَعَلَ».

"Caktimi i Allahut. Ai bën ç'të dojë."²

47. Urimi për fëmijën e porsalindur dhe

¹ Transmetoi Buhariu (4/126) nr. 3293.

² "Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se besimtari i dobët, e megjithatë të dy kanë mirësi. Kujdesu për atë që të bën dobi. Kërko ndihmën e Allahut e mos u dobëso. Nëse të godet diçka, mos thuaj: 'Sikur të kisha vepruar kështu, do të bëhej kështu e ashtu', por thuaj: 'Caktim i Allahut dhe çfarë dëshiron Ai bën', sepse fjala "sikur" hap dyert e veprimt të shejtanit." Muslimi (4/2052) me numër (2664).

përgjigjja e prindit ndaj urimit

«بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي الْمَوْهُوبِ لَكَ، وَشَكَرْتَ الْوَاهِبَ، وَبَلَغَ أَشُدَّهُ، وَرَزَقْتَ بِرَّهُ».

Allahu të bekoftë në fëmijën që të është dhënë, e falënderofsh Dhuruesin, e arritë pjekurinë dhe u bëftë i sjellshëm me ju!"¹

Ndërsa ai të cilit i bëhet urimi thotë:

«بَارَكَ اللَّهُ لَكَ وَبَارَكَ عَلَيْكَ، وَجَزَاكَ اللَّهُ خَيْرًا، وَرَزَقَكَ اللَّهُ مِثْلَهُ، وَأَجَزَلَ

تَوَابِكَ».

"Allahu të bekoftë dhe të dhëntë bereqet! Allahu të shpërbleftë me të mira, të furnizoftë njësoj dhe ta shtoftë shpërblimin!"²

48. Si të kërkojmë mbrojtje për fëmijët tanë?

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) kërkonte mbrojtje për Hasanin dhe Husejnin (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

«أُعِيذُكُمْ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّةِ مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ وَهَامَّةٍ، وَمِنْ كُلِّ غَبْنٍ لَامَّةٍ».

"Kërkoj mbrojtje për ju të dy me fjalët e përsosura të Allahut nga çdo shejtan dhe insekt helmues, si dhe nga çdo sy i keq!"³

¹ Ky urim përcillet si fjalë e Hasan Basriut. Shih: "Tuhfet el-Meudud" të Ibn Kajimit (fq. 20), i cili ia ka atribuar Ibn Mundhirit në "El-Eusat".

² Këtë e ka thënë Neveviu në librin "el-Edhkar" (f. 349). Shih gjithashtu: "Sahihul-Edhkar" të Neveviut, nga Selim el-Hilali (2/713), referenca e plotë gjendet në librin "Dhikri, lutja dhe mjekimi me rukje" të autorit (1/416).

³ Buhariu (4/119) nr. 3371, nga Ibn Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

49. Lutja për të sëmurin gjatë vizitës tek ai

«لَا بِأَسْ طَهُورٌ إِنْ شَاءَ اللَّهُ».

"S'ka gjë! Është pastrim, në dashtë Allahu!"¹

«أَسْأَلُ اللَّهَ الْعَظِيمَ رَبَّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ أَنْ يَشْفِيَكَ».

"E lus All-llahun e Madhëruar, Zotin e Arshit të madh, që të të shërojë!"

Shtatë herë.²

50. Vlera e vizitimit të të sëmurit

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِذَا عَادَ الرَّجُلُ أَخَاهُ الْمُسْلِمَ مَشَى فِي خِرَافَةٍ الْحَبَّةِ حَتَّى يَجْلِسَ، فَإِذَا جَلَسَ عَمَرَتْهُ الرَّحْمَةُ، فَإِنْ كَانَ غُدُوَّةً صَلَّى عَلَيْهِ سَبْعُونَ أَلْفَ مَلَكٍ حَتَّى يُمِيبَ، وَإِنْ كَانَ مَسَاءً صَلَّى عَلَيْهِ سَبْعُونَ أَلْفَ مَلَكٍ حَتَّى يُصْبِحَ».

"Kur personi i shkon për vizitë vëllait të tij musliman (të sëmure), ai ecën nëpër frutat e Xhenetit derisa të ulet. E kur të ulet, atë e mbulon mëshira. Nëse i shkon për vizitë në mëngjes, shtatëdhjetë mijë melekë luten për të deri në mbrëmje, e nëse i shkon në mbrëmje, shtatëdhjetë mijë melekë luten për të deri në mëngjes."³

¹ Buhariu në el-Fet'h (10/118) nr. 3616.

² "Nuk ka asnjë rob musliman që e viziton një të sëmure që nuk i ka ardhur vdekja, dhe thotë shtatë herë: ...veçse do të shërohet." E shënon Tirmidhiu me numër (2083), dhe Ebu Davudi me numër (3106). Shih: Sahih et-Tirmidhi (2/210), dhe Sahih el-Xhami (5/180).

³ E shënojnë Tirmidhiu, nr. 969, Ibn Maxhe, nr. 1442 dhe Ahmedi nr. 975. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/244) dhe Sahih et-Tirmidhi (1/286). Ahmed Shakiri e ka cilësuar të saktë.

51. Lutja e të sëmurit që i ka humbur shpresat për jetën

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَأَلْحِقْنِي بِالرَّفِيقِ الْأَعْلَى».

"O Allah, më fal, më mëshiro dhe më bashko me shoqërinë më të lartë!"¹

Në çastet e vdekjes, Profeti (paqja qoftë mbi të!) i fuste duart në ujë, e lagte fytyrën me to dhe thoshte:

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ»

"Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut.

إِنَّ لِلْمَوْتِ سَكْرَاتٍ».

Me të vërtetë, vdekja ka agoni."²

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ».

"S'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Allahu është më i Madhi. S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit. S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka ortak. S'ka të adhuruar përveç Allahut. Atij i takon sundimi dhe lavdia. S'ka të adhuruar përveç Allahut dhe s'ka ndryshim e as fuqi,

¹ Buhariu (7/10) nr. 4435 dhe Muslimi (4/1893) nr. 2444.

² Buhariu në Fet-h el-Bari (8/144) nr. 4449, në hadith përmendet edhe përdorimi i misvakut.

përveçse me Allahun."¹

52. Përkujtimi i shehadetit ndaj të sëmurit, i cili është në shtratin e vdekjes

«مَنْ كَانَ آخِرُ كَلَامِهِ

"Ai, fjala e fundit e të cilit është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

"Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut"

دَخَلَ الْجَنَّةَ».

do të hyjë në Xhenet."²

53. Duaja kur na bie ndonjë fatkeqësi

«إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاغِبُونَ، اللَّهُمَّ أَجْرُنِي فِي مُصِيبَتِي، وَأَخْلِفْ لِي خَيْرًا مِنْهَا».

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. O Allah, më shpërble në fatkeqësinë time dhe ma zëvendëso atë me diçka më të mirë!"³

54. Lutja kur ia mbyllim sytë të vdekurit

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِفُلَانٍ (بِاسْمِهِ) وَارْفَعْ دَرَجَتَهُ فِي الْمَهْدِيِّينَ، وَاخْلُفْهُ فِي عَقِبِهِ فِي الْغَائِبِينَ، وَاعْفِرْ لَنَا وَلَهُ يَا رَبَّ الْعَالَمِينَ، وَأَفْسَحْ لَهُ فِي قَبْرِهِ، وَنَوِّرْ لَهُ فِيهِ».

"O Allah, fale filanin (ia përmend emrin), ngrija gradën e tij në mesin e të udhëzuarve dhe bëhu

¹ E transmetuan Tirmidhiu nr. 3430 dhe Ibn Maxhe nr. 3794. Albani e ka cilësuar të saktë. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/152) dhe Sahih Ibn Maxhe (2/317).

² Ebu Davudi (3/190) nr. 3116. Shih: Sahih el-Xhami (5/432).

³ Muslimi (2/632) nr. 918.

kujdestar për pasardhësit që ka lënë pas! Na fal ne dhe atë, o Zoti i botëve! Zgjeroja atij varrin dhe ndriçoja atë!"¹

55. Lutja për të vdekurin në namazin e xhenazes

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُ وَارْحَمْهُ، وَعَافِهِ، وَاعْفُ عَنْهُ، وَأَكْرِمْ نُزُلَهُ، وَوَسِّعْ مُدْخَلَهُ، وَاعْسِلْهُ بِالْمَاءِ الْتَلَّجِ وَالْبَرْدِ، وَنَقِّهِ مِنَ الْخَطَايَا كَمَا نَقَّيْتَ الثَّوْبَ الْأَبْيَضَ مِنَ الدَّنَسِ، وَأَبْدِلْهُ دَارًا خَيْرًا مِنْ دَارِهِ، وَأَهْلًا خَيْرًا مِنْ أَهْلِهِ، وَزَوْجًا خَيْرًا مِنْ زَوْجِهِ، وَأَدْخِلْهُ الْجَنَّةَ، وَأَعِذْهُ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ [وَعَذَابِ النَّارِ]».

"O Allah, fale atë dhe mëshiroje, jepi mirëqenie dhe fale, bëja fisnike pritjen e tij dhe zgjeroja hyrjen. Pastroje atë me ujë, borë e breshër dhe pastroje nga mëkatet ashtu siç e pastron Ti rrobën e bardhë nga papastërtia. Zëvendësoja shtëpinë e tij me një më të mirë, familjen e tij me një më të mirë dhe bashkëshorten e tij me një më të mirë. Fute në Xhenet dhe mbroje nga dënimi i varrit dhe nga dënimi i Zjarrit!"²

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيَّتِنَا وَمَيِّتِنَا، وَشَاهِدِنَا وَعَائِدِنَا، وَصَغِيرِنَا وَكَبِيرِنَا، وَذَكَرِنَا وَأُنْثَانَا، اللَّهُمَّ مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَأَحْيِهِ عَلَى الْإِسْلَامِ، وَمَنْ تَوَفَّيْتَهُ مِنَّا فَتَوَفَّهُ عَلَى الْإِيمَانِ، اللَّهُمَّ لَا تَحْرِمْنَا أَجْرَهُ، وَلَا تُضِلَّنَا بَعْدَهُ».

"O Allah, fali të gjallët tanë dhe të vdekurit tanë,

¹ Muslimi (2/634) nr. 920.

² Muslimi (2/663) nr. 963.

ata që janë të pranishëm dhe ata që mungojnë, të vegjlit tanë dhe të mëdhenjtë tanë, meshkujt tanë dhe femrat tona. O Allah, kë ta mbash në jetë prej nesh, mbaje në jetë në Islam, e kë ta marrësh prej nesh, merre duke qenë në iman. O Allah, mos na e privo shpërblimin për të dhe mos na lër të devijojmë pas tij!"¹

«اللَّهُمَّ إِنَّ فُلَانًا بَنَ فُلَانٍ فِي ذِمَّتِكَ، وَحَبْلُ جِوَارِكَ، فَقِهِ مِنْ فِتْنَةِ الْقَبْرِ، وَعَذَابِ النَّارِ، وَأَنْتَ أَهْلُ الْوَفَاءِ وَالْحَقِّ، فَاعْفِرْ لَهُ وَارْحَمْهُ إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ».

"O Allah, vërtet filani, i biri i filanit, është në besën Tënde dhe nën mbrojtjen Tënde, prandaj mbroje atë nga sprova e varrit dhe nga dënimi i Zjarrit! Ti je Zoti i besnikërisë dhe i së Vërtetës, andaj fale atë dhe mëshiroje! Vërtet, Ti je Falësi i Madh, Mëshirëploti!"²

«اللَّهُمَّ عَبْدُكَ وَابْنُ أُمَّتِكَ احتَاجُ إِلَى رَحْمَتِكَ، وَأَنْتَ غَيٌّ عَنْ عَذَابِهِ، إِنْ كَانَ مُحْسِنًا فَزِدْ فِي حَسَنَاتِهِ، وَإِنْ كَانَ مُسِيئًا فَتَجَاوَزْ عَنْهُ».

"O Allah, robi Yt dhe i biri i robëreshës Sate ka nevojë për mëshirën Tënde, ndërsa Ti nuk ke nevojë për dënimin e tij. Nëse ka qenë bamirës, shtoji të mirat e tij, dhe nëse ka qenë gabimtar, falja

¹ Ebu Davudi nr. 3201, Tirmidhiu nr. 1024, Nesaiu nr. 1985, Ibn Maxhe (1/480) nr. 1498 dhe Ahmedi (2/368) nr. 8809. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/251).

² E transmeton Ibn Maxhe nr. 1499. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/251). E transmeton gjithashtu Ebu Davudi (3/211) nr. 3202.

atij!"¹

56. Lutja për fëmijën që ka vdekur në namazin e xhenazes

«اللَّهُمَّ أَعِذْهُ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ».

"O Allah! Ruaje atë nga dënimi i varrit!"²

E nëse themi:

«اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ فَرَطًا وَذُخْرًا لَوَالِدَيْهِ، وَشَفِيعًا مُجَابًّا، اللَّهُمَّ ثَقِّلْ بِهِ مَوَازِينَهُمَا، وَأَعْظِمْ بِهِ أَجُورَهُمَا، وَأَلْحِفْهُ بِصَالِحِ الْمُؤْمِنِينَ، وَاجْعَلْهُ فِي كِفَالَةِ إِبْرَاهِيمَ، وَقِهِ بِرَحْمَتِكَ عَذَابَ الْحَجِيمِ، وَأَبْدِلْهُ دَارًا خَيْرًا مِنْ دَارِهِ، وَأَهْلًا خَيْرًا مِنْ أَهْلِهِ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَأَسْلَافِنَا، وَأَفْرَاطِنَا، وَمَنْ سَبَقَنَا بِالْإِيمَانِ».

"O Allah, bëje atë paraprirës, shpërblim dhe ndërmjetësues të pranuar për prindërit e tij! O Allah, rëndoje me të peshoret e prindërve dhe shumëfishoji shpërblimet e tyre përmes tij! Bashkoje atë me të mirët e besimtarëve dhe vendose atë nën kujdesin e Ibrahimit dhe me mëshirën Tënde mbroje atë nga dënimi i Xhehenemit! Zëvendësoja shtëpinë e tij me një më të mirë dhe familjen e tij me një më të mirë! O Allah,

¹ E ka shënuar Hakimi dhe e ka cilësuar të saktë. I këtij mendimi ishte dhe Dhehebiu.(1/359). Shih: "Ahkam el-Xhenaiz" të Albanit (f. 125).

² Seid Ibn Musejibi ka thënë: "Fala pas Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur me të!) namazin e xhenazes të një fëmije që nuk ka bërë kurrë asnjë mëkat dhe e dëgjova të thoshte..." Hadithi. Këtë hadith e ka shënuar Maliku në "Muvetta" (1/288), Ibn Ebi Shejbe në "Musannef" (3/217) dhe Bejhekiu (4/9). Ndërsa zinxhirin e transmetimit të tij e ka cilësuar të saktë Shuajb Arnauti në verifikimin e tij të "Sherhus-Sunneh" të Begaviut (5/357).

fali të parët tanë, paraprirësit tanë dhe ata që na kanë paraprirë me besim!"

kjo është gjë e mirë.¹

«اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ لَنَا فَرَطًا، وَسَلَفًا، وَأَجْرًا».

"O Allah, bëje atë për ne paraprirës, pararendës dhe shpërblim!"²

57. Lutja e ngushëllimit

«إِنَّ لِلَّهِ مَا أَخَذَ، وَلَهُ مَا أُعْطِيَ، وَكُلُّ شَيْءٍ عِنْدَهُ بِأَجَلٍ مُّسَمًّى... فَلْتَصْبِرْ وَلْتَحْتَسِبْ».

"Vërtet, e Allahut është ajo që ka marrë dhe e Tij është ajo që ka dhënë, dhe çdo gjë tek Ai është me një afat të caktuar, andaj të bësh durim dhe të shpresosh në shpërblim!"³

E nëse themi:

«أَعْظَمَ اللَّهُ أَجْرَكَ، وَأَحْسَنَ عَزَاءَكَ، وَغَفَرَ لِمَيِّتِكَ».

"Allahu ta rritë shpërblimin, të dhëntë ngushëllim të mirë dhe e faltë të vdekurin tënd!"

kjo është gjë e mirë.⁴

¹ Shih: "El Mugni" i Ibn Kudames (3/416) dhe "Ed-Durus el-Muhimme li Ammetil-Ummeh" i Shejh Abdulaziz bin Abdullah bin Bazit, Allahu e mëshiroftë (f. 15).

² Hasani i lexonte fëmijës suren el-Fatiha dhe thoshte... (Hadithi). Shënon Begaviu në "Sherh es-Sunneh" (5/357), dhe Abdurrezaku me nr. 6588, kurse Buhariu e shënon si mual-lek (pa zinxhir) në kapitullin e xhenazeve (65), në nënkaptullin "Leximi i sures el-Fatiha në namazin e xhenazes" (2/113), para hadithit nr. 1335.

³ Buhariu (2/80) nr. 1284 dhe Muslimi (2/636) nr. 923.

⁴ El-Edhkar i Neveviut (f. 126).

58. Lutja gjatë futjes së të vdekurit në varr

«بِسْمِ اللَّهِ وَعَلَى سُنَّةِ رَسُولِ اللَّهِ».

"Me emrin e Allahut dhe sipas sunetit të Dërguarit të Allahut."¹

59. Lutja pas varrimit të të vdekurit

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُ، اللَّهُمَّ تَبِّتْهُ».

"O Allah, fale atë! O Allah, jepi qëndrueshmëri!"²

60. Lutja e vizitës së varreve

«السَّلَامُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ، مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُسْلِمِينَ، وَإِنَّا إِنْ شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاحِقُونَ، [وَيَرْحَمُ اللَّهُ الْمُسْتَقْدِمِينَ مِنَّا وَالْمُسْتَأْخِرِينَ] أَسْأَلُ اللَّهَ لَنَا وَلَكُمْ الْعَافِيَةَ».

"Paqja qoftë mbi ju, o banorë të këtyre varrezave, prej besimtarëve dhe muslimanëve. Edhe ne, me vullnetin e Allahut, do t'ju bashkohemi. [Allahu i mëshiroftë të parët dhe të fundit nga ne!] Kërkoj prej Allahut mirësi për veten dhe për ju!"³

¹ Ebu Davudi (3/314) nr. 3215 me zinxhir të saktë transmetuesish, dhe Ahmedi nr. 5234 dhe nr. 4812 me fjalët: "Bismil-lāhi ue 'alā mil-leti Rasūlil-lāhi" (Me emrin e Allahut dhe sipas fesë së të Dërguarit të Allahut), zinxhiri i tij është i saktë.

² Profeti (paqja qoftë mbi të!) kur përfundonte varrimin e të vdekurit, qëndronte pranë tij dhe thoshte: "Kërkoni falje për vëllanë tuaj dhe kërkoni për të qëndrueshmëri, sepse tani po pyetet." Ebu Davudi (3/315) me numër (3223) dhe Hakimi, i cili e ka cilësuar të saktë dhe me të është pajtuar edhe Dhehebiu (1/370).

³ Muslimi (2/671) nr. 975 dhe Ibn Maxhe (1/494). Teksti është i Ibn Maxhes nr. 1547 nga Burejde (Allahu qoftë i kënaqur me të), ndërsa pjesa mes

61. Lutja që thuhet kur fryn erë

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا».

"O Allah! Kërkoj prej Teje të mirën e saj dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga e keqja e saj!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَهَا، وَخَيْرَ مَا فِيهَا، وَخَيْرَ مَا أُرْسِلَتْ بِهِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا، وَشَرِّ مَا فِيهَا، وَشَرِّ مَا أُرْسِلَتْ بِهِ».

"O Allah, kërkoj prej Teje të mirën e saj, të mirën e asaj që ndodhet në të dhe të mirën me të cilën është dërguar, si dhe kërkoj mbrojtje te Ti nga e keqja e saj, e keqja e asaj që ndodhet në të dhe e keqja me të cilën është dërguar!"²

62. Lutja që thuhet kur dëgjojmë bubullimën

«سُبْحَانَ الَّذِي يُسَبِّحُ الرَّعْدُ بِحَمْدِهِ وَالْمَلَائِكَةُ مِنْ خِيفَتِهِ».

"I Lartësuar është Allahu, të Cilin e madhëron bubullima duke e falënderuar; edhe melekët e madhërojnë Atë nga frika e Tij."³

klapave është nga hadithi i Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të) te Muslimi (2/671) nr. 975.

¹ E transmetuan Ebu Davudi (4/326) nr. 5099 dhe Ibn Maxhe (2/1228) nr. 3727. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/305).

² Transmetuan Muslimi, ndërsa teksti është i tij (2/666) nr. 899, dhe Buhariu (4/76) nr. 3206 dhe 4829.

³ Abdullah ibn Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të dhe babanë e tij) kur dëgjonte bubullimën e ndërpriste bisedën dhe thoshte: ... (Hadithi). Burimi: Muvetta (2/992). Albani në Sahihul Kelimut-Tajjib nr. 157 thotë: "Është fjale e sahabiut dhe zinxhiri është i saktë."

63. Disa nga lutjet që thuhën për lëshimin e shiut

«اللَّهُمَّ اسْقِنَا غَيْثًا مُغِيثًا مَرِيئًا مَرِيئًا، نَافِعًا غَيْرَ ضَارٍّ، عَاجِلًا غَيْرَ آجِلٍ».

"O Allah, na jep shi shpëtues, të këndshëm e të bollshëm, të dobishëm e jo të dëmshëm, të shpejtë e jo të vonuar!"¹

«اللَّهُمَّ أَغْنِنَا، اللَّهُمَّ أَغْنِنَا، اللَّهُمَّ أَغْنِنَا».

"O Allah, na jep shi! O Allah, na jep shi! O Allah, na jep shi!"²

«اللَّهُمَّ اسْقِ عِبَادَكَ، وَبَهَائِمَكَ، وَانْشُرْ رَحْمَتَكَ، وَأَحْيِ بَلَدَكَ الْمَيِّتَ».

"O Allah, jepu ujë robërve të Tu dhe kafshëve të Tua, përhap mëshirën Tënde dhe ngjalle vendin Tënd të vdekur!"³

64. Lutja që thuhet kur shohim shiun duke rënë

«اللَّهُمَّ صَبِّأْ نَافِعًا».

"O Allah! Bëje (shiun) të bollshëm e të dobishëm!"⁴

65. Dhikri që thuhet pas rënies së shiut

¹ Ebu Davudi (1/303) nr. 1171. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Ebu Davudit (1/216).

² Transmetuan Buhariu (1/224) nr. 1014 dhe Muslimi (2/613) nr. 897.

³ Ebu Davudi (1/305) nr. 1178. Albani e ka vlerësuar të mirë në Sahih Ebu Davud (1/218).

⁴ Buhariu në Fet'hul-Bari (2/518) nr. 1032.

«مُطَرَّنَا بِفَضْلِ اللَّهِ وَرَحْمَتِهِ».

"Ra shi mbi ne, falë mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij."¹

66. Disa lutje që thuhën për kthjellim të motit

«اللَّهُمَّ حَوَّائِنَا وَلَا عَلَيْنَا، اللَّهُمَّ عَلَى الْكَامِ وَالظَّرَابِ، وَبُطُونِ الْأَوْدِيَةِ، وَمَنَابِتِ الشَّجَرِ».

"O Allah, (bëje të bjerë) rreth nesh e jo mbi ne! O Allah, nëpër kodrina e male, nëpër lugina dhe në vendet ku mbijnë pemët!"²

67. Duaja që thuhet kur shohim hënën e re

«اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُمَّ أَهْلُهُ عَلَيْنَا بِالْأَمْنِ وَالْإِيمَانِ، وَالسَّلَامَةِ وَالْإِسْلَامِ، وَالتَّوْفِيقِ لِمَا نَحِبُ رَبَّنَا وَتَرْضَى، رَبَّنَا وَرَبُّكَ اللَّهُ».

"Allahu është më i Madhi! O Zoti ynë, na e shfaq atë me siguri dhe besim, me paqe dhe Islam, si dhe me sukses në ato gjëra që Ti i do, o Zoti ynë, dhe në ato gjëra me të cilat Ti je i kënaqur! Zoti ynë dhe Zoti yt është Allahu!"³

68. Lutja që thuhet kur agjëruesi çel iftarin

«ذَهَبَ الظَّمَأُ وَأَبْتَلَّتِ الْعُرُوقُ، وَثَبَّتَ الْأَجْرُ إِنْ شَاءَ اللَّهُ».

¹ Transmetuan Buhariu (1/205) nr. 846 dhe Muslimi (1/83) nr. 71.

² Transmetuan Buhariu (1/224) nr. 933 dhe Muslimi (2/614) nr. 897.

³ Tirmidhiu (5/504) nr. 3451 dhe Darimiu me tekstin e vet (1/336). Shih: Sahihu i Tirmidhiut (3/157).

"Iku etja, u njomën damarët dhe u siguraa shpërblimi, në dashtë Allahu!"¹

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِرَحْمَتِكَ الَّتِي وَسِعَتْ كُلَّ شَيْءٍ أَنْ تَغْفِرَ لِي.»

O Allah! Të lutem me mëshirën Tënde, e cila ka përfshirë çdo gjë, të më falësh!²

69. Lutja që thuhet para ushqimit

«إِذَا أَكَلَ أَحَدُكُمْ طَعَامًا فَلْيَقُلْ:

"Kur ndonjëri prej jush ha ushqim, le të thotë:

بِسْمِ اللَّهِ،

'Me emrin e Allahut!'

فَإِنْ نَسِيَ فِي أَوَّلِهِ فَلْيَقُلْ:

E nëse harron në fillim, le të thotë:

بِسْمِ اللَّهِ فِي أَوَّلِهِ وَآخِرِهِ.»

'Me emrin e Allahut fillim e mbarim!'³

«مَنْ أَطْعَمَهُ اللَّهُ الطَّعَامَ فَلْيَقُلْ:

"Ai të cilit Allahu ia mundëson të hajë ushqim, le të thotë:

¹ E transmetuan Ebu Davudi (2/306) nr. 2359, dhe të tjerë. Shih: Sahihul Xhami (4/209).

² E shënoi Ibn Maxhe (1/557) nr. 1753, nga duaaja e Abdullah ibn Amrit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Hafiz Ibn Haxheri e ka cilësuar të mirë në Tahrîxhul-Edhkar. Shih: Sherhul-Edhkar (4/342).

³ E transmetuan Ebu Davudi (3/347) nr. 3767 dhe Tirmidhiu (4/288) nr. 1858. Shih: Sahih et-Tirmidhi (2/167).

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهِ وَأَطْعِمْنَا خَيْرًا مِنْهُ،

'O Allah, bekoje atë për ne dhe na ushqe me më të mirë se ai!'

وَمَنْ سَقَاهُ اللَّهُ لَبَنًا فَلْيُقُلْ:

E ai të cilit Allahu i jep të pijë qumësht, le të thotë:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِيهِ وَزِدْنَا مِنْهُ.

'O Allah, bekoje atë për ne dhe na e shto!'"¹

70. Lutja që thuhet pas ushqimit

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَطْعَمَنِي هَذَا، وَزَرَقَنِيهِ، مِنْ غَيْرِ حَوْلٍ مِنِّي وَلَا قُوَّةٍ».

Lavdia i takon Allahut, i Cili ma mundësoi ta ha këtë ushqim dhe më furnizoi me të pa mundin dhe fuqinë time!²

«الْحَمْدُ لِلَّهِ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ، غَيْرَ [مَكْنِيٍّ وَلَا] مُودَّعٍ، وَلَا مُسْتَعَقٍّ عَنْهُ رَبَّنَا».

"Lavdia i përket Allahut, lavdi e shumtë, e dëlirë dhe e bekuar; i Pazëvendësueshëm, i Pabraktisur, dhe i Patjetërsueshëm, je Ti o Zoti ynë."³

71. Lutja që bën mysafiri për të zotin e

¹ Tirmidhiu (5/506) nr. 3455. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/158).

² E transmetuan autorët e Suneneve përveç Nesaiut: Ebu Davudi nr. 4025, Tirmidhiu nr. 3458 dhe Ibn Maxhe nr. 3285. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/159).

³ Buhariu (6/214) nr. 5458 dhe Tirmidhiu me tekstin e tij (5/507) nr. 3456.

shtëpisë

«اللَّهُمَّ بَارِكْ لَهُمْ فِيْمَا رَزَقْتَهُمْ، وَاعْفِرْ لَهُمْ وَارْحَمَهُمْ».

"O Allah! Bekoji këta njerëz në furnizimin që u ke dhënë dhe fali e mëshiroji ata!"¹

72. Aludimi përmes lutjes për të kërkuar ushqim ose pije

«اللَّهُمَّ أَطْعِمْ مَنْ أَطْعَمَنِي، وَاسْقِ مَنْ سَقَانِي».

"O Allah, ushqe atë që më ushqen dhe jepi të pijë atij që më jep të pi!"²

73. Lutja që thuhet kur bëjmë iftar te një familje

«أَفْطَرَ عِنْدَكُمْ الصَّائِمُونَ، وَأَكَلَ طَعَامَكُمْ الْأَبْرَارُ، وَصَلَّتْ عَلَيْكُمْ الْمَلَائِكَةُ».

"Bëfshin iftar te ju agjëruesit, e ngrënë ushqimin tuaj të devotshmit dhe bëfshin lutje për ju melekët!"³

74. Lutja që e bën agjëruesi kur i sillet ushqim dhe nuk ha.

¹ Muslimi (3/1615) nr. 2042.

² Muslimi (3/1626) nr. 2055.

³ Sunen Ebu Davud (3/367) nr. 3856, Ibn Maxhe (1/556) nr. 1747 dhe Nesaiu në Amel el-Jeum uel-Lejleh nr. 296-298. Nesaiu ka theksuar se Profeti (paqja qoftë mbi të!) e thoshte këtë kur bënte iftar te ndonjë familje. Albani e ka vlerësuar të saktë këtë hadith në Sahih Ebu Davud (2/730).

«إِذَا دُعِيَ أَحَدُكُمْ فَلْيُجِبْ، فَإِنْ كَانَ صَائِمًا فَلْيُصَلِّ، وَإِنْ كَانَ مُفْطِرًا فَلْيُطْعَمْ».

"Kur të ftohet ndonjëri prej jush për të ngrënë ushqim, le t'i përgjigjet ftesës; nëse është agjërueshëm, le të bëjë dua e nëse nuk është agjërueshëm, le të hajë!"¹

Kuptimi i fjalës "le të bëjë dua" është "le të lutet për atë që e ka ftuar"

75. Çfarë thotë agjëruesi kur dikush e shan?

«إِنِّي صَائِمٌ، إِنِّي صَائِمٌ».

"Unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm!"²

76. Lutja që thuhet kur shikojmë frutat e para të pemës

«اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِي ثَمَرِنَا، وَبَارِكْ لَنَا فِي مَدِينَتِنَا، وَبَارِكْ لَنَا فِي صَاعِنَا، وَبَارِكْ لَنَا فِي مَدَنَّا».

"O Allah, na jep begati në frutat tona, na jep begati në qytetin tonë, na jep begati në njësitë tona të matjes dhe të peshimit!"³

77. Lutja që themi kur teshtijmë

«إِذَا عَطَسَ أَحَدُكُمْ فَلْيَقُلْ:

"Kur ndonjëri prej jush të teshtijë, le të thotë:

¹ Muslimi (2/1054) nr. 1150.

² Buhariu në Fet-h el-Bari (4/103) nr. 1894 dhe Muslimi (2/806) nr. 1151.

³ Muslimi (2/1000) nr. 1373.

الْحَمْدُ لِلَّهِ،

'Elhamdulil-lah – Lavdërimi i takon Allahut!'

وَلْيَقُلْ لَهُ أَخُوهُ أَوْ صَاحِبُهُ:

Kurse vëllai apo shoku le t'i thotë:

يَرْحَمَكَ اللَّهُ،

'Allahu të mëshiroftë!'

فَإِذَا قَالَ لَهُ: يَرْحَمَكَ اللَّهُ، فَلْيَقُلْ:

E kur t'i thotë atij: 'Jerhamukallah!', atëherë ky le t'ia kthejë:

يَهْدِيكُمُ اللَّهُ وَيُصْلِحْ بَالَكُمْ».

'Allahu ju udhëzofte dhe jua përmirësofte gjendjen!'"¹

78. Çfarë i thuhet jobesimtarit kur teshtin dhe thotë: "Elhamdulilah"

«يَهْدِيكُمُ اللَّهُ وَيُصْلِحْ بَالَكُمْ».

"Allahu ju udhëzofte dhe jua përmirësofte gjendjen!"².

79. Lutja që i thuhet të sapomartuarit

«بَارَكَ اللَّهُ لَكَ، وَبَارَكَ عَلَيْكَ، وَجَمَعَ بَيْنَكُمَا فِي خَيْرٍ».

"Allahu të bekoftë, derdhtë bekime mbi ty dhe ju

¹ Buhariu (7/125), nr. 5870.

² Tirmidhiu (5/82) nr. 2741, Ahmedi (4/400) nr. 19586 dhe Ebu Davudi (4/308) nr. 5040. Shih: Sahih et-Tirmidhi (2/354).

bashkoftë të dyve në të mirë!"¹

80. Lutja që themi kur martohemi dhe kur blejmë ndonjë kafshë

"Kur ndonjëri prej jush të martohet me ndonjë grua ose kur të blejë një shërbëtor, le të thotë:

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ خَيْرَهَا، وَخَيْرَ مَا جَبَلْتَهَا عَلَيْهِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا، وَشَرِّ مَا جَبَلْتَهَا عَلَيْهِ،

'O Allah, kërkoj prej Teje të mirën e saj dhe të mirën e natyrës në të cilën e ke krijuar, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e saj dhe e keqja e natyrës në të cilën e ke krijuar!"

وَإِذَا اشْتَرَى بَعِيرًا فَلْيَأْخُذْ بِذُرْوَةِ سَنَامِهِ وَلْيَقُلْ مِثْلَ ذَلِكَ».

E kur të blejë një deve, le ta vendosë dorën në majën e gungës së saj dhe le të thotë të njëjtën gjë".²

81. Lutja që thuhet para marrëdhënieve intime me bashkëshorten

«بِسْمِ اللَّهِ، اللَّهُمَّ جَنِّبْنَا الشَّيْطَانَ، وَجَنِّبِ الشَّيْطَانَ مَا رَزَقْتَنَا».

"Me emrin e Allahut! O Allah, largoje shejtanin nga ne dhe largoje shejtanin nga ajo me të cilën na furnizon!"³

¹ E transmetuan autorët e Suneneve, përveç Nesaiut: Ebu Davudi nr. 2130, Tirmidhiu nr. 1091, Ibn Maxhe nr. 1905 dhe Nesaiu në "Amelul-jeumi vel-lejleh" nr. 259. Shih: Sahih et-Tirmidhi (1/316).

² Ebu Davudi (2/248) nr. 2160, dhe Ibn Maxheja (1/617) nr. 1918. Shih: Sahihun e Ibn Maxhes (1/324).

³ Buhariu (6/141) nr. 141 dhe Muslimi (2/1028) nr. 1434.

82. Lutja që thuhet kur zemërohemi

«أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ».

"Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar."¹

83. Lutja që thuhet kur shohim një të sprovuar

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي عَاقَانِي مِمَّا ابْتَلَاكَ بِهِ، وَفَضَّلَنِي عَلَى كَثِيرٍ مِمَّنْ خَلَقَ تَفْضِيلًا».

"Falënderimi i takon Allahut, që nuk më ka sprovuar me atë që të ka sprovuar dhe që më ka dalluar me të mira prej shumë krijesave të Tij."²

84. Çfarë thuhet në tubime?

Nga Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmetohet se ka thënë: "Të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet qofshin mbi të!) i numëroreshin në një tubim të vetëm, para se të ngrihej, njëqind herë:

«رَبِّ اغْفِرْ لِي، وَتُبْ عَلَيَّ، إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الْغَفُورُ».

'O Zot, më fal dhe prano pendimin tim, vërtet Ti je Pranuesi i pendimit, Falësi!'"³

85. Shlyerja e gabimeve të tubimit

¹ Buhariu (7/99) nr. 3282 dhe Muslimi (4/2015) nr. 2610.

² Tirmidhiu (5/494) dhe (5/493) nr. 3432. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/153).

³ Tirmidhiu nr. 3434 dhe Ibn Maxhe nr. 3814. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/153) dhe Sahih Ibn Maxhe (2/321), ndërsa teksti është i Tirmidhiut.

«سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ».

"I patëmeta je Ti, o Allah! Vetëm Ty të takon lavdërimi! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar përveç Teje. Unë kërkoj falje nga Ti dhe te Ti pendothem."¹

**86. Lutja që bëjmë për atë i cili na thotë:
"Allahu të faltë!"**

«وَلَكَ».

"Edhe ty gjithashtu!"²

**87. Lutja që bëjmë për dikë që na ka bërë
një të mirë**

«جَزَاكَ اللَّهُ خَيْرًا».

"Allahu të shpërbleftë me të mira!"³

**88. Gjërat me të cilat Allahu na mbron nga
Dexhali**

«مَنْ حَفِظَ عَشْرَ آيَاتٍ مِنْ أَوَّلِ سُورَةِ الْكَهْفِ عُصِمَ مِنَ الدَّجَالِ».

¹ Autorët e Suneneve: Ebu Davudi nr. 4858, Tirmidhiu nr. 3433 dhe Nesaiu nr. 1344. Shih: "Sahih et-Tirmidhi" (3/153). Është vërtetuar se Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) nuk ulej në ndonjë tubim, as lexonte Kuran e as falte ndonjë namaz pa e përmbyllur atë me disa fjalë..." (Hadithi). E shënon Nesaiu në "Amel el-jeumi uel-lejleh" nr. 308 dhe Ahmedi (6/77) nr. 24486. Dr. Faruk Hamadeh thotë në verifikimin e tij të "Amel el-jeumi uel-lejleh" të Nesaiut (fq. 273) se ky transmetim është sahih (i saktë).

² Ahmedi 5/82 nr. 20778 dhe Nesaiu në "Amelul-jeumi uel-lejleh" fq. 218 nr. 421, verifikimi i Dr. Faruk Hamadës.

³ Transmetoi Tirmidhiu nr. 2035. Shih edhe: Sahih el-Xhami (6244) dhe Sahih et-Tirmidhi (2/200).

"Ai që i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të jetë i mbrojtur nga (sprova e) Dexhalit."¹

"Kërkimi i mbrojtjes së Allahut nga sprova e tij pas teshehudit të fundit të çdo namazi."²

89. Lutja që bëjmë për atë që na thotë: "Të dua për hir të Allahut"

«أَحَبُّكَ الَّذِي أَحْبَبْتَنِي لَهُ».

"Të dashtë Ai për hir të të Cilit më do!"³

90. Lutja që bëjmë për atë person që na ofron pasurinë e tij

«بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي أَهْلِكَ وَمَالِكَ».

"Allahu të begatoftë në familjen tënde dhe në pasurinë tënde!"⁴

91. Lutja që themi për atë që na jep hua në kohën e shlyerjes së borxhit

«بَارَكَ اللَّهُ لَكَ فِي أَهْلِكَ وَمَالِكَ، إِنَّمَا جَزَاءُ السَّلْفِ الْحَمْدُ وَالْأَدَاءُ».

"Allahu të bekoftë në familjen dhe pasurinë tënde! Vërtet, shpërblimi i huasë është falënderimi

¹ Shih: hadithin nr. 55 dhe hadithin 56 (f. 41) në këtë libër.

² Muslimi (1/555) nr. 809, ndërsa në një transmetim: dhjetë ajetet e fundit të sures Kehf (1/556) nr. 809.

³ E transmetoi Ebu Davudi (4/333) nr. 5125. Albani e ka cilësuar të mirë në Sahih Sunen Ebi Davud (3/965).

⁴ Buhariu në Fet'h el Bari (4/288) nr. 2049.

dhe kthimi i saj."¹

92. Lutja që bëjmë kur kemi frikë nga shirku

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَشْرِكَ بِكَ وَأَنَا أَعْلَمُ، وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا لَا أَعْلَمُ».

"O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos të të përshkruaj shok duke e ditur dhe kërkoj faljen Tënde për atë që nuk e di."²

93. Lutja që bëjmë për atë që na thotë: "Allahu të begatoftë!"

«وَفِيكَ بَارَكَ اللَّهُ».

"Allahu të begatoftë edhe ty!"³

94. Lutja që themi kundër ogurit të keq

«اللَّهُمَّ لَا طَيْرَ إِلَّا طَيْرُكَ، وَلَا خَيْرَ إِلَّا خَيْرُكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ».

"O Allah! Nuk ka ogur tjetër përveç ogurit Tënd, nuk ka mirësi tjetër përveç mirësisë Sate dhe askush pos Teje s'ka të drejtë të adhurohet!"⁴

¹ E transmetuan Nesaiu në "Amelul-jeum uel-lejleh" (fq. 300) dhe Ibn Maxhe (2/809) nr. 2424. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/55).

² E shënojnë Ahmedi (4/403) nr. 19606 dhe Buhariu në "El-Edeb el-Mufred" nr. 716. Shih: "Sahih el-Xhami" (3/233) dhe "Sahih et-Tergib vet-Terhib" të Albanit (1/19).

³ Transmetoi Ibn es-Sunniu (fq. 138) nr. 278 dhe shih: El-Uabil es-Sajib të Ibn Kajjimit (fq. 304), verifikuar nga Beshir Muhamed Ujun.

⁴ E shënojnë Ahmedi (2/220) nr. 7045 dhe Ibn es-Sunni nr. 292. Albani e ka vlerësuar të saktë në "Silsiletul-Ehadith es-Sahiha" (3/54) nr. 1065. Sa i përket optimizmit, atë e pëlqente Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!); prandaj, kur dëgjoji nga një njeri një fjalë të mirë që i pëlqeu, ai tha: "E morëm optimizmin tënd nga goja jote". E shënojnë Ebu Davudi nr. 3719

95. Lutja që themi kur hipim në mjetin e udhëtimit

«بِسْمِ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ»

"Me emrin e Allahut! Falënderimi i takon Allahut!"

«سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ»

"Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se vetë ne këto nuk do të mund t'i kishim nën pushtet.

وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ»

Dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë!"

الْحَمْدُ لِلَّهِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ، الْحَمْدُ لِلَّهِ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ
إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي؛ فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ».

"Falënderimi i përket vetëm Allahut, Falënderimi i përket vetëm Allahut, Falënderimi i përket vetëm Allahut. Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi. I Lartësuar je Ti, o Allah. Unë i kam bërë padrejtësi vetvetes, prandaj më fal, sepse askush përveç Teje nuk mund të m'i falë gjynahet!"¹

96. Lutja e udhëtimit

dhe Ahmedi nr. 9040, ndërsa Albani e ka vlerësuar të saktë në "Silsiletul-Ehadith es-Sahiha" (2/363), si dhe gjendet në librin "Morali i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!)" Ebu Shejhu (f. 270).

¹ Ebu Davudi (3/34) nr. 2602, dhe Tirmidhiu (5/501) nr. 3446. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/156), surja Ez-Zuhruf [13- 14].

«اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ،

"Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi"

سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ

"Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se vetë ne këto nuk do të mund t'i kishim nën pushtet.

وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ،

Dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë"

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ فِي سَفَرِنَا هَذَا الْبِرَّ وَالْتَّقْوَى، وَمِنَ الْعَمَلِ مَا تَرْضَى، اللَّهُمَّ هَوِّنْ عَلَيْنَا سَفَرَنَا هَذَا وَاطْوِ عَنَّا بُعْدَهُ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الصَّاحِبُ فِي السَّفَرِ، وَالْخَلِيقَةُ فِي الْأَهْلِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ وَعْثَاءِ السَّفَرِ، وَكَآبَةِ الْمُنْظَرِ، وَسُوءِ الْمُنْقَلَبِ فِي الْمَالِ وَالْأَهْلِ،

"O Zoti ynë, të lutemi që në këtë udhëtimin tonë të na mundësosh të bëjmë mirësi, të jemi të devotshëm dhe të bëjmë vepra me të cilat Ti je i kënaqur! O Zoti ynë, na e lehtëso udhëtimin dhe na e shkurto distancën! O Zoti ynë, Ti je shoqërues në udhëtim dhe mbrojtës i familjes sonë në mungesën tonë. O Zoti im, kërkoj që të më mbrosh nga vështirësitë e udhëtimit, nga pamja e dëshpëruar dhe nga telashet në pasuri dhe familje!"

Kur Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) kthehej nga udhëtimi, i thoshte ato dhe shtonte:

«يَبُوءُ، تَائِبُونَ، عَابِدُونَ، لِرَبَّنَا حَامِدُونَ».

"Po kthehemi të penduar, adhures dhe falënderues ndaj Zotit tonë."¹

97. Lutja që thuhet kur hyjmë në fshat ose qytet

«اللَّهُمَّ رَبَّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَمَا أَظْلَلْنَ، وَرَبَّ الْأَرْضِينَ السَّبْعِ وَمَا أَقْلَلْنَ، وَرَبَّ الشَّيَاطِينِ وَمَا أَضْلَلْنَ، وَرَبَّ الرِّيَّاحِ وَمَا دَرَيْنَ، أَسْأَلُكَ خَيْرَ هَذِهِ الْقَرْيَةِ، وَخَيْرَ أَهْلِهَا، وَخَيْرَ مَا فِيهَا، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّهَا، وَشَرِّ أَهْلِهَا، وَشَرِّ مَا فِيهَا».

"O Allah, Zoti i shtatë qiejve e i asaj që ata mbulojnë, Zoti i shtatë tokave e i asaj që ato mbajnë, Zoti i shejtanëve e i atyre që ata devijojnë dhe Zoti i erërave e i asaj që ato shpërndajnë! E kërkoj prej Teje të mirën e këtij vendbanimi, të mirën e banorëve të tij dhe të mirën e asaj që gjendet në të, si dhe kërkoj mbrojtje tek Ti nga e keqja e tij, e keqja e banorëve të tij dhe e keqja e asaj që gjendet në të!"²

98. Lutja kur hyjmë në treg

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، يُحْيِي وَيُمِيتُ، وَهُوَ حَيٌّ لَا يَمُوتُ، بِيَدِهِ الْخَيْرُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ».

"S'ka të adhurar përveç Allahut, të Vetmit, që

¹ Muslimi (2/978) nr. 1342.

² Transmetuan Hakimi, i cili e ka vlerësuar të saktë dhe me të është pajtuar edhe Dhehebiu (2/100). E ka transmetuar dhe Ibn es-Suniu nr.524. Ibn Haxheri në "Tahrîx el-Edhkar" (5/154) e ka vlerësuar të mirë. Dijetari i madh Ibn Bazi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "E ka transmetuar Nesaiu me zinxhir të mirë." Shih: "Tuhfet el-Ahjar" (fq.37).

nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai jep jetë dhe vdekje, Ai është i Gjallë dhe nuk vdes, në dorën e Tij është çdo e mirë dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë."¹

99. Duaja kur pengohet mjeti i udhëtimit

«يُسَمِّى اللّٰهُ».

"Me emrin e Allahut"²

100. Lutja e udhëtarit për joudhëtarin

«أَسْتَوْدِعُكُمُ اللّٰهَ الَّذِي لَا تَضِيعُ وَدَائِعُهُ».

"Ju lë nën kujdesin e Allahut, tek i Cili nuk humbet asnjë gjë që lihet në kujdesin e Tij."³

101. Lutja e banorëve për udhëtarin

«أَسْتَوْدِعُ اللّٰهَ دِينَكَ، وَأَمَانَتَكَ، وَخَوَاتِيمَ عَمَلِكَ».

"E lë në kujdesin e Allahut fenë tënde, amanetin tënd dhe përfundimin e veprave të tua."⁴

«رَزَوَدَكَ اللّٰهُ التَّقْوَى، وَعَقَرَ ذَنْبَكَ، وَبَسَّرَ لَكَ الْخَيْرَ حَيْثُ مَا كُنْتَ».

¹ Tirmidhiu nr. 3428, Ibn Maxhe (5/291) nr. 3860 dhe Hakimi (1/538), Albani e ka vlerësuar të mirë në Sahih Ibn Maxhe (2/21) dhe në Sahih et-Tirmidhi (3/152).

² Ebu Davudi (4/296) nr. 4982. Albani e ka vlerësuar të saktë këtë hadith në Sahihun e Ebu Davudit (3/941).

³ Ahmedi (2/403) nr. 9230 dhe Ibn Maxhe (2/943) nr. 2825. Shih: Sahih Ibn Maxhe (2/133).

⁴ Ahmedi (2/7) nr. 4524 dhe Tirmidhiu (5/499) nr. 3443. Albani e ka cilësuar të saktë në Sahih Sunen et-Tirmidhi (3/419).

"Allahu të furnizoftë me devotshmëri, të faltë mëkatet dhe të lehtësoftë të mirat, kudo që të jesh!"¹

102. Tekbiri dhe tesbihi gjatë udhëtimit

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Kur ngjiteshim, bënim tekbir: thotë: "Allahu është më i Madhi" e kur zbrisnim, bënim tesbih."²

thotë: "I Patëmeta është Allahu!"

103. Lutja e udhëtarit në kohën e syfyrit (pak para agimit)

«سَمِعَ سَامِعٌ بِحَمْدِ اللَّهِ، وَحُسْنِ بَلَائِهِ عَلَيْنَا، رَبَّنَا صَاحِبِنَا، وَأَفْضَلِ عَلَيْنَا، عَائِدًا بِاللَّهِ مِنَ النَّارِ».

"Le ta dëgjojë dëgjuesi lavdërimin ndaj Allahut dhe të mirat e Tij ndaj nesh! O Zoti ynë, na shoqëro dhe na dhuro nga mirësitë e Tua! Kërkoj mbrojtjen e Allahut nga dënimi i Zjarrit!"³

104. Lutja kur ndalojmë në një vend qofshim udhëtarë apo jo

«أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ».

¹ Tirmidhiu nr. 3444, dhe shih: Sahih et-Tirmidhi (3/155).

² Buhariu në Fet'h el-Bari (6/135) nr. 2993.

³ Muslimi (4/2086) nr. 2718, kuptimi i "Le ta dëgjojë dëgjuesi...": d.m.th. le të dëshmojë një dëshmitar për lavdërimin tonë ndaj Allahut të Lartësuar për mirësitë e Tij dhe sprovat e Tij të mira ndaj nesh. Ndërsa kuptimi tjetër i saj është: dëgjuesi i fjalës sime le t'ua përcjellë atë të tjerëve, dhe le të thotë të njëjtën gjë në formë ndërgjegjësimi për të tjerët që të bëjnë dhikër dhe dua në kohën e syfyrit. Komentimi i Neveviut në Sahihun e Muslimit (17/39).

"Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut prej së keqes së çdo gjëje që Ai ka krijuar!"¹

105. Dhikri që bëhet gjatë kthimit nga udhëtimi

«يُكَبَّرُ عَلَى كُلِّ شَرَفٍ ثَلَاثَ تَكْبِيرَاتٍ ثُمَّ يَقُولُ:

Bën tekbir tri herë mbi çdo vend të lartë, pastaj thotë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،
آيُّونَ، تَائِبُونَ، عَابِدُونَ، لِرَبِّنَا حَامِدُونَ، صَدَقَ اللَّهُ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ عَبْدَهُ، وَهَزَمَ
الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ».

"Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, Ai është i vetëm dhe nuk ka ortak. Atij i përket sundimi dhe Atij i takon lavdia. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Po kthehemi të penduar, adhurues dhe falënderues ndaj Zotit tonë. Allahu e përmbushi premtimin, e ndihmoi robin e Tij dhe i shpartalloi palët armike i vetëm."²

106. Çfarë themi kur na ndodh diçka që na gëzon ose diçka e pakëndshme

Kur Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!) i vinte diçka që e gëzonte, thoshte:

¹ Muslimi (4/2080) nr. 2709.

² Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) e thoshte kur kthehej nga ekspedita ose Haxhi, Buhariu (7/163) nr. 1797 dhe Muslimi (2/980) nr. 1344.

«الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي بِنِعْمَتِهِ تَتِمُّ الصَّالِحَاتُ».

"Falënderimi i takon Allahut, me mirësinë e të Cilit plotësohen punët e mira."

E kur i vinte diçka që nuk i pëlqente, thoshte:

«الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى كُلِّ حَالٍ».

"Falënderimi i përket Allahut në çdo gjendje!"¹

107. Vlera e dërgimit të salavateve për Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!)

Pejgamberi (paqja dhe bekimet qofshin mbi të!) ka thënë:

«مَنْ صَلَّى عَلَيَّ صَلَاةً صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ بِهَا عَشْرًا».

"Ai që dërgon salavate për mua një herë, Allahu do të dërgojë salavate për të dhjetë herë."² Forma e salavatit është si për shembull: "O Allah, lësho paqe dhe bekime mbi profetin tonë, Muhamedin!"

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَا تَجْعَلُوا قَبْرِي عِيدًا وَصَلُّوا عَلَيَّ؛ فَإِنَّ صَلَاتَكُمْ تَبْلُغُنِي حَيْثُ كُنْتُمْ».

"Mos e shndërroni varrin tim në vend feste dhe më dërgoni salavate, sepse salavatet tuaja më

¹ E transmetuan Ibn es-Sunni në "Amelul-Jeum vel-Lejleh" nr. 377 dhe Hakimi, i cili e ka vlerësuar të saktë (1/499). Gjithashtu Albani e ka cilësuar të saktë në "Sahihul-Xhami" (4/201).

² Transmetoi Muslimi (1/288) nr. 384.

arrijnë kudo që të jeni."¹

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«الْبَخِيلُ مَنْ ذُكِرْتُ عَنْدهُ فَلَمْ يُصَلِّ عَلَيَّ».

"Koprraci (i vërtetë) është ai, që kur përmendem unë tek ai, nuk dërgon salavat mbi mua."²

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِنَّ لِلَّهِ مَلَائِكَةً سَيَّاحِينَ فِي الْأَرْضِ يُبَلِّغُونِي مِنْ أُمَّتِي السَّلَامَ».

"Vërtet, Allahu ka disa melekë që enden (udhëtojnë) në tokë dhe ma përcjellin përshëndetjen (selamin) e umetit tim."³

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَا مِنْ أَحَدٍ يُسَلِّمُ عَلَيَّ إِلَّا رَدَّ اللَّهُ عَلَيَّ رُوحِي حَتَّى أَرُدَّ عَلَيْهِ السَّلَامَ».

"Nuk ndodh që dikush të më japë selam, veçse Allahu ma rikthen shpirtin, derisa t'ia kthej selamin."⁴

¹ Ebu Davudi (2/218) nr. 2044 dhe Imam Ahmedi (2/367) nr. 8804. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Ebu Davudit (2/383).

² Tirmidhiu (5/551) nr. 3546, dhe të tjerë. Shih: Sahihul Xhami (3/25), dhe Sahih et-Tirmidhi (3/177).

³ Nesaiu (3/43) nr. 1282, dhe Hakimi (2/421). Albani e ka cilësuar të saktë në "Sahih en-Nesai" (1/274).

⁴ Ebu Davudi nr. 2041, ndërsa Albani e ka vlerësuar të mirë në Sahih Ebi Davud (1/383).

108. Përhapja e selamit

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَا تَدْخُلُوا الْجَنَّةَ حَتَّى تُؤْمِنُوا، وَلَا تُؤْمِنُوا حَتَّى تَحَابُّوا، أَوْ لَا أَدْلُكُمْ عَلَى شَيْءٍ إِذَا فَعَلْتُمُوهُ تَحَابَبْتُمْ، أَفْشُوا السَّلَامَ بَيْنَكُمْ».

"Nuk keni për të hyrë në Xhenet derisa të besoni, e nuk keni për të besuar derisa të duheni mes vete. A t'ju tregoj për një gjë që, nëse e bëni, do të duheni ndërmjet vete? Përhapeni selamin në mesin tuaj!"¹

«ثَلَاثٌ مَنْ جَمَعَهُنَّ فَقَدْ جَمَعَ الْإِيمَانَ: الْإِنْصَافُ مِنْ نَفْسِكَ، وَبَدَلُ السَّلَامِ لِلْعَالَمِ، وَالْإِنْفَاقُ مِنَ الْإِفْتَارِ».

"Kush i bashkon tri gjëra, e ka plotësuar Imanin (besimin): drejtësinë ndaj vetvetes, dhënien e selamit për të gjithë njerëzit dhe të shpenzuarit në kohë varfërie."²

Abdullah ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Një burrë e pyeti Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!): "Cila cilësi e Islamit është më e mira?" Ai u përgjigj:

«تُطْعِمُ الطَّعَامَ، وَتَقْرَأُ السَّلَامَ عَلَى مَنْ عَرَفْتَ وَمَنْ لَمْ تَعْرِفْ».

"Të japësh ushqim dhe të përshëndesësh me selam ata që i njeh dhe ata që nuk i njeh."³

¹ Muslimi (1/74) nr. 54 dhe Ahmedî nr. 1430, ndërsa teksti është i Ahmedit.

² Buhariu në Fet'h el-Bari (1/82) nr. 28, nga Ammari, Allahu qoftë i kënaqur me të, si fjalë e Ammarit, pa zinxhirin e transmetuesve.

³ Transmetuan Buhariu në Fet'h el-Bari (1/55) nr. 12 dhe Muslimi (1/65) nr. 39.

109. Si t'ia kthejmë selamin jobesimtarit nëse na jep selam?

«إِذَا سَلَّمَ عَلَيْكُمْ أَهْلُ الْكِتَابِ فَقُولُوا: وَعَلَيْكُمْ».

"Kur t'ju përshëndesin me selam ithtarët e Librit, thoni: 'Edhe mbi ju.'"¹

110. Lutja që thuhet kur dëgjojmë këndimin e gjelit dhe pëllitjen e gomarit

«إِذَا سَمِعْتُمْ صِيَاحَ الدَّيَكَةِ فَاسْأَلُوا اللَّهَ مِنْ فَضْلِهِ؛ فَإِنَّهَا رَأَتْ مَلَكًا،

"Kur të dëgjoni këndimin e gjelave, kërkoni prej Allahut nga mirësia e Tij, sepse ata kanë parë një melek!

Për shembull, themi: "O Allah! Të lutem të më japësh nga mirësitë e Tua!"

وَإِذَا سَمِعْتُمْ نَهْيَ الْخِمَارِ فَتَعَوَّذُوا بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ؛ فَإِنَّهُ رَأَى شَيْطَانًا».

Kur të dëgjoni pëllitjen e gomarit, kërkoni mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit; se vërtet, ai ka parë një shejtan!"² Për shembull, themi: "Lus Allahun të më mbrojë prej shejtanit të mallkuar."

111. Lutja që thuhet kur dëgjojmë lehjen e genve natën

«إِذَا سَمِعْتُمْ نُبَاحَ الْكِلَابِ وَنَهْيَ الْخَمِيرِ بِاللَّيْلِ فَتَعَوَّذُوا بِاللَّهِ مِنْهُمْ؛ فَإِنَّهُمْ يَرِينَ

¹ Buhariu me Fet'h el-Bari (11/42) nr. 6258 dhe Muslimi (4/1705) nr. 2163.

² Buhariu në Fet'h el-Bari (6/350) nr. 3303 dhe Muslimi (4/2092) nr. 2729.

مَا لَا تَرَوْنَ».

"Kur të dëgjoni lehjen e qenve dhe pëllitjen e gomarëve natën, kërkoni mbrojtje tek Allahu prej tyre, sepse ato shohin atë që ju nuk e shihni!"¹

Për shembull, themi: "I mbështetem Allahut të më mbrojë nga shejtani i mallkuar."

112. Duaja për atë që e kemi fyer

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«اللَّهُمَّ فَأَيُّمَا مُؤْمِنٍ سَبَّيْتُهُ فَاجْعَلْ ذَلِكَ لَهُ قُرْبَةً إِلَيْكَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ».

"O Allah, cilindo besimtar që e kam sharë, bëje atë shkak afrimi te Ti në Ditën e Gjykimit!"²

113. Çfarë themi kur duam të lëvdojmë një musliman?

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِذَا كَانَ أَحَدُكُمْ مَادِحًا صَاحِبَهُ لَا مُحَالَةً فَلْيَقُلْ: أَحْسِبُ فَلَانًا وَاللَّهُ حَسِيبُهُ، وَلَا أَزْكَى عَلَى اللَّهِ أَحَدًا، أَحْسِبُهُ—إِنْ كَانَ يَعْلَمُ ذَاكَ—كَذَا وَكَذَا».

"Nëse ndonjërit prej jush i duhet patjetër ta lavdërojë shokun e vet, le të thotë: 'Mendoj se filani është kështu e ashtu mirëpo Allahu është Llogarimarrësi i tij; unë nuk e konsideroj askënd të pastër para Allahut, thjesht them atë që mendoj se

¹ Ebu Davudi (4/327) nr. 5105 dhe Ahmedi (3/306) nr. 14283. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Ebu Davudit (3/961).

² Buhariu në Fet'h el-Bari (11/171) nr. 6361 dhe Muslimi (4/2007) nr. 396, ndërsa teksti i Muslimit është: "bëje atë pastrim dhe mëshirë për të".

ai është."¹

114. Çfarë themi kur na lavdërojnë?

«اللَّهُمَّ لَا تُؤَاخِذْنِي بِمَا يَقُولُونَ، وَاعْفُ عَنِّي مَا لَا يَعْلَمُونَ، [وَاجْعَلْنِي خَيْرًا مِمَّا يَظُنُّونَ]».

"O Allah, mos më ndëshko për atë që thonë, më fal për atë që nuk e dinë (dhe më bëj më të mirë nga sa mendojnë ata)!"²

115. Si bën telbije pelegrini për kryerjen e Haxhit ose të Umres?

«لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ، وَالنَّعْمَةَ، لَكَ وَالْمُلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ».

"Të përgjigjem, o Allah, vetëm Ty të përgjigjem! Të përgjigjem Ty; Ti nuk ke ortak; të përgjigjem! Vërtet, Ty të takon falënderimi, mirësia dhe sundimi. Ti nuk ke ortak!"³

116. Kur mbërrijmë te Guri i Zi bëjmë tekbir

«طَافَ النَّبِيُّ ﷺ بِالْبَيْتِ عَلَى بَعِيرٍ كُلَّمَا أَتَى الرُّكْنَ أَشَارَ إِلَيْهِ بِشَيْءٍ عِنْدَهُ وَكَبَّرَ».

¹ Transmetoi Muslimi (4/2296) nr. 3000.

² Buhariu në "El-Edeb el-Mufred" nr. 761. Zinxhirin e transmetimit të tij e ka cilësuar të saktë Albani në "Sahih el-Edeb el-Mufred" nr. 585, ndërsa ajo mes kllapave është shtesë e Bejhekiut në "Shuab el-Iman" [4/228] nga një rrugë tjetër.

³ Buhariu në Fet'h el-Bari (3/408) nr. 1549 dhe Muslimi (2/841) nr. 1184.

"Profeti (paqja qoftë mbi të!) bëri tavaf rreth Qabes mbi një deve dhe, sa herë që arrinte te këndi, ia bënte me shenjë me diçka që kishte me vete dhe thoshte: 'Allahu ekber'"¹

117. Lutja ndërmjet këndit jugperëndimor dhe Gurit të Zi

﴿...رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ﴾

"Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!"²

118. Lutja që themi kur qëndrojmë në Safa dhe Merva

Kur Profeti (paqja qoftë mbi të!) u afrua te kodra e Safasë, lexoi:

«إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ...، أَبْدَأُ بِمَا بَدَأَ اللَّهُ بِهِ».

"Kodrinat Safa dhe Merva (në Mekë) janë pjesë e simboleve të Allahut..., e nis me atë që e nisi Allahu."

Sakaq, ai e nisi me Safanë, u ngjit në të derisa e pa Qaben, u drejtua me fytyrë nga Kibleja, e njësoi Allahun, e madhëroi Atë dhe tha:

¹ Buhariu në Fet'h el-Bari (3/476) nr. 1613, me fjalën 'me diçka që kishte me vete' është për qëllim: kërraba ose bastuni. Shih: Buhariu me Fet'h el-Bari (3/472).

² Ebu Davudi (2/179) nr. 1894, Imam Ahmedi (3/411) nr. 15398 dhe Begaviu në Sherhus-Suneh (7/128). Albani e ka vlerësuar të mirë në Sahihun e Ebu Davudit, (1/354), Surja el-Bekare.

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ، أُنْجَزَ وَعْدُهُ، وَنَصَرَ عَبْدُهُ، وَهَزَمَ الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ،

"Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, i Vetëm, pa ortak. Atij i përket pushteti dhe lavdia dhe Ai ka fuqi mbi çdo gjë. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, i Vetëm, e përmbushi premtimin e Tij, e ndihmoi robin e Tij dhe i mposhti aleatët i Vetëm.

ثُمَّ دَعَا بَيْنَ ذَلِكَ، قَالَ مِثْلَ هَذَا ثَلَاثَ مَرَّاتٍ»

Ai i përsëriti këto tri herë dhe midis tyre bënte lutje." (Hadithi). Në këtë hadith thuhet: pastaj veproi në Merve ashtu siç veproi në Safa.¹

119. Lutja e ditës së Arafatit

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«خَيْرُ الدُّعَاءِ دُعَاءُ يَوْمِ عَرَفَةَ، وَخَيْرُ مَا قُلْتُ أَنَا وَالنَّبِيُّونَ مِنْ قَبْلِي:

"Lutja më e mirë është lutja e ditës së Arafatit dhe fjala më e mirë që kam thënë unë dhe profetët para meje është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ».

'S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai ka fuqi për çdo gjë."² "Profeti (paqja qoftë mbi të!) hipi

¹ Muslimi (2/888) nr. 1218, El-Bekare: nr. 158.

² Tirmidhiu nr. 3585. Albani e ka vlerësuar të mirë në "Sahih et-Tirmidhi" (3/184) dhe në "Silsiletul-Ehadith es-Sahihah" (4/6).

mbi devenë e tij derisa arriti te Mesh'arul-Harami. Aty u drejtua nga kibla, iu lut Allahut, e madhëroi Atë, shqiptoi thënien La ilahe il-lallah dhe pohoi njëshmërinë e Tij. Vazhdoi të qëndronte aty derisa zbardhi mirë dita, pastaj u nis para se të lindte dielli."¹ "Themi 'Allahu ekber' sa herë që hedhim një guralec te të tria xhemeratet, pastaj ecim përpara, qëndrojmë për të bërë lutje duke u drejtuar nga kibla, duke i ngritur duart, pas xhemeres së parë dhe të dytë. Ndërsa te xhemretul-akabe, i hedhim gurët dhe bëjmë tekbir me çdo guralec dhe largohemi pa qëndruar tek ajo."².

120. Dhikri që thuhet në Mesh'arul Haram

121. Thënia "Allahu ekber" gjatë hedhjes së gurëve, me çdo gur

122. Duaja kur mahnitemi ose kur marrim një lajm të gëzueshëm

«سُبْحَانَ اللَّهِ!»

"P patëmëta është Allahu!"³

«اللَّهُ أَكْبَرُ!»

¹ Muslimi (2/891) nr. 1218.

² Buhariu në Fet'h el-Bari (3/583) nr. 1751. Shihe tekstin e tij aty. Po ashtu, Buhariu në Fet'h el-Bari (3/583), (3/584) dhe (3/581) nr. 1753, edhe Muslimi nr. 1218.

³ Transmetuan Buhariu në Fet'h el-Bari(1/210), (390) dhe (414) nr. 115, 3599 dhe 6218, dhe Muslimi (4/1857) nr. 1674.

"Allahu është më i Madhi!"¹

123. Çfarë bëjmë kur na vjen një lajm i gëzueshëm?

«كَانَ النَّبِيُّ ﷺ إِذَا أَتَاهُ أَمْرٌ يُسِّرُهُ أَوْ يُسْرِئُهُ خَرَّ سَاجِدًا شُكْرًا لِلَّهِ تَبَارَكَ وَتَعَالَى».

"Kur Profetiti (paqja qoftë mbi të!) i vinte një lajm që e gëzonte, binte në sexhde në shenjë falënderimi për Allahun e Madhëruar."²

124. Çfarë bëjmë apo themi kur ndiejmë dhembje në trup?

«ضَعُ يَدَكَ عَلَى الَّذِي تَأَلَّمَ مِنْ جَسَدِكَ وَقُلْ:

"Vendosim dorën mbi vendin ku ndiejmë dhembjen në trup dhe themi:

بِسْمِ اللَّهِ،

'Me emrin e Allahut!'

ثَلَاثًا،

Tri herë.

وَقُلْ سَبْعَ مَرَّاتٍ:

Themi shtatë herë:

¹ Buhariu në Fet'h el-Bari (8/441) nr. 4741 dhe 3062, Tirmidhiu nr. 2180 dhe Nesaiu në Sunen el-Kubra nr. 11185. Shih: Sahih et-Tirmidhi (2/103) dhe (2/235) dhe Musnedi i Ahmedit (5/218) nr. 21900.

² Transmetuan autorët e Suneneve përveç Nesaiut: Ebu Davudi nr. 2774, Tirmidhiu nr. 1578 dhe Ibn Maxhe nr. 1394. Shih: Sahih Ibn Maxhe (1/233) dhe Irva el-Galil (2/226).

أَعُوذُ بِاللَّهِ وَقُدْرَتِهِ مِنْ شَرِّ مَا أَجِدُ وَأُحَازِرُ».

"Kërkoj mbrojtjen e Allahut dhe të fuqisë së Tij nga e keqja e asaj që ndiej dhe i frikësohem!"¹

125. Lutja kur druheni se mund të marrim mësysh ndonjë gjë

«إِذَا رَأَى أَحَدُكُمْ مِنْ أَخِيهِ، أَوْ مِنْ نَفْسِهِ، أَوْ مِنْ مَالِهِ مَا يُعْجِبُهُ [فَلْيَدْعُ لَهُ بِالْبَرَكَةِ] فَإِنَّ الْعَيْنَ حَقٌّ».

"Kur dikush sheh diçka që i pëlqen te vëllai i tij ose në veten ose pasurinë e tij, le të lutet për të për bereqet, sepse mësyshi është i vërtetë!"²

126. Çfarë thuhet kur trembemi?

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ».

"Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut!"³

127. Çfarë thuhet gjatë therjes së kafshës?

«بِسْمِ اللَّهِ وَاللَّهُ أَكْبَرُ [اللَّهُمَّ مِنْكَ وَلَكَ] اللَّهُمَّ تَقَبَّلْ مِنِّي».

"Në emër të Allahut! Allahu është më i Madhi! [O Allah, prej Teje dhe për Ty!] O Allah, pranoje prej

¹ Muslimi (4/1728) nr. 2202.

² Musnedi i Ahmedit (4/447) nr. 15700, Ibn Maxhe nr. 3508 dhe Maliku (3/118-119). Albani e ka cilësuar të saktë në "Sahihul-Xhami" (1/212). Shih verifikimin e "Zadul-Mead" të Arnautit (4/170).

³ Buhariu në Fet-h el-Bari (6/381) nr. 3346 dhe Muslimi (4/2208) nr. 2880.

meje!"¹

128. Çfarë thuhet për të zmbrapsur kurthin e shejtanëve rebelë?

«أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ الَّتِي لَا يَجَاوِزُهُنَّ بَرٌّ وَلَا فَاجِرٌ: مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ، وَبَرًّا وَدَرًّا، وَمِنْ شَرِّ مَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ، وَمِنْ شَرِّ مَا يَعْرُجُ فِيهَا، وَمِنْ شَرِّ مَا ذَرَأَ فِي الْأَرْضِ، وَمِنْ شَرِّ مَا يُخْرِجُ مِنْهَا، وَمِنْ شَرِّ فِتَنِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ، وَمِنْ شَرِّ كُلِّ طَارِقٍ إِلَّا طَارِقًا يَطْرُقُ بِخَيْرٍ يَا رَحْمَنُ».

"Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut, të cilat nuk mund t'i kapërcejë as i miri e as i keqi: prej së keqes së çdo gjëje që Ai ka krijuar, ka shpikur dhe ka shumuar, si dhe prej së keqes së asaj që zbret nga qielli, prej së keqes së asaj që ngjitet në të, prej së keqes së asaj që ka shpërndarë në tokë, prej së keqes së asaj që del prej saj, prej së keqes së sprovave të natës dhe të ditës dhe prej së keqes së çdo trokitësi, përveç atij që troket me të mirë, o i Gjithëmëshirshëm!"²

129. Kërkimi i faljes dhe pendimi

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«وَاللَّهِ إِنِّي لَأَسْتَغْفِرُ اللَّهَ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ فِي الْيَوْمِ أَكْثَرَ مِنْ سَبْعِينَ مَرَّةً».

¹ Muslimi (3/1557) nr. 1967 dhe Bejhekiu (9/287), ndërsa ajo mes kllapave është e Bejhekiut (9/287) dhe të tjerëve, kurse fjalinë e fundit e solla sipas kuptimit nga transmetimi i Muslimit.

² Ahmedi (3/419) nr. 15461, me zinxhir të saktë të transmetuesve, dhe Ibn es-Suniu nr. 637, zinxhirin e tij e ka cilësuar të saktë Arnauti në verifikimin e Tahavijes (fq. 133). Shih: Mexhmeu ez-Zevaid (10/127).

"Pasha Allahun, unë i kërkoj falje Allahut dhe pendohem tek Ai më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë."¹

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«بَا أَیَّهَا النَّاسُ تُوبُوا إِلَى اللَّهِ فَإِنِّي أَتُوبُ فِي الْيَوْمِ إِلَيْهِ مِائَةً مَرَّةً».

"O njerëz, pendohuni tek Allahu, sepse unë pendohem tek Allahu njëqind herë në ditë."²

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ قَالَ:

"Kush thotë:

أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ الْعَظِيمَ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ،

'I kërkoj falje dhe i pendohem Allahut të Madhëruar, veç të cilit nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, i Gjalli, Mbikëqyrësi,

غَفَرَ اللَّهُ لَهُ وَإِنْ كَانَ فَرَّ مِنَ الرَّحْفِ».

Allahu e fal atë, edhe nëse ka ikur nga fushëbeteja."³

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka

¹ Buhariu në el-Fet'h (11/101) nr. 6307.

² Muslimi (4/2076) nr. 2702.

³ Ebu Davudi (2/85) nr. 1517, Tirmidhiu (5/569) nr. 3577, Hakimi, i cili e ka vlerësuar të saktë dhe me të është pajtuar dhe Dhehebiu (1/511). Albani e ka vlerësuar gjithashtu të saktë. Shih: Sahih et-Tirmidhi (3/182) dhe Xhami'ul Usul li Ehadithir-Resul (4/389-390) me verifikim të Arnautit.

thënë:

«أَقْرَبُ مَا يَكُونُ الرَّبُّ مِنَ الْعَبْدِ فِي جَوْفِ اللَّيْلِ الْآخِرِ فَإِنْ اسْتَطَعْتَ أَنْ تَكُونَ مِمَّنْ يَذْكُرُ اللَّهَ فِي تِلْكَ السَّاعَةِ فَكُنْ».

"Zoti është më afër robit në mes të natës, kështu që, nëse mund të jesh ndër ata që e përmendin Allahun në atë orë, bëje!"¹

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«أَقْرَبُ مَا يَكُونُ الْعَبْدُ مِنْ رَبِّهِ وَهُوَ سَاجِدٌ فَأَكْثِرُوا الدُّعَاءَ».

"Robi është më afër me Zotin e tij kur ndodhet në sexhde, prandaj shpreshtoni lutjet (në të!)"²

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِنَّهُ لَيُعَانُ عَلَى قَلْبِي وَإِنِّي لَأَسْتَغْفِرُ اللَّهَ فِي الْيَوْمِ مِائَةَ مَرَّةٍ».

"Me të vërtetë, nganjëherë më mbulohet zemra dhe unë i kërkoj falje Allahut njëqind herë në ditë."³

130. Vlera e fjalëve: subhanallah,

¹ Tirmidhiu nr.3579, Nesaiu (1/279) nr.572 dhe Hakimi (1/309). Shih: Sahihun e Tirmidhiut (3/183) dhe "Xhami el-Usul" me verifikimin e Arnautit (4/144).

² Muslimi (1/350) nr. 482.

³ Transmetoi Muslimi (4/2075), nr. 2702. Ibn Ethiri ka thënë: "Zemrës sime i vihet një perde», domethënë: mbulohet. Me këtë nënkuptohet: shpërqendrimi; sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ishte vazhdimisht në shtim e sipër të përmendjes së Allahut, të afritit tek Ai dhe të vetëdijes së vazhdueshme. Kështu që, nëse ai shpërqendrohej nga diçka prej kësaj në disa çaste, ose harronte, e llogariste këtë si mëkat për veten e tij, andaj nxitonte drejt kërimit të faljes." Shih: Xhami'ul-Usul (4/386).

elḥamdulilah, la ilahe il-lallah dhe Allahu ekber

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ قَالَ:

"Kush thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ

'I patëmëta dhe i Lavdëruar është Allahu'

فِي يَوْمٍ مِائَةَ مَرَّةٍ حُطَّتْ حَطَايَاهُ وَلَوْ كَانَتْ مِثْلَ زَبَدِ الْبَحْرِ».

njëqind herë në ditë, i fshihen mëkatet, edhe në qofshin sa shkuma e detit."¹

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ قَالَ:

"Kush thotë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"S'ka të adhuruar përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdia, Ai ka fuqi për çdo gjë."

عَشْرَ مَرَارٍ، كَانَ كَمَنْ أَعْتَقَ أَرْبَعَةَ أَنْفُسٍ مِنْ وَلَدِ إِسْمَاعِيلَ».

dhjetë herë, i llogaritet sikur t'i ketë liruar katër

¹ Buhariu (7/168) nr. 6405 dhe Muslimi (4/2071) nr. 2691. Shih: Vlera e atij që e thotë atë njëqind herë në mëngjes dhe në mbrëmje (fq. 65) e këtij libri.

robër nga pasardhësit e Ismailit."¹

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«كَلِمَتَانِ خَفِيفَتَانِ عَلَى اللِّسَانِ، ثَقِيلَتَانِ فِي الْمِيزَانِ، حَبِيبَتَانِ إِلَى الرَّحْمَنِ:

"Dy fjalë janë të lehta për gjuhën, të rënda në peshore dhe të dashura për të Gjithëmëshirshmin:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ، سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ».

"I Lartësuar është Allahu dhe Atij i takon lavdërimi, i Lartësuar është Allahu i Madhëruar!"²

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَأَنْ أَقُولَ:

"Të them:

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ،

'I lavdëruar qoftë Allahu, falënderimi i takon Allahut, s'ka të adhuroar të denjë përveç Allahut, Allahu është më i Madhi'

أَحَبُّ إِلَيَّ مِمَّا طَلَعَتْ عَلَيْهِ الشَّمْسُ».

është më e dashurpër mua se çdo gjë që Dielli e përshkon kur lind."³

¹ Buhariu (7/67) nr. 6404 dhe Muslimi, teksti është i Muslimit, (4/2071) nr. 2693. Shiko: Vlera e atij që e thotë njëqind herë në ditë. Lutja nr. 93 (f. 66) e këtij libri.

² Buhariu (7/168) nr. 6404 dhe Muslimi (4/2072) nr. 2694.

³ Muslimi (4/2072) nr. 2695.

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«أَيَعِزُّ أَحَدُكُمْ أَنْ يَكْسِبَ كُلَّ يَوْمٍ أَلْفَ حَسَنَةٍ»

"A nuk mundet ndonjëri prej jush të fitojë çdo ditë një mijë të mira?" Njëri nga të pranishmit e pyeti: "Si mund të fitojë dikush prej nesh një mijë të mira?" Ai tha:

«يُسَبِّحُ مِائَةَ تَسْبِيحَةٍ، فَيَكْتَبُ لَهُ أَلْفُ حَسَنَةٍ أَوْ يُحِطُّ عَنْهُ أَلْفُ خَطِيئَةٍ».

"Thotë njëqind herë Subhanallah, dhe i shkruhen një mijë të mira, ose i fshihen një mijë mëkate."¹

«مَنْ قَالَ:

"Atij që thotë:

سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ وَيَحْمَدُهُ

"I Patëmeta është Allahu i Madhëruar dhe Atij i takon lavdërimi"

غُرِسَتْ لَهُ نَخْلَةٌ فِي الْجَنَّةِ».

i mbillet një palmë hurme në Xhenet."²

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«يَا عَبْدَ اللَّهِ بْنَ قَيْسٍ أَلَا أَدُلُّكَ عَلَى كُنْزٍ مِنْ كُنُوزِ الْجَنَّةِ؟»

¹ Muslimi (4/2073) nr. 2698.

² E transmetuan Tirmidhiu (5/511), nr. 3464 dhe Hakimi (1/501). Hakimi e ka vlerësuar të saktë dhe me të është pajtuar dhe Dhehebiu. Shih: Sahih el-Xhami (5/531) dhe Sahih et-Tirmidhi (3/160).

"O Abdullah ibn Kajs, a të tregoj për një nga thesaret e Xhenetit?" Unë thashë: "Patjetër, o i Dërguari i Allahut." Ai tha:

«قُلْ:

"Thuaj:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ».

"Nuk ka lëvizje dhe as fuqi veçse nëpërmjet Allahut."¹

Po ashtu, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«أَحَبُّ الْكَلَامِ إِلَى اللَّهِ أَرْبَعٌ:

"Fjalët më të mira tek Allahu janë katër:

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ،

"I Patëmeta është Allahu, falënderimi i takon Allahut, s'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Allahu është më i Madhi."

لَا يَضُرُّكَ بِأَيِّهِنَّ بَدَأْتَ».

Nuk prish punë se me cilën fillon."²

Një beduin erdhi te Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: "Më mëso disa fjalë që t'i them!" Pejgamberi tha:

«قُلْ:

¹ Buhariu në Fet'h el-Bari (11/213) nr. 4206 dhe Muslimi (4/2076) nr. 2704.

² Muslimi (3/1685) nr. 2137.

"Thuaj:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، سُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ.

"S'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Allahu është më i Madhi, falënderimet e shumta i takojnë Allahut. I lavdëruar qoftë Allahu, Zoti i botëve. S'ka lëvizje e as fuqi, përveçse me Allahun, të Gjithëfuqishmin, të Urtin."

Ai tha: "Këto janë për Zotin tim, po për mua?" Ai tha:

«قُلْ:

"Thuaj:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَارْزُقْنِي».

"O Allah, më fal, më mëshiro, më udhëzo dhe më furnizo me të mira!"¹

Kur një njeri pranonte Islamin, Profeti (paqja qoftë mbi të!) ia mësonte namazin, pastaj e urdhëronte të lutej me këto fjalë:

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي، وَارْحَمْنِي، وَاهْدِنِي، وَارْزُقْنِي».

"O Allah, më fal, më mëshiro, më udhëzo, më jep shëndet dhe më furnizo me të mira!"²

¹ Muslimi (4/ 2072) nr. 2696. Ebu Davudi e përcjell me shtesën: Kur u largua beduini, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) tha: "Vërtet, e mbushi dorën e tij me mirësi." (1/220) nr. 832.

² Muslimi (4/ 2073) nr. 3697. Ndërsa në një transmetim tjetër të tij thuhet: «sepse vërtet, në këto fjalë përmbledhen dunjaja dhe ahireti yt.»

«إِنَّ أَفْضَلَ الدُّعَاءِ

"Me të vërtetë, lutja më e mirë është:

الْحَمْدُ لِلَّهِ،

'Lavdërimi i takon Allahut'

وَأَفْضَلُ الذِّكْرِ

Ndërsa dhikri më i mirë është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ».

"Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut"¹.

«الْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ:

"Veprat e mira që ngelin përgjithmonë janë:

سُبْحَانَ اللَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ».

"I Patëmeta është Allahu, falënderimi i takon Allahut, s'ka të adhuruar përveç Allahut, Allahu është më i Madhi, dhe s'ka lëvizje e as fuqi, përveçse me Allahun"²

131. Si bënte tesbih Profeti (paqja qoftë mbi të!)?

Abdullah ibn Amri (Allahu qoftë i kënaqur me

¹ Tirmidhiu (5/462) nr. 3383, Ibn Maxhe (2/1249) nr. 3800 dhe Hakimi (1/503). Hakimi e ka cilësuar të saktë dhe bashkë me të është pajtuar dhe Dhehebiu. Shih: Sahih el-Xhami (1/362).

² Ahmedi nr. 513 sipas radhitjes së Ahmed Shakirit. Shih gjithashtu: "Mexhma ez-Zevaid" (1/297). Ndërkaq, Ibn Haxheri në "Bulug el-Meram" ia ka atribuar Nesaiut në "El Kubra" nr. 10617 nga transmetimi i Ebu Seidit dhe ka thënë: Ibn Hibani nr. 840 dhe Hakimi (1/541) e kanë cilësuar të saktë.

të!) tregon:

«رَأَيْتُ النَّبِيَّ ﷺ يَعْقِدُ التَّسْبِيحَ» وفي زيادة: «بِإِيمَانِهِ».

"E kam parë Profetin (paqja qoftë mbi të!) duke i numëruar tesbihët", ndërsa në një shtesë thuhet: "me të djathtën e tij."¹

132. Disa mirësi të ndryshme dhe norma gjithëpërfshirëse

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِذَا كَانَ جُنْحُ اللَّيْلِ - أَوْ أَمْسَيْتُمْ - فَكُفُّوا صَبْيَانَكُمْ، فَإِنَّ الشَّيَاطِينَ تَنْتَشِرُ حِينَئِذٍ، فَإِذَا ذَهَبَ سَاعَةٌ مِنَ اللَّيْلِ فَخَلُّوهُمْ، وَأَغْلِقُوا الْأَبْوَابَ وَادْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ؛ فَإِنَّ الشَّيْطَانَ لَا يَفْتَحُ بَابًا مُغْلَقًا، وَأَوْكُوا قِرْبَكُمْ، وَادْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ، وَخَمِّرُوا أَنْيَتَكُمْ، وَادْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ، وَلَوْ أَنَّ تَعْرُضُوا عَلَيْهَا شَيْئًا، وَأَطْفَأُوا مَصَابِيحَكُمْ».

"Kur të bjerë errësira e natës – ose kur të ngryseni – mbajini brenda fëmijët tuaj, ngase shejtanët shpërndahen në atë kohë. Kur të kalojë një pjesë e natës, lërinia ata. Mbyllini dyert dhe përmendeni emrin e Allahut, ngase shejtani nuk hap derë të mbyllur. Lidhini grykat e enëve tuaja të lëkurës dhe përmendeni emrin e Allahut. Mbulojini enët tuaja dhe përmendeni emrin e Allahut, qoftë edhe duke vënë diçka sipër tyre, dhe fikini llambat tuaja."²

¹ E transmetuan Ebu Davudi me tekstin e tij (2/81) nr. 1502 dhe Tirmidhiu (5/521) nr. 3486. Shih: Sahihul-Xhami (4/271) nr. 4865. Albani e ka vlerësuar të saktë në Sahihun e Sunenit të Ebu Davudit (1/411).

² Buhariu në Feth el-Bari (10/ 88) nr. 5623 dhe Muslimi (3/1595) nr. 2012.

Salavatet, selamet dhe bekimet qofshin për Profetin tonë, Muhamedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.



Përmbajtja

Fortesa e Muslimanit – Lutje nga Kurani dhe Suneti	2
Parathënie.....	2
Vlera e dhikrit (përmendjes së Allahut).....	4
1. Dhikri i zgjimit nga gjumi	9
2. Duaja e veshjes së rrobës	12
3. Duaja e veshjes së rrobës së re	13
4. Duaja për atë që ka veshur rrobë të re	13
5. Çfarë themi kur heqim rrobën?.....	14
6. Lutja e hyrjes në tualet (nevojtores)	14
7. Lutja e daljes nga tualeti	14
8. Dhikri para abdesit	14
9. Dhikri pas përfundimit të abdesit.....	14
10. Lutja kur të dalim nga shtëpia	15
11. Lutja kur të hyjmë në shtëpi	16
12. Lutja e shkuarjes në xhami.....	16
13. Lutja e hyrjes në xhami.....	17
14. Lutja e daljes nga xhamia	18
15. Dhikri i ezanit	19
16. Duaja hyrëse (e namazit)	20
17. Duaja që thuhet kur jemi në ruku	25
18. Lutja e ngritjes nga rukuja.....	26
19. Duaja (lutja) e sexhdes	27
20. Lutja e uljes ndërmjet dy sexhdeve	28
21. Lutja e sexhdes së leximit.....	29
22. Teshehudi	30

23. Salavatet për Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!) pas teshehudit	30
24. Lutja pas teshehudit të fundit para selamit	31
25. Dhikri pas mbarimit të namazit.....	35
26. Duaja e namazit të istihares	39
27. Dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes	41
28. Lutjet e gjumit	54
29. Lutja kur rrotullohemi natën në shtrat.	60
30. Lutja kur trembemi në gjumë dhe ndiejmë vetmi.....	61
31. Çfarë duhet të bëjmë kur shohim ëndërr? ..	61
32. Duaja e kunutit të vitrit	62
33. Dhikri pas selamit të vitrit	63
34. Duaja (lutja) e brengës dhe pikëllimit.....	64
35. Duaja e brengosjes (ankthit).....	65
36. Lutja gjatë përballjes me armikun dhe pushtetarin	66
37. Lutja kur i druhami padrejtësisë së sundimtarit	67
38. Lutja kundër armikut.....	68
39. Çfarë themi kur i druhami një grupi të njerëzve.....	68
40. Lutja kur kemi cytje në besim	69
41. Duaja për shlyerjen e borxhit.....	69
42. Lutja kundër cytjeve gjatë namazit dhe këndimit të Kuranit.....	70
43. Duaja (lutja) kur na vështirësohet një çështje	70

44. Çfarë themi kur bëjmë ndonjë gjynah?	71
45. Lutja për largimin e shejtanit dhe cytjeve të tij.....	71
46. Lutja kur na ndodh diçka e pakëndshme ose kur na del situata nga kontrolli.....	72
47. Urimi për fëmijën e porsalindur dhe përgjigjja e prindit ndaj urimit.....	72
48. Si të kërkojmë mbrojtje për fëmijët tanë?...73	
49. Lutja për të sëmurin gjatë vizitës tek ai	74
50. Vlera e vizitimit të të sëmurit	74
51. Lutja e të sëmurit që i ka humbur shpresat për jetën	75
52. Përkujtimi i shehadetit ndaj të sëmurit, i cili është në shtratin e vdekjes.....	76
53. Duaja kur na bie ndonjë fatkeqësi	76
54. Lutja kur ia mbyllim sytë të vdekurit	76
55. Lutja për të vdekurin në namazin e xhenazes	77
56. Lutja për fëmijën që ka vdekur në namazin e xhenazes.....	79
57. Lutja e ngushëllimit	80
58. Lutja gjatë futjes së të vdekurit në varr	81
59. Lutja pas varrimit të të vdekurit.....	81
60. Lutja e vizitës së varreve	81
61. Lutja që thuhet kur fryn erë	82
62. Lutja që thuhet kur dëgjojmë bubullimën ..	82
63. Disa nga lutjet që thuhën për lëshimin e shiut.....	83

64. Lutja që thuhet kur shohim shiun duke rënë	83
65. Dhikri që thuhet pas rënies së shiut.....	83
66. Disa lutje që thuhet për kthjellim të motit.....	84
67. Duaja që thuhet kur shohim hënë e re	84
68. Lutja që thuhet kur agjëruesi çel iftarin.....	84
69. Lutja që thuhet para ushqimit	85
70. Lutja që thuhet pas ushqimit	86
71. Lutja që bën mysafiri për të zotin e shtëpisë	86
72. Aludimi përmes lutjes për të kërkuar ushqim ose pije	87
73. Lutja që thuhet kur bëjmë iftar te një familje	87
74. Lutja që e bën agjëruesi kur i sillet ushqim dhe nuk ha.....	87
75. Çfarë thotë agjëruesi kur dikush e shan?	88
76. Lutja që thuhet kur shikojmë frutat e para të pemës	88
77. Lutja që themi kur teshtijmë.....	88
78. Çfarë i thuhet jobesimtarit kur teshtin dhe thotë: "Elhamdulilah"	89
79. Lutja që i thuhet të sapomartuarit.....	89
80. Lutja që themi kur martohemi dhe kur blejmë ndonjë kafshë	90
81. Lutja që thuhet para marrëdhënieve intime me bashkëshorten.....	90
82. Lutja që thuhet kur zemërohem	91

83. Lutja që thuhet kur shohim një të sprovuar	91
84. Çfarë thuhet në tubime?	91
85. Shlyerja e gabimeve të tubimit	91
86. Lutja që bëjmë për atë i cili na thotë: "Allahu të faltë!"	92
87. Lutja që bëjmë për dikë që na ka bërë një të mirë	92
88. Gjërat me të cilat Allahu na mbron nga Dexhali	92
89. Lutja që bëjmë për atë që na thotë: "Të dua për hir të Allahut"	93
90. Lutja që bëjmë për atë person që na ofron pasurinë e tij	93
91. Lutja që themi për atë që na jep hua në kohën e shlyerjes së borxhit.....	93
92. Lutja që bëjmë kur kemi frikë nga shirku ...	94
93. Lutja që bëjmë për atë që na thotë: "Allahu të begatoftë!"	94
94. Lutja që themi kundër ogurit të keq.....	94
95. Lutja që themi kur hipim në mjetin e udhëtimit	95
96. Lutja e udhëtimit	95
97. Lutja që thuhet kur hyjmë në fshat ose qytet	97
98. Lutja kur hyjmë në treg	97
99. Duaja kur pengohet mjeti i udhëtimit	98
100. Lutja e udhëtarit për joudhëtarin	98

101. Lutja e banorëve për udhëtarin	98
102. Tekbiri dhe tesbihi gjatë udhëtimit.....	99
103. Lutja e udhëtarit në kohën e syfyrit (pak para agimit)	99
104. Lutja kur ndalojmë në një vend qofshim udhëtarë apo jo.....	99
105. Dhikri që bëhet gjatë kthimit nga udhëtimi	100
106. Çfarë themi kur na ndodh diçka që na gëzon ose diçka e pakëndshme	100
107. Vlera e dërgimit të salavateve për Pejgamberin (paqja qoftë mbi të!).....	101
108. Përhapja e selamit	103
109. Si t'ia kthejmë selamin jobesimtarit nëse na jep selam?	104
110. Lutja që thuhet kur dëgjojmë këndimin e gjelit dhe pëllitjen e gomarit	104
111. Lutja që thuhet kur dëgjojmë lehjen e qenve natën	104
112. Dua për atë që e kemi fyer	105
113. Çfarë themi kur duam të lëvdojmë një musliman?.....	105
114. Çfarë themi kur na lavdërojnë?	106
115. Si bën telbije pelegrini për kryerjen e Haxhit ose të Umres?	106
116. Kur mbërrijmë te Guri i Zi bëjmë tekbir .	106
117. Lutja ndërmjet këndit jugperëndimor dhe Gurit të Zi	107

118. Lutja që themi kur qëndrojmë në Safa dhe Merva	107
119. Lutja e ditës së Arafatit.....	108
120. Dhikri që thuhet në Mesh'arul Haram	109
121. Thënia "Allahu ekber" gjatë hedhjes së gurëve, me çdo gur	109
122. Dua ja kur mahnitemi ose kur marrim një lajm të gëzueshëm.....	109
123. Çfarë bëjmë kur na vjen një lajm i gëzueshëm?	110
124. Çfarë bëjmë apo themi kur ndiejmë dhembje në trup?	110
125. Lutja kur druhami se mund të marrim mësysh ndonjë gjë.....	111
126. Çfarë thuhet kur trembemi?	111
127. Çfarë thuhet gjatë therjes së kafshës?	111
128. Çfarë thuhet për të zmbarsur kurthin e shejtanëve rebelë?.....	112
129. Kërkimi i faljes dhe pendimi	112
130. Vlera e fjalëve: subhanallah, elhamdulilah, la ilahe il-lallah dhe Allahu ekber	114
131. Si bënte tesbih Profeti (paqja qoftë mbi të!)?.....	120
132. Disa mirësi të ndryshme dhe norma gjithëpërfshirëse	121

sq24v5.0 - 02/09/2026



رسالة الحرمين

Message of The Two Holy Mosques

Guidance content for the visitors of the Holy Mosque
and the Prophet's Mosque in languages

